

PËRMBLEDHJE STUDIMESH

4

VITI I SHTATËMBËDHJETË I BOTIMIT

Tiranë, 1981

PERMBLEDHJE STUDIMESH

Buletin i përbashkët i Institutit të Studimeve dhe të
Projektimeve të Gjeologjisë dhe të Minierave dhe i Fakultetit të
Gjeologjisë e të Minierave të Universitetit
të Tiranës

4

VITI I SHTATËMBEDHJETË I BOTIMIT

LIBRARI INSTITUTIT

LIBRARI N. DANI, M. KERKIMI - TIRANA - 1981 - PËRMBLEDHJE STUDIMESH
TIRANA - 1981 - LIBRARI INSTITUTIT

LIBRARI INSTITUTIT - TIRANA - 1981

LIBRARI N. KERKIMI - TIRANA - 1981 - LIBRARI INSTITUTIT - TIRANA - 1981

12-02-1981

BIBLIOTEKA E INSTITUTIT
TE KËRKIMEVE GJEOLQIRE
MINERALE

Tiranë, 1981

RUBRIKA E DISKUTIMEVE

Page

- N. Nosi — Saktësimë të disa rekomandimeve të dhëna për kontrollin e gabimit sistematik të analizave. 103

KRONIKA JONE

- S. Pasho — Shërbimi gjeologjik i naftës në 30-vjetorin e krijimit të tij. 109

BIBLIOGRAFI

- A. Osmanliu - Bibliografi e botimeve të «Përbledhje Studimesh» për vitin 1981. 113

SOMMAIRE

| | Page |
|--|------|
| AU 8^e CONGRES DU PTA | |
| ENVER HOXHA — Rapport sur l'activité du Comité central du PTA. | 9 |
| Directives du 8 ^e Congrès du PTA le VII-ème plan quinquennal (1981-1985) du développement de l'économie et de la culture de la République Populaire Socialiste d'Albanie. | 31 |
| <i>Ll. Gegprifti</i> — Discours au 8 ^e Congrès du PTA. | 49 |
| <i>B. Pata</i> — Discours au 8 ^e Congrès du PTA. | 53 |
| <i>D. Kolndreu</i> — Discours au 8 ^e Congrès du PTA. | 55 |
| <i>E. Pumo</i> — Élevons encore le niveau les travaux l'enseignement et le scientifique à Faculté de Géologie et de Mines de l'Université de Tirana. | 57 |
| STRATIGRAPHIE-PALEONTOLOGIE | |
| <i>A. Pirdeni</i> — Hemigordius renzi (Reichel) dans les dépôts du permien supérieur de la région de Gjuraj dans la zone des Alpes albanaises. | 65 |
| GEOLOGIQUES-INGENIERIQUES | |
| <i>V. Shehu, N. Demi, N. Konomi</i> , — Le tunnel de Qaféthanë et ses traits géologiques-ingénieriques | 73 |
| MINERAIS UTILES | |
| <i>R. Cara, F. Mullaj</i> — La plage de Seman, son enrichissement avec des minérais lourds, ses conditions de formation et sa composition minéralogique. | 81 |
| TECHNOLOGIE ET ENRICHISSEMENT DES MINERAIS UTILES | |
| <i>I. Hido</i> — A propos de la détermination de la condition de teneur minimale du métal dans les minéraux de chrome pauvres. | 97 |

Në Kongresin e 8-të të Partisë së Punës

të Shqipërisë

NGA RAPORTI MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

**MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH
SHOKU ENVER HOXHA**

Të dashur shokë e shoqe,

Partia dhe mbarë populli ynë vijnë në këtë Kongres me suksese të mëdha e fitore të shënvatra. Shqipëria socialiste u ngjit një shkallë më lart në zhvillimin e saj ekonomik e kulturor, bëri një hap të ri përpara në rritjen e mirëqënies së masave dhe në forcimin e mbrojtjes së Atdheut.

Pesë vjetët që kanë kaluar nga koha kur u mbajt Kongresi i 7-të, janë një periudhë lufte heroike e masave tona punonjëse në të gjitha frontet për të çuar edhe më përpara ndërtimin socialist, për ta begatuar e lulëzuar edhe më shumë jetën tonë të re. Nën udhëheqjen e Partisë dhe me besim të patundur në vijën e saj të drejtë, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, rinia dhe inteligjencia, i shkrinë pa kursim forcat e tyre fizike e mendore për të përballuar e kapërcyer me sukses vështirësitë e rritjes socialiste, si dhe ato që na krijuan armiqëtë e jashtëm.

Ashtu si në kongreset e mëparshme, edhe në të tanishmin Partia janë vjen ballëlart e faqebardhë, pse detyrat e mëdha që mori përsipër, i plotësoi me sukses, pse besimin e patundur që ka populli tek ajo, e justifikoi plotësisht. Populli ynë mund të jetë i kënaqur nga puna dhe mundi i tij. Kjo ka qenë një punë krijuese dhe e frytshme, që i solli atij gëzime e përparime të reja, që e bëri atë më optimist e më të lumtur.

Industrializimi i vendit edhe gjatë planit të gjashtë pesëvjeçar eci përpara pa u ndalur. Vlerësimi i pasurive tona minerare dhe i lëndëve të tjera të para të vendit arriti një shkallë më të lartë. Me ngritjen e objekteve të reja, siç qenë kombinati metalurgjik «Çeliku i

Partisë», Uzina e Ferrokromit, ajo e Pirometalurgjisë, Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës etj., një pjesë e konsiderueshme e tyre tanë transformohet dhe përpunohet në vend, duke krijuar kështu një bazë të shëndoshë e të sigurt për zhvillimin e tërë ekonomisë. Ky është një sukses i vijës së drejtë të Partisë, siç është edhe sigurimi i bazës së fuqishme energjetike, që u zgjerua akoma më shumë me vënien e plotë në funksionim të turbinave të hidrocentralit «Drita e Partisë».

Bujqësia janë bëri hapa të rinj e të mëdhenj në të gjitha drejtimet. Orientimi i Partisë për ta shndërruar atë në një bujqësi socialiste të prodhimit të madh modern, mbi një bazë gjithnjë e më të fuqishme teknike e duke e mbështetur në dijet më të reja agroteknike, u provua në praktikë se ishte një orientim i drejtë e plotësishët i realizueshëm. Shtimi nga viti në vit i produkteve bujqësore e blegtoreale, plotësimi gjithnjë e më mirë i nevojave të popullsisë e të industrisë me këto produkte e vërtetojnë plotësishët këtë gjë.

Përparime të dukshme janë bërë në fushën e kulturës e të arsimt. Kultura janë e zhvilloi dhe e thelloi më tej përbajtjen sociale, fisionominë e saj kombëtare dhe frymën popullore. Kultura dhe të gjitha vlerat e saj po hyjnë më shumë në masat. Është meritë e kulturës sonë të re që ajo ka përballuar presionet e ndikimet e ndryshme të kulturës borgjeze e revizioniste duke ruajtur originalitetin dhe tiparet e saj sociale. Arsimi populor eci përpara duke plotësuar e zbatuar porositë e Partisë për të siguruar shkollimin e gjerë të brezit të ri dhe për t'i dhënë vendit specialistë në nivelin që kërkon zhvillimi ynë në etapën e tanishme dhe në të ardhmen.

Në këtë periudhë të rëndë krizash që kanë përfshirë botën kapitaliste e revizioniste, ku ka tronditje të shumta politike, stanjacion e rënie të prodhimit, ulje të nivelit të jetesës dhe dekadencë të vlerave morale, të ne ka stabilitet të plotë ekonomik e politik, shoqëria është e shëndoshë, njerëzit janë të sigurt për të sotmen e për të ardhmen. Gjatë pesëvjeçarit që kaloi, një kontigjent i madh njerëzish, të edukuar dhe të arsimuar nga Partia e pushteti ynë popullor, janë futur për herë të parë në punë, duke e shtuar e fuqizuar edhe më shumë armatën e madhe të punonjësve të qytetit e të fshatit. Rëndësia e këtij fakti bëhet edhe më e madhe po të kemi parasysh se sot në botë jo vetëm që nuk i sigurohet punë brezit të ri, por mbeten pa punë edhe nga brezi i vjetër.

Pushteti ynë popullor është forcuar e demokratizuar më tej. Pjesëmarrja e masave në qeverisjen e vendit është bërë më aktive dhe është ngritur në një nivel më të lartë. Është zgjeruar më tej demokracia janë krijuar kushte më të mira që njerëzit t'i gjëzojnë sa më të plota të drejtat e garantuara dhe të realizojnë më mirë detyrat e tyre ndaj shoqërisë.

Situata e brendshme s'ka qenë kurrrë më e fortë se sot. Kompaktesia e uniteti i popullit, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste, bashkëpunimi dhe solidariteti midis shtresave të ndryshme të shoqërisë sonë janë forcuar e konsoliduar më tej. Lidhjet e Partisë me popullin janë çelikosur, besimi reciprok është kalitur akoma më shumë.

Shprehje e shkëlqyer e këtij uniteti të madh është ajo vendosmëri, ai hov dhe ai heroizëm me të cilin populli ynë lufton për realizim

min e detyrave që shtron Partia, për kapërcimin e vështirësive të ndryshme që kanë dalë në rrugën tonë, për përballimin me sukses të blokadës dhe të rrithimit imperialisto-revisionist.

Shqipëria sociale, në sajë të vijës së drejtë dhe të kujdesit të veçantë të Partisë, ka sot një mbrojtje të sigurt e të pathyeshme. Populli dhe ushtria janë e mbajnë kurdoherë lart vigjilencën, qëndrojnë sypatembur e të gatshëm për mbrojtjen e lirisë e të pavarësise së Atdheut, të fitoreve të socializmit.

Vendin tonë e nderojnë dhe e respektojnë popujt dhe shtetet përparimtare e paqedashëse, kudo në botë. Pozita e tij ndërkomëtare është e fortë. Miqtë e dashamirët e tij shtohen e shumohen nga dita në ditë. Lufta e vendosur e parimore kundër imperializmit e revolucionizmit modern e ka rritur simpatinë e dashurinë e marksistë-leninistëve, të revolucionarëve, të njerëzve të ndershëm e demokratë për Partinë e Punës dhe Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Partia dhe populli ynë i bënë ballë me sukses provës së rëndë në të cilën e vuri vendin tonë prerja e menjëherësme dhe brutale e marrëdhënieve ekonomike nga ana e Kinës. Revisionistët kinezë menduan se me veprimin e tyre armiqësor do të goroditnin ekonominë tonë dhe do të ndalonin për një kohë të gjatë zhvillimin e saj, do të detyronin Shqipërinë të bënte lëshime politike e ideologjike, t'u nderte dorën të huajve dhe të kërkonte përkrahje e ndihmë nga jashtë. Por ata, e pas tyre edhe reaksioni ndërkomëtar, që shpresoi se Shqipëria do të detyrohej të ndërronte rrugë, dështuan plotësishët. Vështirësitet e krijuara populli ynë i kapërceu me një pjakuri të madhe politike e me fryshtë të lartë patriotike, me një mobilizim të ri të forcave dhe me bindje të thellë në fitoren e luftës së tij.

Në Kongresin e saj të 8-të Partia janë vjen e kalitur në betejë të reja dhe me një përvjetojë më të pasur. Ajo vjen si një armatë e madhe dhe e edukuar me ideologjinë proletare, marksiste-leniniste, me një unitet të fortë të brendshëm dhe e lidhur ngushtë me popullin, me aftesi të rritura organizuese, mobilizuese e drejtuese, e gatshme të marrë përsipër, si gjithnjë, detyra të reja e më të mëdha dhe t'i realizojë ato, si gjithmonë, me sukses.

Mbajtja e këtij Kongresi koïncidon me një përvjetor të lavdishëm, me përvjetorin e themelimit të Partisë sonë heroike të Punës. Dyzet vjet më parë populli ynë u besoi komunistëve shqiptarë fatet e tij, jetën dhe të ardhmen e Atdheut. Partia janë e justifikoi këtë besim me veprën e saj të lavdishme, me fitoren e revolucionit dhe me krijimin e Shqipërisë së re sociale. E fryshtuar nga besimi i popullit dhe e ndërgjegjshme për përgjegjësinë historike e për misionin e lartë që mori përsipër, ajo e udhëhoqi popullin shqiptar me mendje të mprehtë e dorë të sigurt nga njëra betejë në tjetrën, nga njëra fitore në tjetrën.

Realizimet madhështore, të arritura në vitet e jetës sonë të lirë, nën udhëheqjen e Partisë, treguan se socializmin në Shqipëri, lirinë e pavarësinë e Atdheut tonë, perspektivën tonë të ndritur s'ka forcë që t'i tronditë e t'i errësojë. Ndjekja me konsekuençë e parimit marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta, politika e krijimit të një industrie moderne të mbështetur në lëndët e para të vendit dhe të

një bujqësie që garanton ushqimin e popullit me produktet e veta, përgatitja e kuadrove të mjaftueshmë, teknikë e shkencorë, të aftë për të punuar e për të drejtuar në çdo sektor, kanë qenë shpëtimtare në të gjitha drejtimet. Është kjo politikë e urtë e largpamëse e Partisë që ka krijuar atë bazë të sigurt mbi të cilën mbështetet zhvillimi ynë i pandalshëm ekonomik e kulturor, garantohet rruga jonë socialiste.

Arritja e pavarësisë ekonomike krahas asaj politike, sigurimi i mbrojtjes së vendit nga vetë populli ynë, edukimi dhe armatosja e masave punonjëse me ideologjinë marksiste-leniniste janë ato shtylla të forta e të palëkundshme mbi të cilat qëndron kalaja jonë socialistë, janë tiparet themelore që karakterizojnë një shtet me të vërtetë socialist. Këto realizime, të marra në tërësi, përbëjnë edhe përvojën historike të socializmit në Shqipëri. Përvoja e Shqipërisë tregon se edhe një vend i vogël e me një bazë materialo-teknike të prapambeut mund të arrijë një zhvillim ekonomik e kulturor shumë të shpejtë e të gjithanshëm, mund të sigurojë pavarësinë e tij e të përballojë sulmet e kapitalizmit e të imperializmit botëror, kur udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste, kur është i vendosur të lufnjë parti e vërtetë marksiste-leniniste, kur ka besim se mund t'i realizojë deri në fund për idealet e tij dhe kur ka besim se mund t'i realizojë ato.

Në rrugën e ndritur nëpër të cilën ka ecur gjatë dyzet vjetëve të jetës së saj, Partia e Punës e Shqipërisë do të ecë me vendosmëri e pa u lëkundur edhe në të ardhmen. E lidhur si mishi me kockën me popullin, në krye të tij dhe bashkë me të, ajo do të luftojë me devotshmëri e pa marrë parasysh asnë sakrificë, për t'u siguruar një rrezve tanë, Atdheut tonë socialist përparime e fitore të reja.

I

Zhvillimi i ekonomisë dhe detyrat e Partisë

Ekonomia jonë socialistë hyn në pesëvjeçarin e ri të zhvillimit të saj e stabilizuar, plot dinamizëm dhe me mundësi të mëdha për të zhvilluar e zgjeruar më tej prodhimin shoqëror, për të rritur efektivitetin e saj në të gjitha drejtimet.

Detyrat kryesore të planit të gjashtë pesëvjeçar u plotësuan në përgjithësi me sukses. Kjo e ka fuqizuar edhe më shumë bazën materialo-teknike të vendit, ka shtuar më tej burimet e lëndëve të para e të energjisë, ka siguruar kushte më të mira për një zhvillim të harmonishëm, të vrullshëm e të pandalshëm të ekonomisë. Gjatë pesëvjeçarit të kaluar vazhdoi zhvillimi me ritme të shpejta i forcave prodhuese, u thellua më tej zhvillimi intensiv i ekonomisë dhe revolucioni tekniko-shkencor njohu përparime të reja të rëndësishme. Industria, bujqësia dhe degët e tjera të ekonomisë ecën më përpara. Në vitin 1980, kundrejt vitit 1975, prodhimi shoqëror u rrit afro 25 për qind dhe prodhimi industrial mbi 34 për qind, me një ritëm 2 deri 3 herë më të shpejtë se ritmi i shtimit të popullsise.

Duke zbatuar me konsekuençë politikën ekonomike të Partisë u bënë përmirësimë të ndjeshme në strukturën e prodhimit industrial dhe u rrit pesha specifike e mjeteve të prodhimit. Industria plotësoi më mirë nevojat e popullit, u rrit roli i saj për zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë dhe për mbrojtjen e vendit.

Në krahasin me pesëvjeçarin e pestë, prodhimi bujqësor u rrit mbi 21 për qind. Bujqësia plotësoi nevojat e vendit për drithëra buke, për produkte ushqimore e përlendët e para më të domosdoshme dhe rriti vëllimin e eksportit të produkteve bujqësore.

Për plotësimin e detyrate të planit të gjashtë pesëvjeçar Partia dhe shteti ynë shfrytëzuan në një shkallë më të lartë burimet e mundësítë e brendshme të vendit. U sigurua financimi i pandërpërre i zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, u ndërtuan dhe u vunë në shfrytëzim rreth 300 vepra të rëndësishme dhe eksporti i mallrave u rrit mbi 51 për qind.

Fuqia ekonomike në rritje dhe zbatimi i një yargu masash me karakter ekonomiko-shoqëror garantuan mirëqenien e arritur të popullit dhe çuan në ngritjen e mëtejshme të saj. Të ardhurat reale përfrymë të popullsisë u rritën si në qytet edhe në fshat. Qarkullimi i mallrave me pakicë u shtua afro 20 për qind. U përmirësuan më tej kushtet e strehimit të popullit dhe u morën masa për zgjerimin e shërbimeve sociale. Shkollat e larta i mbáruan afro 20 mijë veta dhe ato të mesmet mbi 113 mijë ose 57 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e pestë.

Këto arritje në zhvillimin e përgjithshëm ekonomiko-shoqëror të vendit marrin një kuptim të veçantë po të kemi parasysh atë që po ndodh në botën kapitalisto-revizioniste, ku kriza ekonomike, me pa sojat e saj të rënda për masat punonjëse dhe për tërë jetën e vendit, ka shkaktuar stanacione e rënie të prodhimit. Këto arritje shënojnë një fitore të madhe për Partinë dhe popullin tonë.

Nga tribuna e këtij Kongresi, në emër të Partisë e të popullit, përshtendës dhe përgëzoj punëtorët, specialistët dhe kuadrot e ndërtimit e të industrisë, të cilët, edhe në rrëthanat e vështira që na krijuan revizionistët kinezë, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, i dolën zot punës dhe ditën të ndërtojnë e të vënë në shfrytëzim veprat e mëdha të pesëvjeçarit të gjashtë, të cilat e fuqizuan më tej atdheun tonë socialist.

Me gjithë sukseset e arritura, ne jemi të ndërgjegjshëm edhe për mosplotësimin e disa detyrate të planit pesëvjeçar, si në investimet e në ndërtimet, në prodhimin bujqësor, në disa produkte industriale dhe në rendimentin e punës. Partia, organet e shtetit dhe kolektivat punonjës i kanë analizuar me vëmendje këto mosrealizime dhe kanë nxjerrë mësimë për të mënjanuar dobësitë e të metat e punës organizuese e drejtuese në ekonomi.

Realizimet e mëdha me rëndësi historike që janë arritur deri sot në të gjitha fushat, si dhe përvoja e pasur e fituar në punën dhe në luftën e Partisë e të popullit për ndërtimin dhe mbrojtjen e socialistë, përbëjnë një mbështetje të fuqishme politike, ekonomike e shoqërore për të ecur me siguri dhe me guxim përpara.

Komiteti Qendror, në bazë të vijës së përgjithshme dhe të politikës ekonomike të Partisë për ndërtimin e socialistë, pas një punë

dhe studimi të gjithanshëm, pas një konsultimi të gjerë popullor, përgatiti Projektdirektivat për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për periudhën 1981-1985, të cilat ia paragjet për shqyrtim e miratim Kongresit. Detyra themelore e këtij pesëvjeçari është: «Zhvillimi i përgjithshëm i ekonomisë, duke u mbështetur tërësisht në forcat tona, mbi bazën e thellimit të industrializimit socialist të vendit, të fuqizimit e të intensifikimit të bujqësisë, të rritjes së efektivitetit të ekonomisë, të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe të përsosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim, me qëllim që të garantohen dhe të ngrihen gradualisht mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i masave punonjëse, të forcohen më tej rendi socialist dhe fuqia mbrojtëse e atdheut».

Në këtë detyrë sintetizohen drejtimet dhe objektivat kryesore të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës gjatë pesëvjeçarit të shtatë, i cili dallohet nga një varg karakteristikash të veçanta.

Ky është i pari plan pesëvjeçar që do të realizohet duke u mbështetur plotësisht në forcat e në mundësitet tona. Shqipëria është sot i vetmi vend në botë që zhvillohet dhe ecën përparrë në rrugën e socializmit pa asnjë lloj ndihme e kredie nga jashtë. Kjo është një provë e madhe, por e lavdishme për popullin e Partinë tonë dhe fitorja është e sigurt, sepse, duke ecur në bazë të marksizëm-leninizmit, jemi përgatitur me kohë për këtë hap vendimtar.

Plani i ri pesëvjeçar përmban objektiva e detyra më të mëdha se çdo plan tjetër, të cilat janë të bazuara shkencërisht dhe plotësisht të realizueshme. Për të pesë vjetët, 1981-1985, vëllimi i prodhimit shoqëror dhe i investimeve do të jetë më i madh se vëllimi i realizuar gjatë katër pesëvjeçarëve të parë të marrë së bashku, ndërsa vëllimi i eksportit do të jetë akoma më i madh. Në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, prodhimi shoqëror parashikohet të rritet 34 deri 36 për qind, më një ritëm mesatar vjetor prej 6,4 për qind. Fondet për investime dhe ndërtime do të përdoren për ngritjen e afro 750 veprave të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës.

Me mundësitet që krijohen nga rritja e prodhimit dhe e të ardhurave kombëtare, në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, foni i konsumit të popullit parashikohet të rritet 21 për qind dhe qarkullimi i mallrave me pakicë 22 deri 24 për qind. Detyra të rëndësishme parashikohen për zhvillimin e arsimit e të kulturës, për shëndetësinë, strehimin dhe shërbimet e tjera jetësore.

Në caktimin e këtyre detyrave e ritmeve janë pasur parasysh si mundësitet që ka dhe që do të krijojë ekonomia, ashtu edhe nevojat për zhvillimin e ekonomisë, për zënien me punë të forcave të reja aktive, për fuqizimin e mbrojtjes së vendit, për shtimin e rezervave, për zhvillimin e sektorëve social-kulturorë, si dhe për plotësimin gjithnjë e më mirë të kërkeseve në rritje të popullsisë. Mjaft nga detyrat e këtij pesëvjeçari, sidomos ato që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e rezervave të naftës e të mineraleve, me caktimin e investimeve etj., janë parë në lidhje të ngushtë edhe me zhvillimin e ekonomisë në pesëvjeçarët e ardhshëm, kur do të ballafaqohemi me nevoja e kërkesa akoma më të mëdha.

Gjatë pesëvjeçarit të shtatë do të bëhen disa përmirësime të rëndësishme strukturore në fushën e prodhimit, të qarkullimit të mallrave

e të konsumit të popullit. Këto përmirësime do të përfshijnë burimet energetike, metalurgjinë e zezë, industrinë mekanike, bujqësinë, transportet, financat dhe mallrat e konsumit të gjerë etj. Përmirësimet e parashikuara do të cojnë përparrë intensifikimin e ekonomisë, do të rritin efektivitetin e saj, do ta bëjnë atë më të aftë për të plotësuar nevojat e vendit dhe për t'i bërë ballë më mirë rrëthimit e blokadës, si dhe presionit të krizës ekonomike të botës kapitaliste e revisioniste.

Zhvillimi dhe fuqizimi i bazës materialo-teknike të vendit, si kurdoherë, do të bëhet në lidhje të ngushtë me përsosjen e anëve të ndryshme të marrëdhënieve ekonomike në qytet e sidomos në fshat. Masa të rëndësishme janë zbatuar e po zbatohen për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kooperativist dhe për ngushtimin e oborrit, përzgjerimin e specializimit e të kooperimit, për forcimin e organizimit e të drejtimit të prodhimit, për një lidhje më të mirë të shpërbimit të punës me sasinë, cilësinë, kursimin dhe me plotësimin e detyrave të planit. Këto masa do të çohen akoma më përparrë, me synim që të forcohet pareshtur rendi ynë socialist...

1. Fuqizimi i mëtejshëm i industrisë – faktor vendimtar përpërparimin e përgjithshëm të vendit

Në politikën ekonomike të Partisë vendin kryesor e ka zënë dhe e zë industrializimi socialist i vendit, i cili, nga njëri pesëvjeçar në tjetrin është zhvilluar si një proces i madh dhe i pandalshëm. Ai ka qenë dhe është një faktor vendimtar përpërparimin e përgjithshëm të vendit në rrugën e socializmit. Krijimi dhe fuqizimi i industrisë sonë shumëdegshe, të rëndë e të lehtë, të mbështetur fuqimisht në burimet e në pasuritë tona dhe me përspektiva të qarta zhvillimi, është vepër monumentale e Partisë dhe e popullit tonë, e arritur me shumë punë, sakrifica dhe me një heroizëm të pashoq, është vepër me rëndësi historike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në pesëvjeçarin e shtatë industria jonë do të ecë akoma më përparrë dhe do të zhvillohet në front të gjerë. Për këtë degë do të përdoren afro 46 për qind e të gjitha investimeve të pesëvjeçarit. Politika e Partisë për zhvillimin e industrisë synon: të konsolidohet struktura shumëdegshe e industrisë, duke i dhënë si gjithnjë përpërparësi industrisë së rëndë; të ruhet dhe të përmirësohet më tej bilanci pozitiv i burimeve energetike, duke i kushtuar rëndësi të veçantë industrisë së naftës; të zhvillohet më tej industria nxjerrëse minerare dhe ajo përpunuese, duke u futur edhe në shfrytëzimin e mineraleve të reja; të bëhen përmirësime të ndjeshme në strukturën e mjetave të prodhimit e të mallrave të konsumit; industria të vihet akoma më shumë në shërbim të intensifikimit të bujqësisë; të rriten aftësitë prodhuese ekzistuese nëpërmjet rikonstruksionit dhe modernizimit të tyre.

Duke ecur me vendosmëri në këtë rrugë, prodhimi industrial do të vazhdojë të rritet me ritme të shpejta. Në vitin 1985 kundrejt viti 1980 ai do të rritet 36 deri 38 për qind. Ky zhvillim material, i lidhur ngushtë edhe me një varg faktorësh të tjerë ekonomikë e shoqërorë, do të bëjë të mundur që vendi ynë të ecë përparrë si një vend me industri dhe bujqësi të përparruar.

Një vëmendje të posaçme Partia u kushton industrisë energjetike, nxjerrjes së naftës, të gazit e të qomyrgurit, prodhimit të energjisë elektrike. Ne kemi krijuar një sistem të fuqishëm e të pavarur energetik, që plotëson nevojat në rritje të vendit për energji dhe siguron nga eksporti i saj të ardhura të rendësishme valutore. Kjo është një fitore e madhe e politikës së drejtë të Partisë, është një mbështetje e sigurt për zhvillimin e tërë ekonomisë kombëtare.

Kjo fitore duhet konsoliduar dhe çuar më tej, në radhë të parë duke bërë investime e duke shtuar prodhimin, por edhe duke përdorur me kursim maksimal, me kontroll të rreptë e me nikoqirillëk të gjitha burimet tona energjetike. Zgjidhja e këtyre problemeve kërkon një punë të organizuar mirë, të disiplinuar, sistematike, me baza të shëndosha shkencore e metodike. Zhvillimi i kësaj dege nevralgjike me rendësi kapitale e strategjike shtrohet si një detyrë imperative, sidomos në kushtet e krisës energjetike botërore.

Nxjerra dhe përpunimi i naftës e i gazit do të zënë vendin kryesor në burimet tona energjetike. Në vitin 1985 kundrejt viti 1980 nxjerra e naftës do të rritet 58 deri 60 për qind. Kjo është një detyrë madhe dhe plotësish e realizueshme, sepse mbështetet në vendburimet ekzistuese dhe në rezervat e njohura e të përvetësuara.

Realizimi i detyrave për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, si dhe rritja e efektivitetit të shpenzimeve të mëdha që bëhen në këtë degë të industrisë, kërkojnë që naftëtarët, specialisët e kuadrot t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përsosjes së metodave të kërkimit dhe të nxjerrjes së tyre, duke u mbështetur plotësish në arritjet e shkencës, në zbatimin e një discipline të fortë teknike dhe të punës.

Shpenzimet për nxjerrjen e naftës e të gazit të bëhen mbi bazën e studimeve të thelluara e me përgjegjësi. Të merren masa të plota teknike, organizative dhe materiale për të shtuar nxjerrjen e naftës jo vetëm nga vendburimet e reja, por edhe nga ato të vjetrat, duke përdorur shumë më mirë se deri tani metodat intensifikuese e të dyta. Në këtë sektor jetik të ecim me ekonomi, me rezerva të sigurta e të njohura dhe të shfrytëzojmë naftën e gazin me nikoqirillëk, duke menduar për sot e për nesër. Forcat shkencore e teknike të angazhohen më shumë për të shpejtuar vënien në shfrytëzim dhe me efektivitet të lartë të rërave bituminoze, të kësaj pasurie të madhe të vendit që duhet futur sa më parë në qarkullim ekonomik.

Një vend të rendësishëm në burimet energjetike të vendit zë qomyrguri, që është një lëndë djegëse masive dhe me leverdi të madhe ekonomike. Në vitin 1985 nxjerra e qomyrgurit do të rritet 48 për qind më shumë se në vitin 1980. Kjo është një detyrë e madhe për realizimin e së cilës kërkohet një punë këmbëngulëse nga punonjësit e këtij sektori.

Vëmendja të përqendrohet jo vetëm në shfrytëzimin racional të minierave qomyrgurore ekzistuese, por edhe në hapjen me rentabilitet të minierave të reja. Të zgjerohen kërkimet për qomyre me fuqi kalorifike më të lartë dhe të koksifikueshme. Të punohet kudo përzëvendësimin e karburanteve të lëngëta me qomyr dhe përkursimin e tij. Gjithashtu është e nevojshme të merren masa edhe për pasurimin e brikitimin e qomyreve, për të rritur leverdinë e përdorimit të tyre.

Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 1985 kundrejt viti 1980, do të rritet 16 për qind. Për t'u dalë përparrë nevojave në rritje për energji elektrike, si dhe për të shfrytëzuar intensivisht burimet hidrike, me të cilat vendi ynë është mjaf i pasur, gjatë këtij pesëvjeçari do të zhvillohen në përmasa të mëdha punimet përfundimin e hidrocentralit të Komanit, që do të jetë më i fuqishëm nga çdo hidrocentral i ndërtuar deri tani, dhe do të bëhen përgatitjet për ndërtimin e hidrocentraleve të tjera, të mëdha e të vogla, për të përballuar jo vetëm nevojat për sot e në perspektivë, por edhe për të rritur eksportimin e energjisë elektrike.

Prodhimi dhe përdorimi i energjisë elektrike duhet të shikohen në unitet. Partia, organet shtetërore dhe ekonomike të punojnë që të ndryshojnë konceptet e njerëzve, me qëllim që energjia elektrike të vlerësohet si një pasuri e madhe kombëtare, të përdoret me kursim e me kontroll të rreptë në çdo fushë, veçanërisht në atë të prodhimit material, ku duhet të vendosen normativa të studiuara shkencërisht për çdo kilovat të harxhuar.

Perspektiva të gjera i hap pesëvjeçari i shtatë industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve të dobishme. Nxjerra e mineraleve të njohura të kromit, të bakrit, të hekur-nikelit do të vazhdojë të rritet në përmasa të mëdha, nga 30 për qind deri mbi 2 herë më shumë. Tani janë krijuar kushtet që të rritet edhe nxjerra e mineraleve të tjera të dobishme, siç janë fosforitet, kuarcitet, kripa e gurit, dolomit, olinvinitet, bokset etj.

Nevojat e sotme dhe të perspektivës shtrojnë detyrën e zgjerimit të nxjerrjes e të pasurimit të mineraleve të varfra dhe të rritjes së shkallës së përfitimit të elementeve të dobishme, për të ngritur vlerën e pasurive tona minerale, për të shfrytëzuar edhe ato vendburime, të vjetra ose të reja, që janë të varfra nga cilësia, por të pasura nga rezervat.

Gjeologëve dhe gjithë kërkuesve të tjerë të mineraleve u vihet detyra që, mbi bazën e përgjithësimeve e të ligjësive shkencore, duke përdorur me guxim metoda të reja e komplekse, si dhe duke përsosur organizimin e punës, të rritin efektivitetin e shpimeve dhe rezervat e këtyre mineraleve, sidomos në minierat ekzistuese, të zbulojnë minerale e vendburime të reja në masivet me perspektivë e të pashkelura.

Punëtorët dhe specialistët e minierave t'u kushtojnë rendësi të veçantë përsosjes së teknikës dhe të teknologjisë së nxjerrjes, rritjes së shkallës së mekanizmit dhe të kualifikimit në punë, për të arritur një kthesë të dukshme në cilësinë e prodhimit, për të ulur shpenzimet dhe për të pakësuar varfërimet e humbjet e mineralit.

Metalurgjisë në përgjithësi dhe siderurgjisë në veçanti do t'u kushtohet vëmendje e posaçme jo vetëm për të thelluar përpunimin me

cikël të plotë të mineraleve tona kryesore, por edhe për të forcuar pavarësinë e ekonomisë sonë nga importi. Prandaj metalurgët tanë mobilizojnë, të gjitha forcat dhe aftësitë e tyre për të njojur e përtë vetësuar me disiplinë të rreptë e në baza shkencore teknologjinë e shkrirjes së mineraleve dhe të përpunimit të shumëlojshëm të metaleve, për të shfrytëzuar në kompleks gjithë përbajtjen e dobishme kryesore e shoqëruese që ato kanë, për të ulur shpenzimet materiale dhe të energjisë, të cilat ende janë të larta. Studime të thelluara dhe pëpunë intensive kërkojnë zgjerimet e mëdha që do të vazhdojnë të bëhen në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» për ngritjen e uzinave të tubave të llojeve të ndryshme, të llamarinës së petëzuar dhe të prodhimeve karbonike.

Tani që kemi çelikun tonë dhe kemi ngritur një industri të fuqishtë mekanike, janë krijuar kushte që para kësaj dege të vihen detyra më të mëdha. Prodhimi i industrisë mekanike në vitin 1985 do të jetë 43 deri 45 përditës më i madh se në vitin 1980.

Industria mekanike e realizoi mirë detyrën që i caktoi Kongresi i 7-të i Partisë për prodhimin e pjesëve të ndërrimit, duke plotësuar 95 përditës më të nevojave që ka ekonomia për to. Në këtë pesëvjeçar do të duhet të konsolidohet kjo arritje, duke përmirësuar rrënjesorinë dhe duke rritur shumë ripërtëritjen e pjesëve të ndërrimit.

Në vitet e këtij pesëvjeçari industria mekanike do të futet në një shkallë më të gjerë në prodhimin e pajisjeve dhe të makinerive përendërtimin e linjave e të fabrikave të reja, për rikonstruksione e zgjerrime të ndryshme të aftësive prodhuese. Realizimi i një detyre të tillë kërkon që të përmirësohet organizimi e drejtimit i kësaj dege të industrisë, të vihen mbi baza sa më shkencore teknologjia e përpunimit, planifikimi, kooperimi dhe standardizimi i prodhimit.

Masa urgjente e të plota të merren sidomos për përgatitjen e projekteve teknologjike e konstruktive të pajisjeve e të makinerive përobjektet e reja e për rikonstruksionet që do të kryhen gjatë pesëvjeçarit. Shumë nga këto pajisje e makineri do të prodhohen për herë të parë. Projektimi dhe prodhimi në kohë e me cilësi i tyre është një ndër detyrat më të vështira që duhet të përballojë industria jonë mekanike.

Futja e industrisë mekanike në rrugën e gjerë të prodhimit të makinerive shtron me forcë nevojën e kualifikimit të njerëzve e të zhvillimit të mendimit të tyre krijuar, nevojën e përgatitjes së kuadrove të lartë e të mesëm edhe për profile të ngushta e specialitete të veçanta, duke bërë për këtë qëllim ndryshimet përkatëse në programet e shkollave profesionale e të Universitetit.

Zhvillim e zgjerim të madh do të marrë në këtë pesëvjeçar industria kimike. Prodhimi i saj në vitin 1985 kundrejt vitit 1980 do të rritet 63 deri 65 përditës. Rëndësi e vegantë do t'i kushtohet shtimit të prodhimit të plehrave fosfatike dhe kimikateve për mbrojtjen e bimëve. Duke pasur tani mjaft prodhime bazë dhe një varg mbetjesh industriale e komponimesh shoqëruese të mineraleve, kimistët dhe specialistët e tjerë duhet të studiojnë e të realizojnë një gamë shumë më të gjerë prodhimesh e reagentësh kimikë, për të ulur sa më parë importin e tyre. Fillimet e sintezës kimike gjithashtu duhen çuar përpara, duke u mbështetur kryesisht në lëndët e para të vendit dhe të

synohet që në një të ardhme jo të largët prodhimet e saj të bëhen një burim i mirë edhe për eksport.

Partia kurdoherë ka mbajtur parasysh që në zhvillimin e industrisë në tërësi në përputhje me nevojat e popullit, të rritet edhe produhimi i mallrave të konsumit të gjerë, duke siguruar një stabilitet e një përmirësim të vazhdueshëm të nivelit material e kulturor të masave punonjëse. Për këtë qëllim prodhimi i industrisë së lehtë e ushqimore gjatë pesëvjeçarit do të shtohet me ritme mbi 2 herë më të larta se ritmi i shtimit të popullsisë.

Në prodhimet e industrisë së lehtë e ushqimore është e nevojshme të bëhet një kthesë e vërtetë, të arrihet një përmirësim rrënjesor në strukturën e mallrave, në assortimentet, në cilësinë, në ambalazhimin e në uljen e kostos së tyre. Kjo kthesë mund të bëhet vetëm me masa të plota dhe efektive në fushën e organizimit e të drejtimit, të planifikimit e të teknologjisë së prodhimit. Mbi të gjitha duhet të ndryshohen plotësish konceptet artizanale, të zhvillohet fantazia dhe mendimi krijuar, të veprohet me shkathtësi e shpejtësi për të bëre ndryshimet pozitive, për t'i hapur kudo rrugë të gjerë së resë.

Për ngritjen dhe zhvillimin e industrisë janë bërë investime të mëdha dhe është përgatitur një armatë e tërë punonjësish të kualifikuar e të devotshëm, të cilët janë një mbështetje e fuqishme për zhvillimin e këtij sektori jetik të ekonomisë.

Realizimi i detyrave të mëdha që shtron Partia, kërkon që punonjësit e industrisë të rritin efektivitetin e prodhimit dhe rendimentin e punës, të ngrenë në një shkallë më të lartë krijuimtarinë e tyre. Ata duhet të shfrytëzojnë gjerësish aftësitë e shumta prodhuese që kanë në duar dhe të përvetësojnë sa më mirë objektet dhe linjat e reja që do të përfundojnë e do të vihen në shfrytëzim, si edhe ato që do të rikonstruktohen në vitet e pesëvjeçarit. Me guxim e vendosmëri dhe duke u mbështetur në të dhënat studimore e shkencore, të çojnë përpara e të modernizojnë teknologjinë e prodhimit, të përmirësojnë tresesit cilësorë e ata financiarë të tij.

Populli dhe Partia kanë besim të plotë se punonjësit e të gjitha degëve të industrisë, të ndërgjegjshëm për situatat që kalojmë, do të shumëfishojnë përpjekjet dhe luftën e tyre për arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të mëdha që po caktion ky Kongres për zhvillimin dhe fuqizimin e industrisë sonë socialiste...

6. Të përsosim drejtimin e ekonomisë dhe të rritim efektivitetin e saj

Drejtimi dhe organizimi janë një hallkë nga më të rëndësishmet pas së cilës duhet të kapemi fort për t'i çuar përpara punët kudo, në ekonomi, në arsim, në shkencë, në kulturë, në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore.

Në kushtet aktuale, kur ekonomia jonë është bërë një ekonomi e madhe e komplekse, ajo nuk mund të drejtohet e të ecë përpara me koncepte e praktika të cilave u ka kaluar koha. Sot nuk mund të punohet me empirizëm e prakticizëm të ngushtë. Drejtimi dhe organizimi duhet të mbështeten në njohuri e dije të thella, në parime dhe kritere

të shëndosha shkencore, që burojnë nga ligjet e zhvillimit ekonomik e shoqëror.

Drejtimi i ekonomisë në bazë të këtyre ligjeve kërkon qe problemet e zhvillimit të forcave prodhuese të shikohen kurdoherë të lidhura ngushtë me anët shoqërore të tyre, me të gjithë komponentët që përbëjnë jetën tonë socialiste. Kjo ka të bëjë me zbatimin në jetë, në mënyrë të planifikuar e të drejtuar mirë, të atij bashkëveprimi reciprok midis forcave prodhuese dhe marrëdhënieve ekonomike e të superstrukturës, që e pohojmë, por që në praktikë disa herë e harrojmë se e kalojmë shkarazi. Këto shfaqje të dëmshme duhet të mënjanohen e të luftohen, sepse bartin rrezikun e një drejtimi nga pozitat e ekonomizmit e të teknokratizmit.

Ekonomia popullore, si një ekonomi unike socialiste, drejtohet në bazë të parimit të centralizmit demokratik dhe të planit të përgjithshëm shtetëror. Në qoftë se cenohet sadopak ky parim, duke u nisur nga interesa të veganta e të ngushta, kjo tregon se nuk kuptohen thellë e nuk zbatohen drejt direktivat e Partisë, ligjet e ekonomisë dhe rregullat e shtetit tonë socialist. Prandaj të luftohen shfaqjet e dikasterializmit e të punës së myllur brenda rretheve ose institucioneve. Të forcohet bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës për problemet e ndryshme mbi bazën e vijës e të politikës së Partisë, për t'u dhënë rrugëzgjidhje të shpejtë problemeve në bazë të kompetencave që i janë dhënë se cilët.

Kryesorja është që secili, duke u udhëhequr nga vija, nga politika dhe ideologjia e Partisë, të realizojë detyrat e ngarkuara, t'i dalë zot punës, të tregojë iniciativë e këmbëngulje dhe të mbajë përgjegjësi të plotë për punën që kryen dhe sektorin ku drejtton e punon. Kërkimi dhe dhënia llogari për kompetencat dhe funksionet e caktuara, për realizimin e detyrave të planit, është një normë që buron nga rendi ynë shoqëror, nga parimi i centralizmit demokratik. Kjo normë duhet zbatuar pa asnjë lëshim në të gjitha instancat, pa lejuar kurrfarfë liberalizmi e sentimentalizmi mikroborgjez.

Partia ka theksuar vazhdimisht se socializmi është veper e masave të gjera punonjëse të udhëhequra prej saj. Këtej rrjedh domosdoshmëria objektive që masat punonjëse të marrin pjesë gjallërisht në drejtimin e jetës së vendit, të përvetësojnë artin e të drejtuarit të ekonomisë. Kjo çështje parimore duhet të ngulitet thellë në mendjen dhe në ndërgjegjen e të gjithëve. Të arrihet kudo që të gjithë punonjësit ta thonë fjalën e tyre ashtu siç mendojnë e gjykojnë vetë, të kritikojnë të metat dhe të gjithë ata që shkelin rregullat dhe disiplinën shtetërore, me qëllim që punët të ecin përpara.

Për organizimin dhe drejtimin shkencor të ekonomisë një rëndësi të vegantë ka hartimi i planeve reale dhe mobilizuese, të mbështetura në studime të gjithanshme për problemet aktuale e të perspektivës, në përgjithësimë dhe analiza të thelliuarë. Një punë më e kujdeshme duhet bërë edhe gjatë zbatimit të planit, duke zgjidhur drejt e shpejt problemet që dalin. Plani vërtet është ligj dhe zbatimi i tij është detyrë shtetërore, por kjo nuk duhet të pengojë marrjen e masave për të bërë ndryshime eventuale për përmirësimin e treguesve të tij sa herë që kjo është e domosdoshme dhe kur është e mundur.

Më shumë vëmendje t'i kushtohet kontrollit për zbatimin e pla-

nit. Ai duhet të jetë një kontroll i gjallë, veprues dhe i përditshëm, që jo vetëm të konstatojë të metat ose dobësitë, por t'u japë rrugëzgjidhje problemeve në vend. Sidomos duhet të forcohet kontrolli i brendshëm ekonomik, financiar dhe teknik në ndërmarrjet ekonomike dhe në kooperativat bujqësore. Organet e financës e të bankës duhet ta vënë kontrollin me anë të lekut në vendin që i takon dhe të rritin më shumë rolin aktiv të tyre në prodhim, në qarkullim e në shërbime, duke përdorur më me efikasitet e në rrugë të drejtë edhe levat e tjera të mëkanizmit tonë ekonomik.

Forcimi i drejtimit dhe i organizimit kërkon që të bëhen edhe përmirësimet e duhura në strukturat ekzistuese të organeve shtetërore dhe në organizma të ndryshëm të ekonomisë sa herë që kjo është e domosdoshme. Ashtu siç luftojmë që të shtojmë prodhimin dhe të përsosim teknologjinë e tij, po ashtu duhet të veprojmë për të ndryshuar format e metodat e vjetruara të drejtimit, duke vënë në zbatim struktura e forma të reja më efikase, më të gjalla dhe më pak të kushtueshme.

Puna drejtuese e organizuese duhet të shprehet në shtimin e prodhimit dhe në rritjen e efektivitetit të shpenzimeve në të gjitha fushat e veprimitarisë ekonomike. Gjatë pesëvjeçarit të shtatë të ardhurat kombëtare do të rriten më shpejt se prodhimi shoqëror; shtesa e tyre do të sigurohet në masën mbi 46 për qind nga rritja e rendimentit të punës; në industri e në ndërtim rendimenti i punës do të rritet 2 deri 3 herë më shpejt se në pesëvjeçarin e kaluar; rritja e së ardhurës neto në ndërmarrje do të realizohet në pjesën më të madhe nga ulja e kostos në prodhim, në ndërtim, në shërbime.

Nga plotësimi i këtyre objektivave varet në një shkallë të madhe zhvillimi i drejtë përpjeshëtimor i gjithë ekonomisë, realizimi i ritmeve të parashikuara dhe i të gjitha detyrave të planit me forcat tona. Rrugët për arritjen e tyre duhen kërkuar në prodhim, në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, në zgjerimin e mekanizimit, në forcimin e disiplinës dhe në shfrytëzimin e kohës së punës, në uljen e kostos, në përdorimin racional të bazës materiale e tekniqe, pra, në zbulimin e shfrytëzimin e të gjitha rezervave të brendshme të ekonomisë, duke u mbështetur fuqimisht në përvojën e përparuar dhe në arritjet e shkencës e të teknikës.

Puna e njerëzve, me cilësi e me rendiment të lartë, është faktori vendimtar për të siguruar rritjen e efektivitetit të prodhimit e për të çuar përpara tërë ekonominë. Kjo kërkon të ngrihet kualifikimi i punonjësve, të zhvillohet iniciativa dhe krijimtaria e tyre, të bëhen ata të ndërgjegjshëm për rendësinë dhe mundësinë e realizimit të detyrave të planit.

Një problem tjetër i madh që lidhet drejtpërdrejt me drejtimin, me organizimin e ekonomisë dhe me rritjen e efektivitetit të saj është zgjerimi dhe forcimi i kooperimit në të gjitha fushat e veprimitarise ekonomike e shoqërore. Kjo diktohet nga thellimi i ndarjes shoqërore të punës dhe i lidhjeve ekonomike. Prodhimi është pasuruar me degë e aktivitete të shumta, forcat prodhuase janë shtrirë në të gjithë vendin. Është thelluar specializimi i veprimtarive prodhuuese dhe kanë ecur përpara shkenca e teknika. Në këto kushte mungesa e koope-

rimit dhe e bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme jo vetëm nuk lejon të shfrytëzohen epërsitë e ekonomisë socialiste si një ekonomi unike, por pengon edhe zhvillimin e saj me ritme të shpejtë.

Në këtë kuadër kërkohet një kuptim dhe zbatim më i thelli dhe më i plotë i parimit të mbështetjes në forcat e veta në fushën e ekonomisë dhe në çdo fushë tjetër. Në raport me botën e jashtme vendi ynë e zbaton këtë parim si një trup i vetëm, domethënë të gjithë së bashku, të gjitha degët dhe sektorët e ekonomisë sigurojnë dhe duhet të sigurojnë me çdo kusht pavarësinë dhe zhvillimin e pandalshëm të vendit. Mbështetja në forcat e veta në planin e brendshëm të degëve ekonomike, të rretheve, të ndërmarrjeve, të kooperativave, duhet kuptuar si një luftë krah për krah, në solidaritet të fortë socialist, në kooperim dhe në bashkëpunim të ngushtë e të gjithanshëm me njëri-tjetrin për plotësimin e detyrave të planit unik e të përgjithshëm shtetëror.

Rruja nëpër të cilën ka ecur dhe ecën ekonomia jonë është një rrugë e drejtë marksiste-leniniste. Dëshmi e qartë dhe konkrete përkëtë janë qëndrueshmëria, vitaliteti dhe dinamizmi i saj. Këto tipare themelore të ekonomisë sonë socialiste do të konsolidohen e do të çohen akoma më përpara me luftën dhe përpjekjet e klasës punëtore, të fshatarësësë kooperativiste dhe të inteligjencës populllore, nën udhëheqjen e Partisë, për të vënë në jetë objektivat e planit të shtatë pesëvjeçar, që po miratojmë në këtë Kongres...

... Socializmi kërkon njerëz me kulturë
të gjerë e dije shkencore

Te ne është bërë një revolucion i vërtetë në nivelin kulturor e profesional të masave punonjëse. Në një vend ku para Clirimt rreth 90 për qind e popullsisë ishte analfabete, sot më shumë se 67 për qind e punëtorëve kanë arsim 8-vjeçar e të mesém dhe 32 për qind e tyre kanë kualifikim profesional të mesém e të lartë; në fshat 52,3 për qind e kooperativistëve janë me arsim 8-vjeçar e të mesém. Ne kemi tani rreth 47 500 kuadro me arsim të lartë dhe rreth 131 500 me arsim të mesém e profesional. Megjithëkëtë ngritja e nivelit arsimor, kulturor e tekniko-profesional të punonjësve, si pjesë e pandarë e edukimit komunist, mbetet një nga drejtimet e rëndësishme të veprimittarisë së Partisë dhe të shtetit.

Zhyllimi intensiv i ekonomisë e i kulturës, futja gjithnjë e më gjerrë e teknikës dhe e teknologjisë së përparuar, detyrat që shtrohen përrendimento e cilësi më të lartë, përrentabilitet dhe efektivitet më të madh në prodhim, përgjithësisht perspektivat e zhvillimit të vendit në të ardhmen kërkojnë ngritjen e mëtejshme të nivelit arsimor e kulturor, zotërimin e shkencës dhe të teknikës nga njerëzit tanë.

Detyra e Partisë është që të krijojë te të gjithë një kuptim të drejtë për nevojën që ka shoqëria jonë për njerëz të ditur, me horizont të gjerë kulturor me përgatitje të lartë profesionale, teknike e shkencore, të edukojë të punonjësit ndjenjën e ekzigjencës së lartë ndaj vetes. Kuadrot e punonjësit tanë duhet t'i karakterizojë ndjenja e së resë përparimitare, fryma novatore, pasioni dhe vullneti për të studiuar dhe mësuar vazhdimisht.

Vatra kryesore e përvetësimit të kulturës, të dijeve dhe të shkençës është shkolla jonë e re. Gjatë 15 vjetëve të fundit është ndërma rrë dhe po përballohet me sukses aksioni i madh për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë socialistë. Tashmë janë stabilizuar të gjitha strukturat e reja themelore të këtij procesi. Një punë e gjerrë me vlerë është bërë përpilimin dhe vënien në jetë të programeve të reja mësimore e sidomos për hartimin e teksteve shkollore të të gjitha kategorive.

Përpjekje të mëdha janë bërë për forcimin e përbajtjes ideologjike e shkencore të shkollës sonë në të tre komponentët e saj, për ndërtimin më racional të mënyrave të transmetimit të dijeve, për të nxitur qëndrimin aktiv e krijues të nxënësve ndaj mësimit etj. Të gjitha këto kanë bërë që nga shkolla jonë të dalin kontigjente të tëra nxënësish e studentësh me formim më të mirë e më të gjithanëshëm, më të brumosur ideologjikisht dhe më të aftë profesionalisht.

Suksesi të mëdha janë arritur edhe në masivizimin e të gjitha hallkave të sistemit tonë arsimor. Në tërësi mund të konsiderohen të zgjidhura ose të vëna përfundimisht në rrugën e zgjidhjes shumica dërrmuese e nevojave urgjente të zhvillimit sasior të arsimit. Ne kemi tanë një sistem arsimor të aftë për të përballuar kërkesat e sotme dhe të perspektivës në të gjitha fushat.

Tani ka ardhur koha që, pa lënë mënjanë kujdesin e vazhdueshëm për masivizimin e mëtejshëm të arsimit në tërësi e veçanërisht të disa hallkave të tij, të gjitha forcat e frontit tonë arsimor e pedagogjik të përgendrohen në mënyrë më serioze e më të kualifikuar në ngritjen e cilësisë së punës së shkollës. Kjo nevojë diktohet jo vetëm nga zhvillimet e brendshme specifike të arsimit, të shkollës e të pedagogjisë, por, në radhë të parë, nga zhvillimet e përgjithshme, ekonomike, shoqërore, shkencore e teknike të të gjithë jetës së vendit.

Shkolla jonë duhet ta pajasë brezin e ri me dije të nivelit bashkë-kohor. Në kohën tonë sistemi i dijeve ripërtërihet vazhdimisht e në përpjessëtime të mëdha. Një zhvillim me ritme shumë të shpejta kanë marrë matematika, fizika, kimia, biologjia etj., që përbëjnë themelin teorik të disiplinave të aplikuara të teknikës e të teknologjisë. Eshtë shkurtuar së tepërmë koha që ndan një zbulim shkencor nga përdorimi i tij në veprimtarinë prodhuese. Prandaj eshtë bërë shumë i imprehtë problemi i pasqyrimit më të shpejtë të arritjeve të reja në programet shkollore. Për t'i hapur vend informacionit të ri e të domos-doshëm shkencor, duhet bërë jo një shtim mekanik i vëllimit të njo-hurive, por ndryshime të aparatit konceptual dhe risistemime të këtij informacioni në struktura më kompakte dhe më universale, që e rritin mjaft peshën e tij specifike dhe e zgjerojnë në mënyrë të ndjeshme fushën e zbatimeve.

Para shkollës sonë, në të gjitha nivelet e saj, qëndron detyra e nënjanimit të njëfarë tradicionalizmi në parashtrimin e disiplinave shkencore bazë, të cilat tanimë i ka kaluar koha. Kjo është një detyrë serioze që nuk duhet të zgjidhet kurrsesi me shartime dhe arnime të së resë mbi të vjetër, por mbi bazën e një konceptimi tërësor e unik, që të shtrihet në të gjitha vitet e shkollimit, sidomos në hallkat mësuese të sistemit tonë arsimor. Studimet për këto probleme duhen bërë me kujdes e të menduara mirë, me qëllim që të bëhet me kohë përmirësuar e zhvilluar.

gatitja për ndryshimet eventuale, që të shmanget çdo element im provizimi në vendimet që do të merren për to, që të përpunohen më imtësish procedimet didaktike në përputhje me kriteret tona ideologjike, shkencore pedagogjike.

Organet kompetente të studiojnë me përgjegjësi ngarkesën mësimore të nxënësve e të studentëve, sepse realisht ka mbingarkesë, e cila shkon në dëm të formimit të tyre. Burimet e saj janë koordinimi jo i mirë i ngarkesave të pjesshme të lëndëve të planit mësimor, prirja që shkolla të monopolizojë e të dublojë edhe dhënien e informacionit që sot merret nëpër kanale të tjera, kërkesat e papërligjura për të përvetësuar koncepte e ide jashtë fuqive perceptuese të moshës etj. Në mënyrë të veçantë të tregohet kujdes i posaçëm për përpunimin në nivele të ndryshme trajtimi të disiplinave me karakter të mirëfilltë ideologjik, sepse vërehet një shtjellim pak a shumë i njësuar dhe pa shkallëzimet e nevojshme sipas grup-moshave shkollorë.

Ngritjes së gjithanshme të cilësisë e të rendimentit të punës mësimore-edukative të shkollës i shërben më mirë edhe forcimi i mëtejshëm i lidhjes së mësimit me jetën, me praktikën, me punën prodhuase jo vetëm në prizmin e edukimit e të kalitjes së brezit të ri, ku ne kemi arritur të konsiderueshme, por edhe në prizmin e integrimit të arsimit e të shkencës me prodhimin e sotëm modern, të vënies së tyre edhe më mirë në shërbim të zgjerimit e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor. Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se rinia e sotme që merr një arsim gjithnjë e më solid, është, e në të ardhmen do të jetë edhe më shumë, një forcë pararojë në realizimin e këtij revolucioni.

Forcimi i gjithanshëm cilësor, ngritja e nivelit shkencor, e rendimentit dhe e efikasitetit të të gjithë procesit mësimor-edukativ kërkon të bëhen përpjekje më të mëdha për përmirësimin rrënjësor të metodave të mësimdhënies, në mënyrë që të rritet përvetësimi aktiv i djeve dhe qëndrueshmëria e tyre, të nxitet mendimi krijues dhe të edukohen shprehëtë e punës së pavarur te nxënësit e studentët qysh në bankat e shkollës. Në këtë kuadër është e nevojshme të merren masa konkrete për të fuqizuar bazën materiale laboratorike të shkollës.

Prodhimi ynë, që ka tanë një shtrirje shumë të gjërë aktivitetesh, do të pasurohet në të ardhmen edhe me aktivitete të reja. Një ndër shtyllat e tij është armata e madhe e teknikëve të mesëm dhe e punëtorëve të kualifikuar. Prandaj rëndësi e veçantë u duhet kushtuar shkollave të mesme profesionale me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, të cilat përbëjnë 80 për qind të arsimit të mesëm të vendit. Këto shkolla, sidomos ato pa shkëputje nga puna e me profil bujqësor, duhet të konsolidohen plotësisht. Përpara tyre shtrohet detyra që rritjen e formimit teorik të nxënësve të mos e shohin vetëm si një synim që i lejon këta të fundit të ndjekin më lehtë shkollën e lartë, por ta harmonizojnë e ta vënë më mirë në funksion të aftësimit profesional në fushën përkatëse. Hallka që duhet kapur, është formimi i aftësive praktike dhe i intuitës teknike mbi bazën e një horizonti më të gjërë teorik.

Një kujdes i madh i duhet kushtuar përgatitjes së specialistëve të lartë. Ata të janë të aftë të përballojnë me kompetencë të plotë dety-

rat e tyre dhe në të njëjtën kohë të janë të pajisur me imagjinatë shkencore, pa të cilën nuk mund ta çojnë përpëra revolucionin tekniko-shkencor në sektorin ku punojnë. Puna e rëndomtë duhet të zëre dhe do të zëre një pjesë gjithnjë e më të vogël të kohës, ndërsa veprimtaria e mirëfilltë studimore, novatore, shkencore të shndërrohet në një preokupim themelor të specialistit të lartë.

Është detyrë e Universitetit dhe e shkollave të tjera të larta që këto cilësi t'i kultivojnë te studentët, duke vënë në lëvizje tërë potentialin intelektual të tyre, duke insistuar më fort në aspektin krijues të procesit mësimor-edukativ. Për të realizuar këtë, pedagogët e shkollave të larta duhet të futen thellë në veprimtarinë kërkimore, sepse vetëm një kërkues e ndjek me interes disiplinën që jep dhe është në gjendje ta zbulojë atë para auditorit me pasion të vërtetë.

Zgjerimi i punës shkencore në shkollën e lartë dhe trajtimi në-përmjet saj jo i temave të vogla, por i problemeve të mëdha të ekonomisë, të prodhimit, të mbrojtjes, të kulturës bëhet i domosdoshëm edhe për zgjerimin e intensifikimin e kualifikimit shkencor pasuniversitar. Kualifikimi i kuadrove dhe i specialistëve të lartë është një çështje për të cilën është e interesuar tërë shoqëria. Ajo ka nevojë që kuadrot të rritin vazhdimisht dijet e tyre, të njojin të rejat e shkencës dhe të teknikës, të mësojnë e të kualifikohen në forma individuale, por dhe të organizuara e të kontrolluara. Ndërtimi i kësaj halke të re të sistemit arsimor kërkon një punë të madhe e me përgjegjësi nga shkolla e lartë, nga Ministria e Arsimit, si dhe një ndihmë të gjithanshme e shumë të interesuar nga të gjitha dikasteret e tjera.

Arsimi ynë po kalon një proces konsolidimi të arritjeve të mëdha të revolucionarizimit të tij. Për ne mbetet detyrë e përhershme përsosja e vazhdueshme e tërë kompleksit të madh të masave që përbëjnë thelbin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës. Verifikimin e tyre e bën praktika revolucionare, e cila na mëson të korrigojmë pasaktësitë, të zhdukim të metat, të plotësojmë zbrazëtitë. Shumë gjëra janë ndrequr në dinamikën e përparimit të shkollës sonë. Por zhvillimi i jetës së vendit dhe i vetë arsimit nxjerrin probleme të reja, të cilat duhen studiuar me kujdes në tërë kompleksitetin e tyre dhe pastaj të merren masat e nevojshme e të përshtatshme për t'i zgjidhur.

Një rol vendimtar në realizimin e gjithë këtyre detyrave që shtrohen përpëra shkollës, kanë arsimtarët e pedagogët. Ata duhet të punojnë më shumë për ngritjen e tyre ideopolitike e profesionale, për zgjerimin e horizontit të përgjithshëm shkencor e kulturor, për të rritur mjeshtërinë pedagogjike. Të luftohet çdo formalizëm në vlerësimin e punës së tyre, të luftohet fryma e liberalizmit dhe e të kënaqurit me pak. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se shkolla kërkon mund e djersë, kërkon pasion e vullnet, ndërgjegje e disiplinë të lartë.

Në forcimin e punës së shkollës një peshë të madhe ka opinioni i shëndoshë shoqëror, i cili mund të ndihmojë shumë në veprimtarinë e përditshme të shkollës. Rëndësi të posaçme ka kultivimi te rinia e shkollave i motiveve të shëndosha të të mësuarit mbi bazën e idealeve revolucionare.

Përmirësimi i gjithanshëm i punës në arsimin popullor dikton

edhe nevojën për përsosjen e për revolucionarizimin e mëtejshëm të metodës e të stilit të punës drejtuese të të gjitha organeve arsimore që nga drejtoritë e shkollave e deri në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës. Kjo kërkon ngritjen e nivelit shkencor të punës drejtuese, zgjidhjen mbi baza më të kualifikuarë shkencore të problemeve komplekse të zhvillimit të mëtejshëm të arsimit populor e të revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës.

Nga ana e tyre, edhe ministritë e institucionet e tjera duhet të merren më mirë me përgatitjen e kuadrove e të specialistëve të mesëm dhe të lartë, të përcaktojnë drejt kërkesat për numrin dhe profillet e tyre, të angazhohen seriozisht në hartimin e planeve, të programave e të teksteve të shkollës, të kujdesen për organizimin më të mirë të punës prodhuase e të stazhit në punë të nxënësve e të studentëve...

... Në sukseset e mëdha që ka arritur populli ynë në ndërtimin socialist të vendit, një kontribut të veçantë ka dhënë edhe shkenca jonë e re. Kjo është shtrirë në fusha të reja të palëvruara më parë, ka ngritur nivelin e studimeve dhe tani është në gjendje të marrë përsipër detyra më të vështira e të zgjidhë probleme më të mëdha, iku përgjigjet më mirë kërkesave që shtron para saj zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës.

Njerëzit tanë të shkencës e të teknikës sot studiojnë, projektojnë dhe zbatojnë tèrësish me forcat e veta të gjitha veprat për të cilat ka nevojë ekonomia dhe mbrojtja, siç janë veprat hidroenergjetike, hekurudhat, puset e shpimeve të thella, fabrikat e pasurimit të minerealeve dhe shumë objekte të tjera të rëndësishme industriale. Janë zbuluar dhe vënë në shfrytëzim pasuri të mëdha të nëntokës, të cilat tani përbëjnë bazën themelore për zhvillimin e industrisë e të tere ekonomisë së vendit. Hapa të mirë janë bërë për zgjidhjen e problemeve të shumta teknike e teknologjike të prodhimit. Nga pjesët e ndërrimit tani është kaluar në prodhimin e makinerive të plota. Në fushën e bujqësisë studimet dhe eksperimentimet janë bërë faktorë të rëndësishëm përritjen e rendimenteve dhe për përmirësimin e racave. Realizime me vlerë ka pasur edhe në shkencat shoqërore, historike, gjuhësore, ekonomike, politike etj.

Por stadi i arritur i zhvillimit të vendit dhe detyrat e mëdha që shkenkimi përpara, shtrojnë si një nevojë të ngutshme zhvillimin e shkenkës, vlerësimin e saj të drejtë dhe zbatimin e arritjeve të saj në proces, vlerësimin e saj të drejtë dhe zbatimin e arritjeve të saj në përdorim. Kjo nevojë bëhet edhe më imperative në kushtet e sotme të zhvillimit të vendit vetëm me forcat tonë, kur ekonomia dhe gjithë sektorët e veprimtarisë shoqërore janë futur në rrugën intensive dhe kur kudo kërkohet punë me cilësi, rendiment dhe efektivitet të lartë.

Këto ishin arsyet që Partia në një Plenum të posaçëm vitin e kaluar analizoi gjithë veprimtarinë shkencore në vendin tonë, duke orientimet që dha Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror përbëjnë dhe njerrë konkluzione dhe duke përcaktuar detyra të veçanta jo vetëm një program të madh pune për sot e për të ardhmen. Tani tërë puna një program të madh pune për sot e për të ardhmen. Tani tërë puna duhet përqëndruar në luftën këmbëngulëse përvienien në jetë të këtij programi.

Objektivi kryesor i gjithë punës studimore shkencore është që të mbështesë si duhet pesëvjeçarin e shtatë për të siguruar realizimin e plotë të tij. Krahas kësaj, detyrë dhe objektiv me rëndësi i shkencës sonë është që qysh tani të fillojë nga kryerja e studimeve për pesëvjeçarin e ardhshëm. Shkenca, që të jetë shkencë, që ta luajë me të vërtetë rolin e saj dhe të kryejë funksionin e vet, duhet t'i paraprijë prodhimit, të tregojë qysh më përpara perspektivën e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës. Vetëm mbi këtë bazë ajo mund të ndihmojë si planifikimin, ashtu edhe prodhimin.

Duke pasur mirë parasysh detyrat aktuale e të perspektivës, kujdes i madh i duhet kushtuar përvetësimit të arritjeve bashkëkohore dhe lëvrimit të atyre shkencave të cilat zbatohen në fusha me rëndësi jetike për ne, që kushtëzojnë përparimin e vendit me ritme të shpejta dhe fuqizojnë pavarësinë e plotë të tij.

Forcat dhe mjetet kryesore duhet të përqëndrohen në studimin e pasurive tona natyrore e në radhë të parë në kërkimin dhe zbulimin e minraleve të dobishme. Shkenca jonë duhet të gjejë rrugë më të mira për të shtuar burimet energetike dhe për përdorimin rational të tyre, për një shfrytëzim sa më kompleks dhe integral të të gjithë përbërësve të dobishëm të lëndëve të para, për kosto sa më të ulët dhe cilësi sa më të lartë të prodhimit.

Objektiv i rëndësishëm i punës shkencore duhet të jetë zgjerimi i studimeve në fushën e konstruksioneve mekanike dhe të përsosjes së teknologjive të prodhimit e të mekanizmit të proceseve të punës, në fushën e projektimit dhe të ndërtimit të veprave të ndryshme industriale, hidroteknike e civile etj.

Me rëndësi të veçantë janë studimet në lëmin e bujqësisë, sidomos ato që kanë të bëjnë me ruajtjen, shtimin dhe përmirësimin e tokës, me rritjen e aftësive gjenetike të farërave e të racave, me përmirësimin e agroteknikës, me mbrojtjen e bimëve e të kafshëve.

Për kushtet e vendit tonë ne duhet të ngulim këmbë në aplikim. Në këtë fushë të përqendrohet, në radhë të parë, puna kërkimore-shkencore. Këtu të angazhohen edhe forcat kryesore shkencore-teknike. Kjo nuk do të thotë që të lihen mënjanë shkencat fondamentale, të cilat përbëjnë themelin teorik të shkencave të aplikuara e të teknikës moderne. Detyra që shtrohet është të njihen e të përvetësohen rezultatet dhe metodat e përparuara të këtyre shkencave për t'i vënë sa më mirë në shërbim të prodhimit dhe për të siguruar një përgatitje të shëndoshë teorike të specialistëve tanë.

Në të gjitha fushat e shkencës, por sidomos në ato të aplikuarat duhet të ngremë cilësinë e punës studimore shkencore dhe efektivitetin e saj. Cdo studim që kryhet të jetë i plotë, fazat e ndryshme të tij të përbëjnë një tërësi të vetme, duke filluar nga studimi i përgjithshëm, eksperimentimi, projektimi dhe deri në zbatim. Studimet teknike e teknologjike duhet të shoqërohen edhe me studime ekonomiko-financiare, me qëllim që të evidentohet leverdia ekonomike dhe efektiviteti i shpenzimeve.

Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor në të gjitha fushat ka vënë në lëvizje masa të mëdha njerëzish, ka nxitur një interesim të vërtetë për të përvetësuar më thellë dijet shkencore e për të eksperimentuar. Mbi të gjitha ai ka forcuar besimin e kuadrove e të pu-

nonjësve tanë në aftësitë dhe në mendimin e tyre krijues. Tani janë krijuar mundësitë që, krahas rritjes sasiore e cilësore të racionalizimeve e të novacioneve, të kalohet gradualisht në një front më të gjerë përmirësimesh e transformimesh më të mëdha, që të sjellin ndryshime më rrënjosore në dobi të prodhimit, të pajimit teknik, të konceptimeve teknologjike apo formave organizative jo vetëm në reparate e fabrika të veçanta, por edhe në degë të tëra. Për këtë duhet të rritet më tej roli aktiv dhe efektiviteti i shkencës, e cila të zhvillohet jo vetëm në institucionet kërkimore-shkencore, por të zhvillohet e të zbatohet gjërisht në terrenin konkret, në uzina, kombinate, në fusha, kudo ku prodhohen të mira materiale.

Përparimi i shkencës kushtëzohet shumë nga planifikimi më i saktë e më largpamës i saj në përputhje me nevojat e vendit në të gjitha hallkat e punës kërkimore-shkencore, nga organizimi dhe bashkërendimi i mirë i veprimtarisë së institucioneve të ndryshme, nga shkërendimi e një baze materialo-laboratorike të përshtatshme dhe të mundshme për vendin tonë, nga përgatitja, kualifikimi i vazhdueshëm dhe angazhimi me efektivitet të lartë i specialistëve të fushave të ndryshme.

Akademia e Shkencave mbetet qendra më e madhe e më e rëndësishme e kërkimeve shkencore në vendin tonë. Partia i ka vënë detyrën që, krahas konsolidimit të institucioneve të saj shkencore asaj, si ekzistuese, të zgjerojë veprimtarinë e saj edhe në fusha të tjera, si domos në ato natyrore e teknike, që i shërbjnë më drejtpërdrejt zgjidhjes së problemeve të mëdha të prodhimit.

Krijimi i Komitetit të Shkencës dhe Teknikës këtë vit është një masë e rëndësishme që mori Partia për drejtimin dhe organizimin më të mirë të punës studimore-shkencore. Është detyrë e tij që të bashkëtë rendojë më mirë gjithë veprimtarinë shkencore të vendit dhe të ndihmojë për vënien në zbatim të rezultateve të saj.

Një kujdes e interesim më të madh për zhvillimin e shkencës duhet të tregojnë të gjitha organet shtetërore nga baza deri në qendër. Veprimtarinë shkencore këto duhet ta konsiderojnë si pjesë përbërëse të pandarë të punës së tyre, për planifikimin, organizimin, drejtimin e ekonomisë, të kulturës e të gjithë jetës së vendit.

Zhvillimi dhe përpërimi i shkencës ndihmohet kur jetohet më afër veprimtarisë shkencore dhe njerëzve që merren me të, kur tërhiqet mendimi i specialistëve dhe përkrahët e reja, kur luftohen penës dhe zvarritjet burokratike që vihen re disa herë në kryerjen e studimeve dhe sidomos në vënien e tyre në jetë.

Objekt themelor i punës së organizatave të Partisë duhet të jetë kujdesi për zbatimin e politikës së Partisë në fushën e shkencës, që veprimtaria kërkimore e studimore të përqendrohet në problemet e mëdha aktuale e të perspektivës, që kuadrot shkencorë të armatosen me botëkuptimin marksist-leninist e me mësimet e Partisë...

Të dashur shokë,

Sukseset që ka arritur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë janë të mëdha, betejat e fituara janë madhështore. Ato dëshmojnë se populli ynë ka fuqi të pashtershme, se ai është optimist e i vendosur

të ndërmarrë beteja të reja për ta bërë jetën e tij më të lumtur, për ta lartësuar akoma më shumë emrin e Atdheut të tij socialist, për të forcuar lirinë e pavarësinë, pushtetin populor që lindi në flakët e revolucionit.

Është ky realitet i mrekullueshëm, është uniteti i pathyeshëm i popullit me Partinë, është pjekuria, guximi dhe vendosmëria e komunistëve që u jep siguri e garanci popullit e Partisë se objektivat që do të caktojë ky Kongres do të arrihen e do të tejkalojen.

Entuziazmi që kanë ngjallur Projektdirektivat e planit të shtatë pesëvjeçar, mobilizimi i masave punonjëse për realizimin e detyrave të këtij viti, rezultatet inkurajuese që po arrihen, e, mbi të gjitha, përkrahja unanime, e vendosur dhe e zjarrtë që njerëzit tanë i jepin politikës së brendshme e të jashtme të Partisë, tregojnë se i gjithë vendi është i gatshëm dhe i mobilizuar për të ecur me besim e vendosmëri në rrugën ku na udhëheq Partia, për të arritur fitore të reja.

Këtë vrull revolucionar, këtë dashuri të pafund për Partinë tonë të lavdishme, këtë besim të patundur në të ardhmen le t'i kthejmë, të dashur shokë e shoqe, në një forcë të madhe lëvizëse për të realizuar detyrat në të gjitha fushat, për të kapërcyer të gjitha vështirësitë që do të na dalin, për t'i forcuar e konsoliduar më tej fitoret tona, bazat e pathyeshme të socializmit në Shqipëri.

Rroftë Kongresi i 8-të i Partisë!

Rroftë populli heroik, i talentuar e punëtor shqiptar!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja e urtë, trime dhe e sprovuar, organizatorja e të gjitha fitoreve tona në rrugën e ndritur të ndërtimit socialist

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Raporti i shokut Enver Hoxha u dëgjua me interesim të veçantë dhe me vëmendje të madhe. Ai u ndërpre shpeshherë nga duartrokitje, brohoritje e ovacione të zjarra të të gjithë delegatëve. Shpesh në sallë buçitnin thirrjet «Rroftë Partia e Punës së Shqipërisë», «Rroftë shoku Enver Hoxha», «Parti - Enver jemi gati kurdoherë», «Lavdi marksizëm-leninizmit», «Rroftë internacionalizmi proletar», «Rrofshin partitë marksiste-leniniste» etj. Delegatët ngrihen në këmbë dhe brohorisnin për unitetin e çeliktë Parti-popull, për fitoret e Partisë e të popullit tonë, për proletariatin ndërkombëtar dhe për popujt që janë ngritur në revolucion e luftojnë me vendosmëri kundër superfuqive, imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e atij kinez, kundër revizionizmit e reaksionit.

(«Zëri i Popullit», Nr. 262
— 10.375, datë 2 nëntor 1981)

DIREKTIYAT E KONGRESIT TE 8-TE TE PPSH PER PLANIN e 7-TE PESEVJEÇAR (1981-1985) TE ZHVILLIMIT TE EKONOMISE DHE TE KULTURES TE RPSSH

Pesëvjeçari i gjashtë 1976-1980 shënoi një periudhë tjetër të lavigjishme në luftën e Partisë dhe të popullit tonë për të çuar përpara ndërtimin e socializmit, për të forcuar rendin ekonomiko-shoqëror dhe mbrojtjen e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, për të ngri-tur mirëqenien materiale e kulturore të popullit dhe për të kalitur ndërgjegjen socialiste të njeriut tonë të ri. Gjatë kësaj periudhe forcat prodhuase u zhvilluan më tej dhe produksi shoqëror mori përmasa më të mëdha, u përsosën marrëdhëniet socialiste në prodhim, u ngritën në një shkallë më të lartë arsimi e kultura dhe u thellua revolucioni tekniko-shkencor.

Fitoret e mëdha që u arriten në të gjitha fushat e jetës në pesëvjeçarin që kaloi dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme për epërsinë dhe vitalitetin e rendit tonë socialist. Ato kanë në themel vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë dhe janë fryt i punës së ndërgjegjshme e të palodhur të masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 7-te të Partisë.

Këto fitore u realizuan në kushte të veçanta e tepër të vështira të rrëthimit e bllokadës së egër imperialisto-revisioniste, të vështirësive të krijuara nga veprimitaria armiqësore e sabotuese e revisionistëve kinzë ndaj vendit tonë, të ashpërsimit të luftrës së klasave në arenën ndërkombëtare dhe të thellimit të krizës ekonomike botërore. Lufta titanike e Partisë dhe e popullit tonë bëri të dështojnë me turp të gjitha përpjekjet e armiqve për të na penguar dhe larguar nga rruga e ndërtimit të socializmit.

Në këtë luftë u forcua edhe më shumë uniteti i çeliktë e i pathyeshmë i Partisë e i popullit, Atdheu e ekonomia jonë dolën më të fuqishëm se kurrë. Në një kohë kur ekonomia kapitaliste, borgjeze e revisioniste, është zhytur gjithnjë e më shumë në darën e kontradiktave dhe të krizave, ekonomia jonë ka rritur vazhdimisht qëndrueshmërinë e saj dhe ka krijuar një bazë të fuqishme për të ecur me ritme më të shpejta përpara, plotësisht me forcat tona.

Lufta kundër imperializmit dhe revisionizmit modern, mbrojtja pa u lëkundur e marksizëm-leninizmit, kundër sulmeve e shtrëmbëri-

meve të borgjezisë dhe të gjitha rrnymave të oportunizmit dhe revisionizmit, përkrahja e vendosur që Partia dhe populli ynë i jepin lufte së popujve për liri e pavarësi, demaskimi i vazhdueshëm i politikës luftënxitëse të të dy superfuqive, imperializmit amerikan dhe social-imperializmit sovjetik, si dhe të revizionistëve kinezë, rritën edhe më shumë autoritetin dhe forcuan pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë socialiste.

I

PLOTËSIMI I DETYRAVE KRYESORE TË PLANIT TË GJASHTË PESËVJEÇAR (1976-1980) TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS

Në pesëvjeçarin që kaloi ekonomia dhe kultura e vendit tonë u ngriten në një stad zhvillimi të ri më të lartë. U rrit më tej vëllimi i prodhimit dhe u bënë përmirësimë të rëndësishme në strukturën e produktit shoqëror.

Megjithëse revisionistët kinezë ndërprenë kreditë dhe marrëdhënet e tjera ekonomike me vendin tonë, në të cilat mbështetet arritura e disa objektivave të rëndësishme në pesëvjeçarin e gjashtë, Partia i bëri thirrje të gjithë popullit, ajo mobilizoi dhe udhëhoqi masat punonjëse për të plotësuar detyrat kryesore të planit të shtetit.

Me masat që u morën për të vazhduar ndërtimin e veprave të lëna përgjysmë e të sabotuara nga revisionistët kinezë, ekonomia jonë gjatë viteve 1979-1980, duke u mbështetur tërsisht në forcat e veta, pa asnjë ndihmë e kredi nga jashtë, u zhvillua me ritme më të shpejta se në vitet 1976-1978. Kështu, produkti shoqëror gjatë dy viteve të fundit të pesëvjeçarit u rrit mesatarisht 4,9 për qind, nga 4,2 për qind që u rrit mesatarisht në vitet 1976-1978, kurse ritmi mesatar vjetor i rritjes së prodhimit të përgjithshëm industrial ishte 17 për qind më i lartë.

Në vitin 1980 produkti i përgjithshëm shoqëror u rrit 24,4 për qind në krahasim me vitin 1975, ose mbi dy herë më shpejt se shtimi i popullsisë.

Duke zbatuar me konsekuençë politikën ekonomike të Partisë për thellimin e industrializmit socialist të vendit, u rrit më tej roli i industrisë si degë udhëheqëse e ekonomisë, për shfrytëzimin më të gjërë të pasurive natyrore, për rritjen e shkallës së përpunimit të tyre në vend dhe për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë. Prodhami i përgjithshëm industrial gjatë pesëvjeçarit të kaluar u rrit me një ritëm mesatar vjetor prej 6,1 për qind. U ngriten degë të reja të industrisë, si ajo e metalurgjisë së zezë, e përpunimit të thellë të naftës, e ferrokromit etj., si dhe u zgjerua më tej baza materiale e teknike e degëve ekzistuese të industrisë nxjerrëse e përpunuese.

Përparësi gjatë pesëvjeçarit të kaluar morën degët e prodhimit të mjeteve të prodhimit. Në vitin 1980 pesha specifike e grupit A në prodhimin e përgjithshëm industrial arriti në 64 për qind, nga 56,8 për qind që zinte në vitin 1975. Industria energetike u fuqizua edhe

më shumë duke plotësuar të gjitha nevojat në rritje të vendit dhe u bë një nga burimet e rëndësishme për shtimin e eksportit. Suxsesi të rëndësishme u arriten në zbulimin e fushave të reja naftë-gazmbajtëse, të cilat shtuan rezervat industriale. Nxjerra e qymyrgurit në vitin 1980 u rrit 63 për qind më shumë se në vitin 1975 dhe prodhami i energjisë elektrike nga hidrocentralet 3 herë më shumë.

Industria mekanike u zhvillua me ritme të larta dhe arriti detyrën kryesore të saj për plotësimin e 95 për qind të nevojave të ekonomisë me pjesë ndërrimi të prodhua në vend. Hapa të rëndësishëm përpara u bënë edhe për shtimin e prodhimit të makinerive e të pajisjeve. Prodhami industrial i kësaj dege në vitin 1980 ishte 57,7 për qind më shumë se në vitin 1975. Përparime të dukshme u bënë edhe në të gjitha degët e tjera të industrisë së rëndë nxjerrëse dhe përpunuese, si në atë të kromit, të bakrit, të industrisë kimike, të materialeve të ndërtimit, të industrisë së letrës dhe të drurit etj.

Zhvillim të mëtejshëm gjatë pesëvjeçarit të gjashtë mori edhe prodhami i mallrave të përdorimit të gjerë. Në mjaft nga produktet kryesore të industrisë së lehtë dhe ushqimore ritmi mesatar vjetor i shtimit të tyre ishte nga 2,2 deri në 6,5 herë më i lartë se ritmi mesatar vjetor i shtimit të popullsisë.

Në pesëvjeçarin e gjashtë bujqësia jonë socialiste përparoi më tej mbi bazën e intensifikimit të prodhimit në degët e ndryshme të saj. Prodhami bujqësor, për të pesë vitet të marra së bashku, në krahasim me atë të pesëvjeçarit të 5-të, ishte 21,4 për qind më i madh. Fshatarësia kooperativiste dhe punonjësit e tjerë të bujqësisë konsoliduan fitoren e madhe, plotësimin e nevojave të ekonomisë dhe të popullit me drithëra buke të prodhua në vend. Kjo, së bashku me shtimin e produkteve të tjera bujqësore e blektorale, rriten më tej rolin e bujqësisë sonë socialiste për zhvillimin e pavarur të vendit, duke plotësuar më mirë nevojat e popullit, të industrisë dhe të eksportit.

Këto arritura u mbështetën edhe në fuqizimin e mëtejshëm të bazës materialo-teknike të bujqësisë. Krahas me shtimin e numrit të traktorëve dhe të makinerive të tjera bujqësore, sipërfaqja e ujitshme u shtua edhe për rrëth 40 mijë ha, prodhami i plehrave kimike në vitin 1980 u rrit 50 për qind më shumë se në vitin 1975. Hapa të rëndësishëm përpara u bënë gjithashtu në përdorimin më racional të bazës materialo-teknike nëpërmjet zbatimit të teknikës e të teknologjisë së përparuar për rritjen e pjellorisë së tokës dhe mbarështimin e blektorisë.

Gjatë pesëvjeçarit të gjashtë vëllimi i investimeve të kryera për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës ishte 15 për qind më i madh se në pesëvjeçarin e pestë. U ndërtuan dhe u vunë në shfrytëzim mjaft vepra të rëndësishme ekonomike e social-kulturore, të cilat forcuan më tej bazën materialo-teknike të ekonomisë në tërësi e të degëve të veçanta të saj, sidomos të industrisë dhe të bujqësisë.

Zhvillim të mëtejshëm morën edhe degët e sektorët e tjerë të ekonomisë dhe të kulturës. Vëllimi i transportit të mallrave gjatë pesëvjeçarit të kaluar u rrit 30 për qind, duke plotësuar më mirë nevojat e ekonomisë për lëvizjen në kohë të mallrave të ndryshme.

Tregtia e jashtme, me masat që u morën, kapërceu vështirësitet dhe pengesat e krijuara nga ndërprerja e marrëdhënieve ekonomike prej

revisionistëve kinezë me vendin tonë, siguroi tregje të reja të shitjes përmallrat e eksportit dhe rriti vëllimin e eksport-importit në përgjithësi.

Të gjitha këto arritje ishin një hap tjetër i rëndësishëm në rrugen e shndërrimit të Shqipërisë në një vend industrialo-bujqësor.

Me kujdesin e Partisë dhe me masat që u zbatuan u ruajt dhe u përmirësua nivel i jetesës së masave punonjëse. Të ardhurat reale për frymë të popullsisë u rritën më tej, fuga blerëse e saj u shtua dhe tregtia socialiste plotësoi më mirë nevojat e popullit për mallra të përdorimit të gjërë në sasi, në strukturë dhe në cilësi. Me ritme të shpejta u rritën edhe sektorët e shërbimeve komunale. Në një kohë kur inflacioni, ngritja e shfrenuar e çmimeve, papunësia e dukuri të tjera negative godasin nga të gjitha anët nivelin e jetesës të puhojnësve të vendeve kapitaliste e revisioniste, në vendin tonë prej kohësh janë hequr tatimet dhe taksat e gdo lloji, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve kanë qëndrueshmëri dhe ato të banesave janë shumë të ulëta. Te ne nuk ka inflacion, papunësi dhe emigracion ekonomik.

Arsimi dhe kultura socialiste morën një zhvillim të metejshem. U ngrit në një shkallë më të lartë roli i tyre në gjithë punën që bën Partia për edukimin komunist të masave punonjëse. U përgatiten rreth 20 mijë kuadro të larta të specialiteteve të ndryshme, ose 57 përqind më shumë se në pesëvjeçarin e pestë. U ngrit cilësia e përgatitjes së specialistëve në shkollat e larta dhe të punëtorëve të kualifikuar e të specialistëve të tjerë në shkollat e mesme.

Përparime u bënë edhe në shërbimin shëndetësor për ruajtjen e përmirësimin e shëndetit të popullit. U shënuan arritje në higjienizmin më të mirë të qyteteve e të fshatrave, të qendrave të punës e të prodhimit dhe në mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet.

Sukseset në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës dhe larta e gjithashme për të vendosur kudo një regjim të reprejtë kursimi forcuan më tej gjendjen financiare të vendit dhe fuqinë blerëse të lekut. Buxheti i shtetit ka financuar në mënyrë të pandërprerë shpenzimet në rritje për zhvillimin e ekonomisë, të sektorëve shoqërorë e kulturore dhe për fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të vendit.

Në bazë të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë u përsosën më tej në rrugë revolucionare marrëdhëniet socialiste në prodhim. Mësat që u morën për të fuqizuar në mënyrë të vazhdueshme pronën socialist, përsosja e formave të shpërbimit mbi bazën e parimit socialist sipas sasisë dhe cilësisë së punës, përkrahja e nismave revolucionare, sidomos për tufëzimin e bagëtive të oborreve kooperativiste dhe përsosja e drejtimit shkencor e me plan të ekonomisë u bënë faktorë të rëndësishëm për të çuar përpara zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës dhe ndërtimin socialist në vendin tonë.

Një kontribut me vlerë në përparimin e përgjithshëm të vendit ka dhënë zhvillimi dhe thellimi i pandërprerë i revolucionit tekniko-shkencor, duke zgjidhur me sukses mjaft probleme të zhvillimit të ekonomisë, të kulturës e të forcimit të aftësisë mbrojtëse të vendit.

Mbështetur në arritjet e mësipërme në të gjitha sferat e veprimtarisë ekonomiko-shoqërore të vendit, Kongresi i 8-të i PPSH arriți në përfundimin se detyra themelore e caktuar nga Kongresi i 7-të i Partisë për planin e gjashtë pesëvjeçar u plotësua me sukses.

Kongresi i 8-të i PPSH, duke u bazuar në këto arritje, në burimet dhe në mundësitetë materiale dhe financiare që ka vendi ynë dhe që do të shtohen në të ardhmen, në studimet e kryera për zhvillimin e degëve dhe të sektorëve të ndryshëm të prodhimit material e të atyre shoqërorë e kulturorë, dhe në diskutimin e shqyrtimin me kolektivat punonjëse të qytetit e të fshatit të projektplanit të pesëvjeçarit të shtatë (1981-1985), miraton këto direktiva për planin e 7-të pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë.

II

DREJTIMET DHE DETYRAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË E TË KULTURES PËR PLANIN E 7-të PESËVJEÇAR (1981-1985)

Të udhëhequr nga vija e përgjithshme e Partisë, të mbështetur në entuziazmin revolucionar e në patriotizmin e lartë të popullit, në bazën materialo-teknike të krijuar deri më sot dhe në marrëdhëniet sociale të nё prodhim, Kongresi i 8-të i PPSH miraton këtë detyrë themelore pёr planin e shtatë pesëvjeçar 1981-1985: »zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë duke u mbështetur tërësisht në forcat tona mbi bazën e thellimit të industrializimit socialist të vendit, fuqizimit e intensifikimit të bujqësisë, rritjes së efektivitetit të ekonomisë, zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe përsosjes së marrëdhënieve sociale të nё prodhim, me qëllim që të garantohet dhe të ngrihet gradualist mirqënia materiale dhe niveli kulturor i masave punonjëse, të forcohet më tej rendi socialist dhe fuqia mbrojtëse e Atdheut.»

Kjo detyrë të arrihet:

nëpërmjet zhvillimit të shpejtë të industrisë për të siguruar vazhdimin e ndërtimit të një industrie komplekse shumëdegëshe, duke forcuar degët ekzistuese dhe duke ngritur degë të reja, duke rritur me përparësi industrinë e rëndë nxjerrëse e përpunuese, në radhë të parë, industrinë energetike, atë minerare e përpunuese dhe industrinë mekanike, si dhe duke zhvilluar, në përputhje me nevojat e popullit e të ekonomisë, industrinë e prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë dhe duke përmirësuar strukturën e cilësinë e tyre;

nëpërmjet përparimit dhe intensifikimit me ritme të shpejta të prodhimit bujqësor, duke futur e zbatuar në shkallë më të gjerë arritjet e shkencës e të përvojës së përparuar, me qëllim që të shtohet pandërprerje prodhimi i drithërave të bukës, si dhe të rriten me ritme të larta gjithnjë produktet e tjera bujqësore e blegtoriale për plotësimin më mirë të nevojave të popullit, të ekonomisë dhe të mbrojtjes me këto produkte:

nëpërmjet rritjes më tej të efektivitetit të produktit shoqëror dhe të përdorimit të të ardhurave kombëtare, sidomos të investimeve dhe ndërtimeve themelore, duke foruar regjimin e kursimit dhe rentabilitetin në degot e prodhimit material dhe në sektorët shoqërorë e kulturorë;

nëpërmjet përparimit të gjithanshëm të shkencës, thellimit të revolucionit tekniko-shkencor, duke rritur më tej rolin e tyre për zhvillimin e zbatimin në shkallë të gjerë të teknikës e të teknologjisë së përparuar dhe për zgjidhjen e problemeve ekonomiko-shoqërore të ndërtimit socialist të vendit;

nëpërmjet forcimit të vazhdueshëm të pronës socialiste, sidomos në fshat, përsosjes së formave të shpërbimit, forcimit të karakterit shkencor të organizimit e të drejtimit me plan të ekonomisë dhe të kulturës, mbi bazën e parimit të centralizmit demokratik dhe përmirësimit të strukturave organizative në përputhje me nevojat e zhvillimit.

Treguesit më kryesorë të zhvillimit të ekonomisë gjatë pesëvjeçarit të shtatë (1981-1985) të rriten si vijon:

Në përqindje
Viti 1985 kundrejt
vitit 1980

| | |
|--|-------|
| Produkti i përgjithshëm shoqëror | 34-36 |
| Të ardhurat kombëtare | 35-37 |
| Prodhimi i përgjithshëm industrial | 36-38 |
| Prodhimi i përgjithshëm bujqësor (në pesëvjeçarin e shtatë kundrejt pesëvjeçarit të gjashtë për të pesë vitet e marrë së bashku) | 30-32 |
| Investimet themelore (në pesëvjeçarin e shtatë kundrejt pesëvjeçarit të gjashtë për të pesë vitet e marrë së bashku) | 22-24 |
| Transporti i mallrave gjithsej në t/km | 34-36 |
| Qarkullimi i mallrave me pakicë në tregtinë shtetërore | 22-24 |
| Eksporti | 58-60 |
| Rendimenti shoqëror i punës | 12-14 |
| Rendimenti i punës në industri | 13-15 |
| Rendimenti i punës në ndërtim | 14-16 |
| Të ardhurat reale përfrymë të popullsisë | 8-10 |
| Të ardhurat e përgjithshme financiare | 34-36 |

Detyrat që parashikohen për planin e shtatë pesëvjeçar janë më madhështoret në krahasim me të gjitha planet e mëparshme, aq më tepër sepse për herë të parë Partia dhe populli ynë do të zbatojnë një plan pesëvjeçar të mbështetur plotësish në forcat tona, pa asnjë ndihmë e kredi nga jashtë, në kushte e rrethana të acaruarë ndërkombëtare, duke siguruar ritme të shpejta zhvillimi në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës.

Objektivat që parashikohen për planin e shtatë pesëvjeçar janë reale dhe shkencore. Në themel të tyre qëndrojnë, si kurdoherë, ligjësitë përgjithshme dhe parimet bazë të socializmit shkencor, si dhe mundësítë reale që ka ekonomia jonë përritjen e këtyre objektivave.

Për të plotësuar këto objektiva madhështore të planit të shtatë pesëvjeçar kërkohet mobilizimi i mëtejshëm i të gjitha burimeve dhe rezervave të brendshme që ka dhe që do të krijojë ekonomia jonë, kuptimi dhe zbatimi sa më i plotë nga të gjithë i detyrave që dalin nga

situatat në të cilat zhvillohet vendi ynë, në mënyrë të veçantë zbatimi nga të gjitha kolektivat punonjëse të qytetit e të fshatit i parimit të mbështetjes në forcat e veta, ngritja në një nivel edhe më të lartë të punës së Partisë dhe e të gjitha levave të saj për edukimin dhe kulturjen revolucionare të njeriut tonë të ri, nëpërmjet thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor kurdoherë mbi bazën e marksizëm-le-ninizmit.

1. Zhvillimi i industrisë

Gjatë pesëvjeçarit të shtatë industria të zhvillohet e të fuqizohet më tej, në radhë të parë nëpërmjet shfrytëzimit më të plotë e racional të lëndëve të para të vendit, përdorimit më të mirë të aftësive prodhuase në shfrytëzim dhe zgjerimit e rikonstrukcionit të tyre, si dhe duke ndërtuar vepra të reja, duke i dhënë përparësi industrisë së prodhimit të mjeteve të prodhimit. Prodhimi i mjeteve të prodhimit (Grupi A) në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, të rritet 38-40 për qind, kurse prodhimi i sendeve të konsumit (Grupi B) të rritet 33-35 për qind.

Të fuqizohen kërkimet gjeologjike për zbulimin e mineraleve, duke siguruar shtimin e rezervave industriale e të atyre prognoze për naftën, gazin, qymyrgurin, mineralin e kromit, të bakrit, të hekurnikelit dhe mineraleve të tjera të dobishme, si bazë për zhvillimin me ritme të shpejta të industrisë nxjerrëse e përpunuese të mineraleve për periudha kohe sa më të gjata. Të rritet efektiviteti i përdorimit të bazës materialo-teknike dhe i investimeve në fushën e kërkim-zbulimit, duke përdorur metoda shkencore të përparuara dhe duke thelluar studimet komplekse.

T'i jepet përparësi zhvillimit të industrisë energjetike për të rritur me ritme më të shpejta produktet energjetike, duke siguruar plotësimin e nevojave në rritje të ekonomisë për këto produkte dhe shtimin e eksportit të tyre.

Zhvillimi i industrisë së naftës dhe gazit të jetë detyra kryesore në lëmin e energjetikës. Nxjerra e naftës në vitin 1985 të rritet 58-60 për qind kundrejt vitit 1980. Shtimi i prodhimit të naftës e të gazit të mbështetet në zonat në shfrytëzim dhe në ato të njohura e të zbuluara. Të përmirësohet shfrytëzimi sa më racional, mbi baza shkencore, i të gjitha vendburimeve naftë-gazmbajtëse dhe të shtrihet gjërisht përdorimi i metodave të dyta e punimet intensifikuese për të rritur në mënyrë të ndjeshme koeficientin e naftënxjerrjes në vendburimet ranore e gëlgerore. Të forcohet disiplina tekniko-shkencore dhe të rritet efektiviteti, veçanërisht në sektorin e shpimeve për naftë dhe gaz. Të intensifikohen punimet për të vënë në shfrytëzim minierat dhe uzinat e përpunimit të rërave bituminoze, duke përmirësuar edhe treguesit tekniko-financiarë të tyre.

Në uzinat e përpunimit të naftës të përmirësohet cilësia e karburanteve, të rritet gama e produkteve në përpunje me nevojat e ekonomisë dhe të ulen humbjet teknologjike.

Nxjerra e qymyrgurit dhe masat përritjen e cilësisë së tij, zgjerimi më tej i përdorimit të qymyrgurit për të zëvendësuar në maksimum përdorimin e lëndëve djegëse të lëngëta të jenë ndër detyrat më të rëndësishme për punonjësit e industrisë energjetike dhe të për-

doruesve të tjerë. Në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, nxjerrja e qymyrgut të rritet rrith 48 pér qind.

Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, të rritet rrith 16 pér qind, nga i cili me hidrocentrale rrith 14 pér qind. Të punohet pér një përdorim më racional të ujërave të hidrocentraleve gjatë gjithë vitit dhe pér një shfrytëzim më ekonomik të termocentraleve, si dhe të sigurohet një gatishmëri e lartë e tyre pér furnizimin e pandërprerë të përdoruesve me energji elektrike.

Në përdorimin e produkteve të para energjetike, si dhe të karburanteve të vendoset një regjim i rreptë kursimi me normativa shkençërisht të studiuara dhe një kontroll i rreptë e i vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Industria nxjerrëse e mineraleteve të zhvillohet me ritme të shpejta, mbështetur në rezervat minerale të njobura, duke intensifikuar nxjerrjen e tyre, në radhë të parë nga minierat në shfrytëzim dhe nga zgjerimi i tyre. Në vitin 1985, në krahasim me vitin 1980, nxjerrja e mineralit të kromit të rritet rrith 29 pér qind, e mineralit të bakrit rrith 53 pér qind, e hekur-nikelit rrith 2,5 herë. Në përputhje me nevojat e ekonomisë të rritet edhe nxjerrja e mineraleteve të fosforitit, të kuarcit, të kripës së gurit, të bloqeve të mermerit, të dolomiteve, të olivinitive, të magnezitit të boksideve, të nikeli-silikatit, të alabastit etj.

Krahas me shfrytëzimin e rezervave të mineraleteve të pasura, të rritet edhe nxjerrja e mineraleteve të varfra, duke zgjeruar në të njëjtën kohë pasurimin e tyre. Në industrinë nxjerrëse e të përpunimit të mineralete duke përfshirë edhe atë të qymyrgut, të rritet shkalla e mekanizmit dhe të zbatohen teknologjitet e reja pér nxjerrjen dhe pasurimin e tyre, duke siguar një ulje të ndjeshme të humbjeve e të varfërimit gjatë nxjerrjes së mineraleteve dhe të mbetjeve teknologjike në pasurim.

Metalurgjia e zezë dhe ajo me ngjyra të zhvillohen me ritme të larta pér të rritur më tej shkallën e përpunimit në vend të lëndëve të para minerare. Në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, prodhimi i çeliqeve të petëzuara të rritet rrith 76 pér qind, i ferrokromit karbonik rrith 3 herë, i bakrit blister rrith 28 pér qind. Të zgjerohet assortimenti dhe markat e çeliqeve, produktet prej bakri etj., dhe të përmirësohen në mënyrë të ndjeshme treguesit teknikë, ekonomikë e financiarë të shfrytëzimit të aftësive prodhuese të tyre.

Industria mekanike të sigurojë gatishmërinë e plotë të aftësive prodhuese dhe të mjeteve në përdorim që ka ekonomia, si dhe rritjen me ritme të shpejta të prodhimit të makinerive e të pajisjeve pér të plotësuar nevojat pér zgjerime, rikonstruksione e ngritjen e veprave protë reja me forcat tona dhe pér rritjen e shkallës së mekanizmit të proceseve të punës. Prodhimi i përgjithshëm i industrisë mekanike gjatë pesëvjeçarit të shtatë të rritet 43-45 pér qind, ripërtëritja e pjesëve të ndërrimit të rritet 54-56 pér qind dhe prodhimi i makinerive e i pajisjeve 56-58 pér qind.

Përsosja e vazhdueshme e organizimit dhe e drejtimit të industrisë mekanike nëpërmjet thellimit të kooperimit, specializimit e përqëndrimit dhe përgatitja në kohë e me cilësi të lartë e projekteve teknologjike e konstruktive të makinerive e të pajisjeve, vendosja mbi

baza teknologjike më të përparuara të prodhimit e të ripërtëritjes së pjesëve të ndërrimit të jenë rrugët kryesore pér të siguruar plotësimin e detyrave pér shtimin e prodhimit në këtë degë dhe pér shfrytëzimin më racional të çeliqeve e përmirësimin e cilësisë së prodhimeve.

Prodhimi i industrisë kimike në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, të rritet 62-65 pér qind. Të plotësohen më mirë nevojat e bujqësisë me plehra kimike e pesticide. Të rritet prodhimi i produkteve të rëndësishme që ka nevojë ekonomia, si soda e kalçinuar, soda kaustike, PVC, koksi metalurgjik, acidi sulfurik, detergjentët etj. Të punohet pér të eksperimentuar, përvetësuar e prodhuar kimikate të reja që ende importohen.

Industria e material-ndërtimit të zhvillohet në përputhje me nevojat e ekonomisë dhe të popullit, të përmirësohet cilësia dhe struktura e prodhimit, duke përvetësuar dhe prodhuar në shkallë të gjërë materiale të lehta dhe të ulet kostojë e tyre, me qëllim që të arrihet një përdorim sa më me efektivitet i fondeve të caktuara pér ndërtim-montimet. Prodhimi i industrisë së material-ndërtimit në vitin 1985 të jetë rrith 20-22 pér qind më i lartë se në vitin 1980.

Industria e drurit dhe e letërës të zhvillohet duke shfrytëzuar më mirë burimet që ka ekonomia pyjore e vendit. Të përdoren gjërisht lëndë të tjera jodeficitare pér të zëvendësuar në maksimumin e mundshëm lëndën drusore. Në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, industria e letërës të rritet 22-24 pér qind.

Industria e lehtë dhe ushqimore të zhvillohet nëpërmjet shfrytëzimit më të plotë të aftësive prodhuese në përdorim e të përsosjes së teknikës e teknologjisë. Të rritet më tej roli i saj, pér të plotësuar gjithnjë e më mirë nevojat e popullit me mallra të përdorimit të gjërë në sasi, në strukturë dhe në cilësi.

Në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, prodhimi i industrisë së lehtë të rritet 38-40 pér qind, kurse i industrisë ushqimore 23-25 pér qind. Të bëhen përmirësimë rrënjosore në cilësinë e prodhimeve, duke bërë në shkallë të gjërë ripërtëritje të vazhdueshme të produkteve me parametra cilësore më të lartë, dhe në shtimin e artikujve të rinj e të shumëllojshmërisë së assortimenteve, duke punuar më me iniciativë e fantazi. Të luftohet në mënyrë të vendosur kundër prirjeve të globalizmit, me qëllim që të sigurohet shtimi me ritme të shpejta i artikujve të imtë e shumë të imtë.

2. Zhvillimi i bujqësisë

Sigurimi gjithnjë e më mirë i nevojave të popullit dhe të ekonomisë me produkte bujqësore e blektorale kërkon që bujqësia jonë socialiste të ecë me ritme më të shpejta në rrugën e intensifikimit të prodhimit, duke rritur rendimentet në bujqësi, në blektori e në pemëtarë mbi bazën e trajtimit më shkencor të tokës, të përmirësimit të mëtejshëm të farërave dhe të racave, të rajonizmit e të specializimit më të mirë të prodhimit, si dhe të përsosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor mesatar vjetor në pësëvjeçarin e 7-të të rritet 30-32 pér qind në krahasim me atë të pesëvjeçarit të gjashtë. Nga rritja e rendimentit në pesëvjeçarin e 7-të të sigurohet mbi 90 pér qind e shtesës së prodhimit bujqësor.

Detyrë kryesore edhe në këtë pesëvjeçar mbetet prodhimi i drithë-rave të bukës, i cili për të pesë vjetët e marrë së bashku të rritet 1,500 për qind në krahasim me atë të pesëvjeçarit të 6-të. Të for-cohet qëndrueshmëria në shtimin e prodhimit dhe në rritjen e rendi-mentit në grurë dhe të arrihet kthesa rrënjesore për rritjen e pro-dhimit të misrit. Rendimenti mesatar vjetor për ha në misër të rritet 39 për qind, në krahasim me pesëvjeçarin e kaluar. Të forcohen ma-sat për mirëadministrimin dhe kursimin e drithë-rave në çdo drejtim

Të vlerësohet më mirë e të merren masa për shtimin me ritme të larta të bimëve industriale. Prodhimi mesatar vjetor i paxharshe-gerit të rritet 41-44 për qind, i lulediellit 56-58 për qind, i pambukut 55-58 për qind dhe i duhanit 46-49 për qind, në krahasim me atë të arritur në pesëvjecarin e 6-të.

Rëndësi e veçantë t'i kushtohet rritjes së prodhimit të patateve perimeve dhe fasuleve, duke prodhuar të gjitha llojet, sasitë e nevojshme dhe duke siguruar hershmërinë e tyre.

Në zonën fushore e bregdetare të vendit të merren masa për të kryer në një shkallë më të lartë intensifikimin e prodhimit bujqësor. Për këtë në mbi 100 mijë ha tokë të kësaj zone të bëhet një përqëndrim dhe përdorim më racional i bazës materiale, i teknikës bujqësore i investimeve dhe i punës së njerëzve, duke përsosur në të njëjtën kohë edhe marrëdhëni socialiste në prodhim.

Prodhimet blegtore të shtohen me ritme më të shpejta. Në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, prodhimi i qumështit të rritet 30-32 për qind, i mishit 53-55 për qind, i vezëve 50-52 për qind dhe i lesshit 34-36 për qind. Të merren masa për të vënë prodhimin e mishit mbazë më shkencore.

Të rritet rendimenti për krerë i produkteve blegtore si detyrë kryesore në blegtori. Përparësi t'i jetet shtimit me ritme të larta të bazës ushqimore, duke shënuar edhe një kthesë rrënjesore për sigurimin e përdorimin në mënyrë racionale të ushqimit për blegtorinë, të shpejtohen ritmet e përmirësimit racor të të gjitha llojeve të kafshëve nëpërmjet masave komplekse. Shtimi numerik i bagëtive dhe i shpendëve të bëhet me raca të përmirësuara me prodhimtari të lartë.

Për sigurimin e bazës ushqimore të nevojshme për blektori të dy-fishohen rendimentet nga kulturat e para foragjere, të zgjerohet mbjellja e foragjereve të dyta, të zgjerohet me ritme të shpejta silazhimi i ushqimeve, të grumbullohen plotësisht dhe të shfrytëzohen me niko-qirillëk të gjitha nënprodhimet e bimëve të arave dhe të merren masa për të rritur aftësinë kullosore të livadheve e të kullotave. Të futen gjerësisht në ekonomitë bujqësore teknologjitet e reja të përpunimit të ushqimeve të ashpra e të ushqimeve të koncentruara. Të tregohen kujdes i veçantë për mbarështimin e bagëtive të tufëzuara të oborreve kooperativiste, njëloj si për bagëtinë kolektive.

Të zgjerohen më tej sipërfaqet e mbjella me kultura drufrutore dhe të rritet kujdesi për zhvillimin e pemëtarisë në tërësi. Plotësim i bлоqeve eksistuese me numrin e nevojshëm të pemëve dhe kryerja e të gjitha shërbimeve sipas kërkesave agroteknike të përbëjnë ndë dreitimet kryesore të punës së ekonomive bujqësore.

Gjatë pesëvjeçarit të 7-të prodhimi i frutave të rritet 38-40 përshtatje.

qind, i rrushit 41-44 për qind dhe i agrumeve 42-45 për qind kundrejt prodhimit të pesëvjeçarit të 6-të për të pesë vitet e marra së bashku. Prodhami i ullirit në pesëvjeçarin e 7-të të rritet 68-70 për qind, kundrejt pesëvjeçarit të 6-të.

Të zhvillohet më tej ekonomia pyjore si ekonomi komplekse për të plotësuar më mirë nevojat e vendit për lëndë druri e prodhime të tjera nga pylli dhe të merren masa të vazhdueshme për të arritur drejt bilancimit të prerjeve me rritjen e pyjeve. Të punohet më mirë përuaritjen dhe trajtimin e kafshëve të egra.

Të merren masa të plota për shkripëzimin dhe përvetësimin e tokave bregdetare të bonifikuara, për përmirësimin e tokave acide si dhe sistemimin me ritme të shpejta të tokave në zonën kodrinore-malore, krahës përmirësimit e sistemimit të mëtejshëm të tokave në zonën fushore.

Aftësia ujitetëse të shtohet edhe me 50-51 mijë ha dhe të merren masat për ruajtjen e aftësive të veprave ujitetëse në përdorim. Të zgjerohet sipërfaqja e drenazhuar (drenazhimi i përhershëm nëntokësor) duke arritur në vitin 1985 në rreth 93 mijë ha, si dhe të shtohet përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve. Të hapen gjatë pesë-viecarit të 7-të 26 mijë ha toka të reia.

Rritja e efektivitetit të bazës materiale e teknike të bujqësisë dhe kombinimi më i mirë i saj me shtimin e punës së gjallë të jetë hallka dhe rezerva kryesore për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtoriale. Krahas forcimit të masave për trajtimin dhe përdorimin shkencor e racional të tokës dhe përritjen e pjellorisë së saj të rritet efektiviteti i përdorimit të plehrave kimike dhe organike.

Plotësimi i detyrave në bujqësi të mbështetet edhe në fuqizimin e mëtejshëm të bazës materialo-teknike të saj dhe në zbatimin e plotë të investimeve të domosdoshme që rritin pjellorinë e tokës. Të rritet më tej mekanizimi i punimeve në bujqësi, në radhë të parë duke shfrytëzuar më mirë parkun e traktorëve, të makinerive e të pajisjeve të tjera bujqësore, si dhe të merren masa të gjithanshme për të zgjeguar mekanizimin e vogël.

Të thellohet përqëndrimi i specializimi i prodhimit dhe i ekonomive bujqësore në përshtatje me kushtet ekonomike dhe natyrore dhe të harmonizohet më tej zhvillimi i bujqësisë, i blegtorisë dhe i pemëtarisë për plotësimin më mirë të nevojave të vendit me produkte bujqësore e blegtoriale.

Të ngrihet në një nivel më të lartë dhe të vihet në baza më shkencore njojja, përgjithësimi dhe zbatimi i përvojës së përparuar në të gjitha ekonomitë bujqësore, si dhe të punohet me këmbëngulje për zbatimin në shkallë më të gjërë në prodhim të arritjeve të reja të shkencës dhe të teknikës.

3. Për akumulimin, investimet dhe ndërtimet

Të shtohen me ritme të shpejta të ardhurat kombëtare mbi bazën e shtimit të produktit shoqëror dhe të rendimentit shoqëror të punës në të gjitha degët e ekonomisë.

Shpërndarja e përdorimi i të ardhurave kombëtare të bëhet në bazë të kërkesave të ligjeve ekonomike objektive të socializmit, duke i drejtar ato në zhvillimin me përparësi të sferës prodhuese e në radhë të parë për të mbështetur përparimin e ekonomisë si në industri, ashtu edhe në bujqësi. Të rritet me ritme më të shpejta produkti për shoqërinë ndaj produktit për vete nëpërmjet rritjes së rendimentit të punës dhe forcimit kudo të regjimit të kursimit, si dhe të sigurohet rritja më përparësi e fondit të akumulimit ndaj fondit të konsumit, duke rritur në radhë të parë akumulimin prodhues.

Fondi i akumulimit të rritet 74-76 për qind më shumë në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, kurse norma e akumulimit për të pesë vitet të marrë së bashku në pesëvjeçarin e 7-të të jetë 31-33 për qind. Mbi bazën e përdorimit racional të fondit të akumulimit të sigurohen fondet materiale e financiare të domosdoshme për investimet dhe ndërtimet themelore, për shtimin dhe fuqizimin e rezervave në të gjitha hallkat e ekonomisë dhe forcimin e aftësisë mbrojtëse të vendit.

Vëllimi i investimeve gjatë pesëvjeçarit të shtatë të rritet 22-24 për qind dhe ai i ndërtim-montimeve rreth 11 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e 6-të. Investimet dhe ndërtimet themelore të sigurojnë, në radhë të parë, zhvillimin me përparësi të degëve të produksionit material. Për zhvillimin e industrisë dhe të bujqësisë të përdoret rreth 74 për qind e vëllimit të përgjithshëm të investimeve.

Të shkurtohen afatet e ndërtimit të veprave në përgjithësi e në radhë të parë të veprave industriale, bujqësore dhe të transportit, në përmjet përqëndrimit më të mirë të forcave njerëzore e të mjeteve materiale e teknike, duke shfrytëzuar plotësisht e në mënyrë racionale makineritë, mekanizmat e mjetet e ndërtimit, si dhe të bëhet një kthesë e madhe në cilësinë e ndërtimeve, të sigurohen në kohë dhe me cilësi projektet e ndërtimit, sheshet e ndërtimit si dhe makineritë e pajisjet për veprat e reja.

Të zbatohen masa për një ulje të ndjeshme të kostos së ndërtimeve duke forcuar disiplinën në studimin e në hartimin e projekteve e të preventivave, të anës teknologjike e asaj ndërtimore. Të futen në shkallë shumë më të gjerë konstruksione më të lehta dhe kryerja e punimeve e vënia në shfrytëzim e veprave të bëhet me fazë dhe brenda afateve të caktuara.

4. Zhvillimi i transportit dhe i postëtelekomunikacioneve

Vëllimi i përgjithshëm i transportit të mallrave në vitin 1985 të rritet 34-36 për qind kundrejt vitit 1980, kurse vëllimi i transportit të mallrave në ndërmarrjet e Ministrisë së Komunikacioneve rreth 40 për qind. Për të rritur në një shkallë të lartë efektivitetin e transportit t'i jepet përparësi zhvillimit të hekurudhave dhe të forcohen puna e të merren masat për të bërë një kthesë rrënjosore në intensifikimin e transportit hekurudhor. Vëllimi i transportit të mallrave me hekurudhë në vitin 1985 në km të rritet 80-84 për qind. Të vazhdojë në mënyrë

të pandërprerë ndërtimi i linjave të reja hekurudhere dhe i degëzimeve të ndryshme.

Zhvillimi i transportit të sigurojë plotësimin në kohë të nevojave të ekonomisë e të popullit për lëvizjen e mallrave e të udhëtarëve. Të forcohen organizimi dhe drejtimi i transportit në bazë dhe në qendër për shfrytëzimin racional të mjeteve dhe të bashkërendohet më mirë puna midis llojeve të transportit. Transporti automobilistik të çlirohet nga të gjitha lëvizjet paralele me hekurudhën dhe nga kryqëzimet në lëvizjen e mallrave. Të rritet përdorimi i rimorkiove dhe të përmirësohet më tej rrjeti rrugor. Të merren masa për zhvillimin më të shpejtë të transportit me teleferikë si dhe të transportit ujor të brendshëm duke shfrytëzuar lumenjtë.

Të zhvillohen e të përmirësohen më tej shërbimet e postëtelekomunikacioneve për të përballuar nevojat në rritje të punonjësve dhe të ekonomisë, duke përmirësuar më shumë gatishmërinë, cilësinë dhe kulturën e shërbimeve.

5. Zhvillimi i tregtisë së jashtme

Vëllimi i qarkullimit të mallrave të tregtisë së jashtme në vitin 1985, në krahasim me vitin 1980, të rritet 57-59 për qind, duke i dhënë përparësi eksportit ndaj importit, me qëllim që bilanci i eksport-importit të sigurojë shtimin e rezervave valutore të vendit.

Të fuqizohet eksporti i mallrave tradicionale dhe të punohet për shtimin e mallrave të reja për eksport, duke shfrytëzuar të gjitha burimet dhe mundësitë që ka vendi. Mbi këtë bazë eksporti i mallrave në vitin 1985 kundrejt vitit 1980 të rritet 58-60 për qind. Të përmirësohen nga prodhuesit cilësia e mallrave të eksportit, ambalazhimi, etiketimi dhe markëtimi i tyre. Organet e tregtisë së jashtme të përmirësojnë punën për të siguruar e zgjeruar tregjet për mallrat e eksportit.

Të merren masa të vazhdueshme për të pakësuar në maksimumin e mundshëm importimin e lëndëve të para, materialeve, makinerive e pajisjeve etj. Në import të parashikohen kurdoherë vetëm nevojat më të domosdoshme. Të ulen normativat e përdorimit të lëndëve të para e materialeve të importit, të bëhen zëvendësime të tyre me lëndë të para e materiale të vendit, të mos sillet nga importi asnjë makineri, pajisje etj. që prodhohet ose mund të prodhohet në vend dhe pa siguruar plotësisht shfrytëzimin e atyre që janë në përdorim.

Të rriten përpjekjet e organeve të tregtisë së jashtme për të njojur më mirë tregjet dhe koniukturat për mallrat dhe çmimet për ta bërë eksport-importin sa më të leverdishëm.

6. Për rritjen e rendimentit të punës

Nga rritja e rendimentit të punës, në pesëvjeçarin e 7-të të sigurohet 46-48 për qind e shtesës së prodhimit industrial dhe 42-44 për qind e shtesës së vëllimit të ndërtim-montimeve.

Plotësimi i këtyre detyrate të arrihet nëpërmjet përsosjes së mëtejshme të organizimit socialist të punës, rritjes së shkallës së pajimit teknik dhe përsosjes së teknologjisë së prodhimit në çdo degë e sektor

të ekonomisë. Të punohet kudo për rritjen e shkallës së mekanizmit të proceseve të punës, sidomos në miniera, në bujqësi e në ndërtim. Të përmirësohet evidencimi dhe të forcitet më tej kontrolli i zbatimit me përpikmëri të kërkesave teknike e teknologjike të proceseve të punës dhe i disiplinës proletare në punë. Shpërblimi i punës së kryer të bëhet me rigorozitet sipas sasisë, cilësisë dhe shpenzimeve të prodhimit e të shërbimit, duke luftuar prirjet e rendjes pas interesit vetjak në dëm të interesit të përgjithshëm.

Të përsoset vazhdimisht normimi i punës mbi baza më të thella shkencore, në përshtatje me përparimin e teknikës, rritjen e ndërgjegjës së punonjësve dhe nivelin arsimor e tekniko-profesional të tyre. Të punohet për zëvendësimin e normave të vjetruara me norma të reja teknike në çdo degë e sektor të ekonomisë.

Të tregohet kujdes i vazhdueshëm për burimet e punës, për zënien e forcave të reja në punë, për t'i aktivizuar ato në frontin e ndërtimit socialist të vendit. Shpërndarja e burimeve të reja të punës të bëhet duke ruajtur kurdoherë përpjesëtime të drejta ndërmjet sferës prodhuese e joprodhuese. Të zhvillohet një punë e vazhdueshme dhe e gjerë edukative me rininë, që ajo, si kurdoherë, t'u përgjigjet nevojave të Atdheut për të punuar në frontet e reja të punës që krijohen në miniera, në bujqësi, në ndërtim dhe në degë të tjera të ekonomisë.

7. Për rritjen e nivelit material e kulturor të masave punonjëse

Me mundësitet që krijohen nga zhvillimi i ekonomisë gjatë pesë-vjeçarit të 7-të të rritet më tej niveli material e kulturor i masave punonjëse. Të ardhurat reale për fryshtësinë e vitit 1985 janë 8-10 përqind më shumë se në vitin 1980. Të ngushtohen më tej dallimet thembësore ndërmjet fshatit dhe qytetit dhe të rriten më tej fondet e konsumit shoqëror në plotësimin e nevojave materiale e kulturore të shqërisë sonë socialiste.

Qarkullimi i mallrave me pakicë në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, në tregtinë shtetërore të rritet 22-24 përqind.

Të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike të rritin më tej kujdesin për plotësimin e kërkesave të popullit me mallra të përdorimit të gjerë në strukturën e nevojshme, në sasi, në cilësi e në llojshmëri.

Organet e tregtisë së brendshme, në bashkëpunim me prodhuesit, të njobin e të studiojnë më mirë kërkesat e popullit dhe të marrin masa për planifikimin e shpërndarjen më të mirë të mallrave të përdorimit të gjerë sipas rretheve e zonave. Të rritet më tej kultura e shërbimeve dhe të përmirësohet sidomos ushqimi social.

Të rritet kujdesi për tregtimin e artikujve ushqimore në fshat nga kooperativat bujqësore dhe tregtia shtetërore. Të merren masa konkrete e të organizuara për të plotësuar si duhet detyrat e reja që dalin në këtë drejtim me tufëzimin e bagëtisë së oborreve kooperativiste.

Në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, shërbimet, riparimet, meremëtimet dhe punimet me porosi që kryhen për popullin nga ndërmarrjet komunale të rriten 45-47 përqind dhe në kooperativat bujqësore 80-84 përqind, duke përdorur kryesisht forca pune nga të qytetit. Gjatë

pesëvjeçarit të 7-të të vihen mbi baza më të organizuara shërbimet komunale në fshat. Të merren masa për rritjen e llojshmërisë së riparimeve e të shërbimeve dhe për rritjen e cilësisë së tyre.

Të përmirësimin e kushteve të banimit të popullit të ndërtohen nga shteti dhe me kontribut vullnetar gjatë pesëvjeçarit të 7-të rreth 50 mijë apartamente banimi. Gjithashtu, të plotësohen nevojat me materiale ndërtimore për ndërtimin e 31 mijë banesave nga vetë fshatarësia kooperativiste. Të furnizohen me ujë të pijshëm me ujësjellës shumë fshatra dhe të ndërtohen disa ujësjellës të rinj në qytete.

Zhvillimi i arsimit të synojë thellimin e mëtejshëm të punës në të gjitha hallkat e sistemit arsimor për forcimin e përbajtjes ideologjike e shkencore të shkollës, për përgatitjen më të mirë cilësore të kontingjenteve që ndjekin shkollat e kategorive të ndryshme për t'iu përgjigjur si duhet kërkesave të zhvillimit të sotëm e perspektiv të prodhimit, shkencës dhe kulturës.

Në shkollat e larta numri i studentëve në vitin 1985, në krahasim me vitin 1980, të rritet rreth 24 përqind. Të organizohet me baza më të shëndosha shkencore kualifikimi dhe specializimi pasuniversitar.

Të punohet vazhdimisht për të forcuar arsimin e mesëm profesional, për tërheqjen dhe ruajtjen e kontingjenteve të nxënësve, sidomos në shkollat pa shkëputje nga puna dhe për çeljen e profileve të reja. Numri i nxënësve në shkollat e mesme me shkëputje nga puna në vitin 1985, në krahasim me vitin 1980, të rritet rreth 46 përqind.

Të zgjerohet më tej arsimi parashkollar dhe të ngrihet në një nivel më të lartë puna për edukimin e fëmijëve në kopshte, sidomos në fshat.

Të zhvillohen e të masivizohen më tej arti, kultura fizike dhe sportet dhe të rritet vazhdimisht cilësia e tyre për t'i shërbyer më mirë edukimit e kalitjes revolucionare, si dhe mobilizimit të masave për realizimin e detyrateve në fushën e ndërtimit dhe të mbrojtjes së vendit.

Të zhvillohet më tej shërbimi shëndetësor, duke forcuar e zgjruar vazhdimisht masat e gjithanshme profilaktike për ruajtjen e përmirësimin e shëndetit të popullit dhe mbrojtjen e mjedisit, të ngrihet cilësia e shërbimit shëndetësor, veçanërisht e atij ambulator dhe të urgjencës. Të përsoset puna për zbulimin, parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet forcimit të shërbimit shëndetësor dhe parandalues për mbrojtjen e shëndetit të nënës e të fëmijës, sidomos në fshat. Të përsoset më tej shërbimi për të sëmurët në institucionet mjekësore. Të ngrihet roli i propagandës shëndetësore në përmirësimin e shëndetit të popullit.

8. Për zhvillimin e punës studimore shkencore e projektuese dhe për zhvillimin e teknikës e të teknologjisë së re në prodhim

Të zhvillohen e të thellohet më tej revolucionari tekniko-shkencor në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës mbi bazën e politikës e të botëkuarit marksist-leninist të Partisë.

Të thellohet më tej puna studimore shkencore komplekse tekniko-teknologjike dhe ekonomiko-financiare për rritjen dhe përmirësimin e treguesve të prodhimit, ndërtimit, shërbimeve etj. për rritjen e rendimentit të punës, të efektivitetit të shpenzimeve, të akumulimit etj.

Të gjitha studimet në fushën e energjetikës, në atë të naftës, të gjeologjisë e të minierave, të elektronikës, të industrisë mekanike dhe asaj kimike, në fushën e bujqësisë e të blegtorisë, të ndërtimit, të transportit etj. t'i shërbejnë zbatimit të detyrave që parashikon plani i 7-të pesëvjeçar dhe të çelin perspektiva të reja për zhvillimin e vendit për periudhat e mëtejshme.

Të bëhet një punë më e madhe për studimin dhe përvetësimin e matematikës, fizikës, kimisë, biologjisë etj., të domosdoshme për zhvillimin e shkencave të aplikuara dhe përparimin teknik. Për kushtet e vendit tonë të ngulet këmbë më shumë në zbatimin e arritjeve të shkencave, ku duhet të përqëndrohen edhe forcat kryesore për punëkërkimore-shkencore.

Të zgjerohet tematika e të ngrihet niveli i studimeve në fushën e shkencave shoqërore, sidomos për problemet e mëdha të revolucionit e të ndërtimit socialist.

9. Për shtimin e burimeve financiare nëpërmjet forcimit të regjimit të kursimit

Në bazë të detyrave të zhvillimit të ekonomisë dhe të rritjes së efektivitetit të produktit shoqëror, të përdorimit racional të të ardhurave kombëtare, sidomos të fondeve të akumulimit socialist, të sigurohet rritja me përparësi e të ardhurave të përgjithshme financiare ndaj shpenzimeve.

Të bëhet një punë e veçantë në bazë dhe në qendër për të forcuar regjimin e kursimit kudo, në çdo gjë dhe vazhdimisht dhe për të forcuar kontrollin me anë të lekut. Ulja e vazhdueshme e kostos, duke përsosur planifikimin dhe ndjekjen e realizimit të planit të shpenzimeve të prodhimit, të ndërtimit, të qarkullimit etj. të përbëjë një ndërburimet e faktorët më kryesorë për të shtuar mjetet financiare në çdo ndërmarrje, kooperativë dhe në shkallën e gjithë ekonomisë.

Të merren kudo masa për të ulur në mënyrë të ndjeshme normativa e lëndëve të para e materialeve dhe të fuqizohen vazhdimisht rezervat e tyre në të gjitha hallkat e ekonomisë.

Të organizohet mbi baza më të shëndosha ripërtëritja e disa produkteve, lëndëve të para etj., si të autogomave, lëndës plastike, të vajrave lubrifikante, si dhe të merren masa kudo për të mënjanuar mbeturinat dhe për t'i përdorur ato që krijohen si lëndë të para për prodhimin e artikujve të ndryshëm.

Të merren masa për të mënjanuar humbjet në ndërmarrje, në aktivitete dhe prodhime të ndryshme, duke i bërë ato rentabël. Të forcohen më tej qëndrimi socialist ndaj pronës dhe të gjitha masat e nevojshme për të siguruar paprekshmërinë dhe miradministrimin e saj.

Mbi këto baza të ardhurat e përgjithshme financiare në vitin 1985, kundrejt vitit 1980, të rriten 34-36 për qind, kurse shpenzimet e përgjithshme financiare 33-35 për qind.

10. Për përsosjen në rrugë revolucionare të marrëdhënieve socialiste në prodhim

Zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit gjatë pesëvjeçarit të 7-të të mbështetet edhe në përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve socialiste në prodhim, të cilat t'i çelin, si kurdoherë, rrugë të gjërë zhvillimit të forcave prodhuase, pjesëmarrjes së plotë të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse në drejtimin e shtetit e të ekonomisë, mobilizimit dhe rritjes së iniciativës së tyre krijuese për ndërtimin dhe imbrojtjen e socializmit.

Të forcohet më tej prona socialiste, sidomos në fshat, duke përkrahur dhe marrë të gjitha masat për zbatimin e iniciativës revolucionare të fshatarës së kooperativiste për tufëzimin e bagëtive të oborreve kooperativiste, duke synuar që kurdoherë të rritet më tej interes i kooperativistëve për fuqizimin e ekonomisë kolektive dhe që pjesa dërrmuese e të ardhurave të tyre të sigurohet nga pjesëmarrja në punën e përbashkët në kooperativë.

Të përsosen më tej marrëdhënet e shpërndarjes nëpërmjet zbatimit të parimit socialist të shpërblimit sipas sasisë e cilësisë së punës, duke rritur më tej interesimin e punëtorëve, kooperativistëve dhe punonjësve të tjerë dhe forcimin e përgjegjësisë individuale e kolektive për plotësimin e të gjitha detyrave të planit ekonomik e financiar. Të forcohet kontrolli në prodhim dhe kudo, me qëllim që të myllen të gjitha shtigjet që mund t'i lënë shkas marrjes me rrugë e forma të ndryshme nga shoqëria më shumë sesa i jepet asaj.

Të merren masa për të përsosur vazhdimisht organizimin dhe drejtimin e ekonomisë në të gjitha hallkat e saj, mbi bazën e zbatimit me konsekuencë të parimit të centralizmit demokratik. Të forcohet më tej karakteri shkencor i planifikimit dhe roli mobilizues i tij në zhvillimin me ritme të shpejta të forcave prodhuase dhe në zhvillimin përpjesëtimor të riprodhimit të zgjeruar socialist.

* * *

Zbatimi i detyrave madhështore të planit të 7-të pesëvjeçar mbi bazën e parimit të mbështetjes në forcat e veta dhe në situatat ndërkombëtare të krijuara kërkon forcimin e mëtejshëm të rolit udhëheqës të Partisë, thellimin e luftës klasore kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe shfaqjeve të huaja liberale e burokratike, ngritjen e nivelit arsimor, kulturor e tekniko-profesional të punonjësve, përmirësimin e përgatitjes dhe forcimin e gatishmërisë luftarake të të gjithë popullit për imbrojtjen e Atdheut.

Kongresi i 8-të i PPSH, duke miratuar direktivat për planin e 7-të pesëvjeçar, shpreh bindjen e thellë se, si kurdoherë, klasa pu-

nëtore, fshatarësia kooperativiste dhe i gjithë populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë dhe në unitet të çelikët e të pathyeshëm mendimi dhe veprimi do të rritin luftën, përpjekjet dhe mobilizimin për t'i bërë ballë dhe për të shpartalluar rrëthimin dhe bllokadën e egër imperialisto-rezisioniste, për të plotësuar me sukses detyrat që caktohen në këto projektdirektiva.

Në pesëvjeçarin e ri revolucioni dhe ndërtimi socialist i vendit tonë do të ngrihen edhe më lart. Shqipëria socialiste do të bëhet edhe më e fuqishme, jeta e popullit më e begatshme dhe atdheu ynë më i lëlzuar.

Garanci për të sotmen e mrekullueshme dhe për të ardhmen e ndrritur të popullit janë vija dhe politika e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, udhëheqja e urtë e saj, e Komitetit Qendror të Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, që, si kurdoherë, do ta çojnë popullin në fitore të reja edhe më madhështore, do ta ngrenë Atdheun tonë në lartësi të reja në rrugën e socializmit.

KONGRESI I 8-të I PPSH

Tiranë, më 6 nëntor 1981.

(«Zëri i Popullit», nr. 270
— 10.383, datë 10
nëntor 1981).

Nga diskutimi i Shokut Llambi Gegprifti

Raporti i shokut Enver, paraqitur në këtë Kongres, me të cilin unë jam plotësish dakord, shpreh në mënyrë të koncentruar luftën, përpjekjet dhe arritjet e mëdha të popullit dhe të Partisë sonë si në planin kombëtar, ashtu dhe atë ndërkombetar.

Pesëvjeçari i kaluar qe një periudhë historike e lavdishme për popullin dhe Partinë tonë, e ngsjeshur me luftë e punë heroike për kapërcimin e vështirësive e pengesave, për të çarë rrëthimin e bllokadën e egër imperialisto-rezisioniste dhe për të përballuar sabotimet e rezisionistëve kinezë. Në këtë luftë, populli ynë, me Partinë në krye, si kurdoherë, doli fitimtar dhe e shpuri akoma më përpara çështjen e mëdhe të ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë, duke fituar kështu përkrahjen dhe dashurinë e zjarrtë të popujve revolucionarë të botës dhe partive marksiste-leniniste, që luftojnë për revolucionin, për socializmin.

Partia jonë, vazhdimisht ka zbatuar me konsekuençë një politikë ekonomike të drejtë, marksiste-leniniste dhe, në luftë të ashpër dhëmb për dhëmb me armiqëtë e brendshëm, me titistët jugosllavë, më pas me rezisionistët sovjetikë dhe më vonë me ata kinezë, i ka dhënë përaparësi industrializimit socialist të vendit, duke e konsideruar atë si degën udhëheqëse të ekonomisë.

Jeta e ka vërtetuar drejtësinë e kësaj politike të urtë, largpamëse e revolucionare dhe sot vendi ynë zotëron një industri të fuqishme, shumëdegëshe e moderne, e cila e ka forcuar së tepërmë pavarësinë e vendit dhe është bërë një faktor bazë për ndërtimin me sukses të socializmit dhe mbrojtjen e Atdheut.

Gjatë pesëvjeçarit të 6-të ritmet e shtimit të prodhimit industrial ishin të larta, ato arriten me një mesatare vjetore prej 11,8 përqindësh. Qdo vit u shtuan rezervat e mineraleve të dobishme dhe llojet e tyre. U vunë në shfrytëzim miniera e vepra të rëndësishme industriale, si kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë» në Elbasan, uzina e ferrokromit në Burrel, ajo e pirometalurgjisë në Laç, fabrika e pasurimit të kromit në Kalimash, e bakrit në Rehovë e në Fushë-Arrëz, e hekurit në Gurin e Kuq etj.

Për nder të 40-vjetorit të themelimit të Partisë dhe Kongresit të 8-të të saj, punonjësit e industrisë dhe të minierave kanë ndërmarrë me dhjetëra nisma dhe lëvizje të fuqishme revolucionare: për rritjen e rendimentit dhe të cilësisë së prodhimit, për kursimin e lëndëve të para e të materialeve të importit, për mekanizmin e proceseve të punës dhe, në këtë kuadër, është ndërmarrë aksioni i madh për mekanizmin e plotë të proceseve të punës në katër minierat më të mëdha të

vendit tonë, brënda këtij viti, duke i shndërruar ato në shkolla të larta për mekanizimin e plotë të gjitha minierave të tjera të vendit.

Eshtë kuptimplotë të përmendim këtu faktin se për të vënë në jetë porositë e Partisë, punonjësit e industrisë minerare kanë shpërthyer një lëvizje me vlerë të madhe ideopolitike dhe ekonomike për të shumëfishuar ritmet e avancimit të punimeve minerare, mbi bazën e përsosjes së organizimit të punës, shfrytëzimit më të plotë të kohës dhe rritjes së shkallës së mekanizmit me forcat e veta.

Kështu vetëm muajt e fundit mjaft brigada arritën të hapin 270 deri në 340 ml në muaj nga 30-40 ml që avanconin mesatarisht për çdo muaj vitin e kaluar.

Duke e parë çështjen e ritmeve të shpejta si faktor tepër të rëndësishëm për arritjen dhe tejkalimin e objektivave të këtij pesëvjeçari dhe si kyçin e realizimit të 1.573.000 ml punime minerare, që janë baraz me më shumë se ato të hapura në pesëvjeçarin e 6-të dhe të 5-të të marrë së bashku, ne kemi marrë masa dhe do t'i thellojmë ato, përtatë shtrirë këtë lëvizje jo vetëm në industrinë minerare, por edhe në të gjitha fushat e veprimtarisë së dikasterit tonë.

Plani i 7-të pesëvjeçar cakton objektiva madhështore për vitet 1981-1985 dhe hap perspektiva të reja e të shkëlqyera për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë socialistë e përgjithësisht e përgjithësuar të aftësisë mbrojtëse të vendit. Industrisë mekanike i shtrohen detyra të mëdha, ajo do të përballojë prodhimin e shumë makinerive dhe pajisjeve që nevojiten për ngritjen e 750 objekteve të reja, përzgjerimin dhe modernizimin e qindra linjave dhe fabrikave ekzistuese, përrritjen e mekanizmit të proceseve të punës në miniera, bujqësi, ndërtim, sharra, përrritjen e përpunimit të lëndëve të para dhe përmirëmbajtjen e sigurimit e gatishmërisë së krejt bazës teknike të ekonomisë sonë.

Duke folur për detyrat e industrisë mekanike në këtë pesëvjeçar, shoku Enver në Raportin e tij tha se ajo do të futet në një shkallë më të madhe në prodhimin e pajisjeve e të makinerive për ndërtimin e linjave e të fabrikave të reja dhe përrritjen e rikonstruksioneve e zgjerimeve të ndryshme të kapaciteteve prodhuese.

Përtatësuar me sukses këto detyra, përparrë nesh, punonjësve të industrisë, organizatave të Partisë, organave shtetërore dhe të ekonomisë, vihet detyra të ngremë në një nivel më të lartë punën ideo-politike, të krijojmë te të gjithë punonjësit bindje të thella përmundësitet e plotësimit të kësaj detyre madhështore dhe të të gjithë planit pesëvjeçar, të krijojmë koncepte të reja, shkencore, në punën tonë, dhe të shfrytëzojmë sa më racionalist rezervat e pashtershme që ekzistojnë dhe krijojen në procesin e prodhimit.

Zhvillimi me ritme të shpejta i prodhimit të makinerive dhe pajisjeve, në këtë pesëvjeçar, shtron para industrisë mekanike si detyrë imediatë organizimin dhe përsosjen e mëtejshme të punës studimore dhe projektuese.

Në pesëvjeçarin e 7-të, kundrejt pesëvjeçarit të 6-të vetëm për objektet e reja, prodhimi në vend i makinerive do të shtohet 2,6 herë. Përmekanizimin e proceseve të punës, në tërë degët e ekonomisë do

të prodhohen mbi 265 000 copë makineri dhe, si rrjetë, volumi i punës projektuese do të rritet 5 herë.

Partia na porosit që të mos konstruktojmë atë tip që projektohet e ndërtohet më lehtë, por të konstruktojmë atë që është më i mirë, më i fortë, me rendiment më të lartë, më i përshtatshëm dhe më i leverdishëm.

Plotësimi me sukses i kësaj detyre dhe i këtij volumi të madh pune projektuese kërkon nga të gjithë ne, para së gjithash, një metodë të re pune, një organizim dhe planifikim më të mirë dhe një luftë këmbëngulëse për zbatimin e vendimeve të Partisë. Ne duhet t'i vëmë shpatullat më mirë se deri më sot rritjes së cilësisë dhe të rendimenti në projektim, si faktor vendimtar për të përballuar volumin e madh të punës projektuese. Moment me rëndësi të veçantë në këtë drejtim përbën përsosja e mëtejshme e organizimit të punës për projektim, nga një organ i vetëm, i pjesëve dhe i makinerive standard. që kanë përdorim shumë të gjere.

Ne do të luftojmë më mirë që projektuesit dhe konstruktorët të lidhen më ngushtë me prodhimin, të studiojnë dhe përgjithësojnë përvojën e përparuar të punëtorëve, të reja e teknikës dhe të shkencës në vendin tonë dhe në botë. Duke organizuar e përsosur më mirë informacionin tekniko-shkencor, të forcohet bashkëpunimi me teknologët dhe mjeshtrit e prodhimit, duke pasur gjithnjë parasysh se, me makinat e konstruktuar nga ata, nesër do të punojnë njerëzit me dije më të gjera. Në këtë kuadër, do të forcojmë akoma më shumë bashkëpunimin projektues, investitorë e zbatues, në mënyrë që porositë të bëhen në kohën e duhur, të jenë të plota, me cilësi të lartë, t'i paripjnë prodhimit, ndryshtë krijojen vështirësi që rëndojnë ekonominë.

Zhvillimi i shpejtë i prodhimit të makinerive dhe pajisjeve në këtë pesëvjeçar kërkon me urgjencë ngritjen në një shkallë shumë më të lartë të teknologjisë së prodhimit. Në këtë fushë ne do të luftojmë në mënyrë të organizuar kundër koncepteve e praktikave artizanale që shfaqen në mjaft uzina dhe oficina, dhe do të bëjmë kthesë të fortë në zbatimin e një teknologji të përparuar, të mbështetur në zbatimin e metodave dhe të proceseve progresive, që sigurojnë tregues tekniko-ekonomikë, sa më të lartë, siç janë metoda e derdhjeve me forma vetëngurtësuese, e cila, nga eksperimentimet që kemi bërë muajt e fundit, tregon se do të sjellë një rritje të ndjeshme të cilësisë së derdhjeve, metoda e përpunimit në grup të detaleve sipas ngjashmërisë teknologjike, të cilën kemi filluar ta zbatojmë në kombinatin e autotraktorëve «Enver Hoxha» dhe do të luftojmë ta zgjerojmë më tej në uzinat e tjera. Detyrë tjetër e rëndësishme që ne duhet ta zgjidhim sa më parë është edhe ajo që industria mekanike të pajiset dhe të kompletohet me një dokumentacion më të plotë teknik e teknologjik. Gjithashtu, ne duhet të vlerësojmë dhe zgjidhim më mirë edhe problemet e rritjes së mëtejshme të shkallës së mekanizmit të proceseve të prodhimit në industrinë mekanike nëpërmjet përdorimit më të gjërë të pajisjeve hidraulike, pneumatike, mekanike e elektrike.

Kalimi në një shkallë të gjërë në prodhimin e makinerive dhe të pajisjeve nuk mund të mendohet e të realizohet pa zbatuar në praktikë porositë e Partisë lidhur me përqëndrimin, specializimin dhe kooperimin e prodhimit.

Lidhur me këtë ne po planifikojmë dhe po marrim studime e masa të rëndësishme për ngritjen e linjave e të reparteve të specializuara, në radhë të parë, për ato pjesë, nyje e aggregate të standardizuara, që kanë përdorim shumë të gjerë në prodhimin e makinerive dhe të pajisjeve të ndryshme.

Këto do të krijojnë kushte për të rritur cilësinë, ritmet e prodhimit, gatishmérinë e parkut ekzistues të makinave dhe plotësimin në mënyrë të përqëndruar të nevojave të ekonomisë popullore me një numër të konsiderueshëm artikuash të rëndësishëm të industrisë mekanike. Njëkohësisht po studiojmë përsosjen e mëtejshme të përqëndrimit dhe kooperimit për përgatitjen e gjysmëfabrikateve me derdhje dhe stampim të përqëndruar, sidomos në qytetet e mëdha industriale.

Zgjidhja komplekse e kooperimit, përqëndrimit, specializimit dhe e të gjitha detyrave të tjera që ka industria mekanike kërkon përsosjen e mëtejshme të të gjithë praktikës së planifikimit, nga qendra në bazë, ku, me gjithë përparimet, mbetet shumë për t'u bërë, vazhdoi më poshtë, shoku Llambi Gegprifti.

Futja e industrisë mekanike në rrugën e gjerë të prodhimit të makinerive, theksoi ai, shtron më shumë se kurrë nevojën e rritjes në një shkallë më të lartë të kualifikimit të punonjësve, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të mendimit të tyre krijues.

Kuptohet se në kualifikimin e punonjësve kemi rezerva të brendshme të mëdha për të bërë realitet kthesën që kërkon Partia në zhvillimin e industrisë mekanike. Në radhë të parë e mbi të gjitha kualifikimin duhet ta vëmë mbi baza më të shëndosha organizative dhe tekniko-shkencore, duke e parë atë në lidhje të ngushtë me detyrat aktuale dhe perspektivë, si dhe duke luftuar më me forcë kundër formalizmit, liberalizmit dhe koncepteve të tjera frenuese. Kujdes të veçantë do t'i kushtojmë edhe profilizmit e specializimit të mëtejshëm të punonjësve në kurse, shkollat e mesme dhe të larta, për t'iu përgjigjur natyrës së vendeve të reja të punës dhe nevojave më të ngutshme që kemi. Do të marrim masa të gjithanshme për përgatitjen në kohë të njerëzve sipas profileve, në mënyrë që të përvetësohen sa më shpejt teknologjia dhe kapacitetet e objekteve të reja.

Programi madhështor që do të miratojë ky kongres, tha në përfundim shoku Llambi Gegprifti, shtron objektiva dhe detyra të mëdha edhe për minatorët, gjeologët, sharrëxhinxjtë, metalurgët dhe gjithë punonjësit e tjerë të industrisë dhe minierave. Luftën për realizimin e tyre, ashtu si gjithë punonjësit e vendit, e kemi nisur me sukses dhe po me sukses do ta vazhdojmë atë gjatë gjithë pesëvjeçarit.

Komunistët, kuadrot dhe gjithë punonjësit e industrisë dhe minierave, duke pasur çdo ditë e çdo orë në mëndje e në zemër direktivat drithëdhënëse të Partisë sonë heroike dhe vendimet historike të këtij kongresi, do të luftojnë me mish e me shpirt dhe do të shkrijnë të gjitha energjitet e tyre për të zbatuar deri në një të gjitha detyrat dhe objektivat madhështore të Kongresit të 8-të dhe mësimet marksiste-le-niniste të udhëheqësит të dashur e të shtrenjtë të Partisë dhe popullit tonë, shokut Enver Hoxha.

Nga diskutimi i shokut Bujar Pata

Në diskutimin e tij shoku Bujar Pata, në mes të tjerash, tha: Në përputhje me detyrat e vëna nga Partia, punonjësit e shërbimit gjeologjik kanë punuar për të zbuluar të fshehtat e nëntokës sonë, thesarët e saj, dhe për t'i vënë ato në shërbim të Atdheut e të zhvillimit të tij të gjithanshëm. Rezultat i kësaj pune janë njojja e ndërtimit gjeologjik dhe i potencialit mineralmbajtës të vendit, zbulimi i rezervave të kromit, bakrit, hekurnikelit, fosforiteve, materialeve refraktare, ndërtimit dhe lëndëve të tjera të para materiale. Sot vendi ynë ka një blanic të tillë të lëndëve të para minerare, që jo vetëm përballon nevojat tona për industrinë përpunuuese ekzistuese, por është siguruar një përspektivë e qartë dhe e qëndrueshme për të ardhmen edhe për ngritjen e degëve të tjera të rëndësishme të industrisë, si dhe të sigurohen të ardhura në valutë nga eksportimi i tyre. Volumet fizike të shpim-kërkimeve për mineralet e ngurta në pesëvjeçarin e 6-të ishin 40 herë më të mëdha se në pesëvjeçarin e 1-rë. Nga 5-6 minerale që njihej përohej për kërkimin e zbulimin e tyre në pesëvjeçarin e 1-rë, në pesëvjeçarin e 6-të u punua për kërkimin e zbulimin e rezervave industriale e gjeologjike për më tepër se 37 lloje mineralesh.

Pastaj ai, mbasi foli për rrugën e zhvillimit të minierave tona, theksoi:

Niveli i prodhimit që parashikohet, si dhe detyra tjetër e rëndësishme që më shumë se 60 për qind e rritjes të përballohet nga rritja e rendimentit, shtrojnë përpara nesh që në mënyrë të shpejtë të bëjmë mekanizimin e plotë të punimeve. Detyra e minatorëve, specialistëve, me komunistët në ballë, është arritja e objektivit për mekanizimin 100 për qind të transportit nëntokësor e sipërfaqësor dhe 80 për qind e ngarkimit dhe e shkarkimit. Rritja e kapacitetit prodhues të fronteve lidhet sa me përmirësimin e teknologjisë së shfrytëzimit, aq edhe me mekanizimin e punës. Iniciativa e katër minierave më të mëdha ndër të cilat edhe Bulqiza, për të mekanizuar 100 për qind proceset e punës është e guximshme, por plotësisht e realizueshme. Iniciativa e tyre do të shtrihet në të gjitha minierat e vendit dhe përkëtë janë marrë masat e janë përcaktuar konkretisht detyrat. Plotësimi i detyrës për mekanizimin e punës ka rëndësi të madhe politike dhe ideologjike, sepse lehtëson më tej punën e punëtorit, kualifikon më tej atë, lufton konceptet frenuese se miniera kërkon njerëz «të fortë», se miniera ka nevojë «vetëm për lëndë eksplozive e ajër të komprimuar» e të tjera, si dhe ka rëndësi të madhe ekonomike përritjen e rendimentit të punës e pakësimin e shpenzimeve për njësi prodhimi. Detyra të ngjeshura ka industria mekanike për t'iu përgjigjur me pjesë ndërrimi, nyje komplete e të pjesshme, me qëndrue-

shmöri, fortësi, toleranca e përmasa që u përgjigjen kërkesave të mierave në kushtet e punës së nëntokës me lagështirë dhe mjedis abraziv.

Krahas nxjerrjes së mineralete, zhvillim të hovshëm merr dega më e re, pasurimi i mineralete. Fabrikat e pasurimit, që parashikohen të ndërtohen, do të bëjnë që rrëth 50 pér qind e mineralit të kromit të pasurohet duke nxjerrë koncentrate të pasura. Në pasurimin e mineralete rëndësi do t'i kushtohet thellimit të mëtejshëm të pasurimit pér të rritur shkallën e rikuperimit si dhe pér të filluar pasurimin e kromeve shumë të varfëra. Partia ka porositur. «Ka ardhur koha të bëhen studime më të plota e vlerësime më të mira edhe pér ato lëndët para që deri tani konsiderohen të varfëra». Studimet, projektimet si dhe ndërtimet e fabrikave të pasurimit pér krom, bakër, hekur-nikel, qymyrgur etj., janë inkurajuese, por rritja e prodhimit nga minierat, futja në qarkullim e rezervave e bëjnë të ngutshme shpejtimin e pasurimeve si rrugë që çon në vlerësimin më të madh të pasurive natyrore të vendit, ashtu edhe në kursime të drejtëpërdrejta të transportit e të tjerë. Nga fabrikat e pasurimit dhe uzinat e shkrirjes në përgjithësi dhe nga fabrikat e pasurimit të kromit në veçanti do të punohet që t'u shkohet gjer në fund proceseve të pasurimit, si një ndër rrugët e ngritjes së mëtejshme të vlerave të vendburimeve. Përvoja e fituar tashmë në shumë miniera, krahas nxjerrjes së mine-është e madhe, tashmë në shumë miniera, krahas nxjerrjes së mineralete, mendohet e punohet më mirë edhe pér përsosjen në teknologjien e nxjerrjes, pér seleksionimin e pasurimin. Megjithëkëtë, teknologja e shfrytëzimit dhe e pasurimit ka përparrë mjaft rrugë pér të shkuar në përsosje, sidomos përcaktimi e zbatimi i parametrave optimale të pajisjeve në qdo proces, zbatimi i një regjimi të rreptë teknologjik në të gjitha fazat e pasurimit dhe kualifikimin e mëtejshëm tekniko-shkencor të punëtorëve e specialistëve të fabrikave të pasurimit. Me një punë më të thelluar do të arrijmë që të shfrytëzojmë sa më me dobi qdo mineral, të sigurojmë një shkallë rikuperimi rrëth 95 pér qind të elementëve të dobishme. Është e nevojshme që pasurimi i mineralete të shtohet më tej dhe përspektiva të afrohet jo vetëm pér disa mineralet, por pér të gjitha mineralet, pér kthimin e tyre në koncentrate. Kjo është cilësuar nga Partia si rrugë me rëndësi pér rritjen e efektivitetit ekonomik të industrisë minerare.

Optimizmi revolucionar, besimi i patundur te Partia, fryma e shëndoshë e sakrificës, shpirti sulmues që karakterizon komunistët, minadorët dhe tërë punonjësit e mierave e gjeologjisë, me mësimet e torët dhe tërë punonjësit e mineralete e gjeologjisë, me mësimet e Partisë dhe të shokut Enver në mendje e në zemër, përfundoi shoku Bujar Pata, do të bëjnë të mundur plotësimin e detyrate madhështore Bujar Pata, që shtron Kongresi i 8-të i Partisë sonë, pér t'i dhënë popullit gjithnjë e më shumë mineralet dhe pér të ndihmuar në thyerjen e bllokadës së egër imperialisto-revizoniste.

Nga diskutimi i shokut Dedë Kolndreu

Për mua, birin e një punëtori të thjeshtë, që Partia më bëri komunist e gjeolog, tha në diskutimin e tij shoku Dedë Kolndreu, është nderi më i madh dhe gjësim i papershkuar, që më jepet rasti t'i rapportoj këtij kuvendi të madh se detyrat e pesëvjeçarit të 6-të i realizuam dhe i tejkluam me sukses. Rezervat minerale të pesëvjeçarit të kaluar i realizuam në 4 vjet. Në krahasim me pesëvjeçarin e 5-të, dhamë 73 pér qind më shumë rezerva industriale dhe dyfishuam rezervat gjeologjike. Plani i shpimeve u realizua në 4 vjet e 10 muaj, rendimenti u realizua 113 pér qind dhe kursyem më shumë se 3 milionë e gjysmë lekë.

Për realizimin e detyrate vëmendjen e kemi përqëndruar në rritjen e nivelit shkencor të studimeve, pér zbulimin e vendburimeve të mineralete të dobishme, si hallkë e rëndësishme pér arritjen e objektivave ekonomike të caktuara. Në këtë drejtim jemi udhëhequr nga direktiva e Partisë se «Gjeologjia është një shkencë me disiplinë të rreptë, që kërkon saktësi të kontrollueshme në qdo veprim dhe në qdo moment», ajo me rolin e saj «duhet t'i paraprijë zhvillimit të industrisë dhe t'i hapë shtigje të reja».

Pikërisht, më 7 korrik 1978, tha më poshtë ai, kur revizionistët, kinezë prenë në mënyrë arbitrale kreditë ndaj vendit tonë, në Rubik u ngrit flamuri i kuq i fitores, që shënoi rezultatin e parë të kërkimeve gjeologjike në këtë vendburim. Ky rezultat u pasua nga shumë të tjerë dhe në prag të 40-vjetorit të lavdishëm të themelimit të Partisë, u bë e mundur të jepet pér shfrytëzim vendburimi i Rubikut, i cili pér nga rezervat e zbuluara është afér 4 herë më i madh sesa ishin rezervat e shfrytëzuara gjatë gjithë jetës së kësaj miniere. I rëndësishëm është fakti se perspektiva e këtij vendburimi është hapur në të gjitha drejtimet.

Rezultate të mira u morën dhe në objekte të tjera, pikërisht në ato vende ku vite më parë nga gjeologët e huaj ishte thënë se «nuk ka mineral».

Përveçsimi dhe zbatimi gjithnjë më mirë i metodave shkencore të përparuara e komplekse gjeologjike, vazhdoi shoku Dedë Kolndreu, organizimi i punës shkencore dhe kryerja sa më e shpejtë e në têrësi e punimeve gjeologo-kërkuese e zbuluese ka rritur efektivitetin e punimeve. Në 6-mujorin e parë të këtij viti u realizua pér rezervat minerale, industriale dhe gjeologjike, të marra së bashku, një efektivitet 178 pér qind, ose mbi 30 tonë mineral pér metër linear shpim. Mirë ka ndihmuar têrheqja e mendimit të punëtorëve dhe aktivizimi i spesialistëve.

Në kërkimet gjeologjike, në qdo hap të punës sonë, duke bashkë-

punuar me Institutin e Gjeologjisë e të Minierave, Fakultetin e Gjeologjisë e të Minierave dhe ndërmarrjet gjeologjike e minerare të vendit tonë, ne i jemi përbajtur orientimeve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror për të shtuar rezervat në vendburimet ekzistuese, për të kërkuar afër tyre dhe në zonat e reja. Nëpërmjet konsultave dhe sesioneve shkencore të përbashkëta, janë përfunduar analiza për arritjet e të metat e vërtetuara. Me përgjithësimet e bëra është arritur në konkluzione teorike e praktike me rëndësi që ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të prodhimit. Ky material i rëndësishëm pasuron literaturën gjeologjike shqiptare, që ka karakter të theksuar albanologjik dhe, si e tillë, ka tërhequr vëmendjen edhe të shkencëtarëve të huaj, që e kanë mirëpritur dhe e kanë vlerësuar atë. Në bashkëpunim me shërbimin gjeologjik të disa minierave të Mirditës, po zgjidhen probleme të zgjatjes së jetës së shfrytëzimit të vendburimeve, nëpërmjet zgjerimit të perspektivës në anë dhe thelli, me uljen e humbjeve dhe të varférimit të mineraleve. Një punë më e mirë po bëhet për përmirësimin e metodikave të kërkimit, si dhe për të përcaktuar rrjetet optimale të kërkim-zbulimit etj.

Në pesëvjeçarin e 7-të na shtrohen detyra akoma më të mëdha. Në përputhje me rritjen e sasisë së nxjerrjes së mineralit të bakrit nga shfrytëzimi i nëntokës prej 52 për qind më tepër se në pesëvjeçarin e 6-të, ne me punën tonë, duke zbatuar drejt dialektikën materialiste për kalimin nga e njohura në të panjohurën, do të zgjerojmë vendburimet ekzistuese, duke synuar që të gjemjë mineral të pasur, pa lënë pas dore mineralin e varfér; do të konkretizojmë dhe zbulojmë 2 vendburime të tjera për të cilat janë planifikuar investime, me synim që kërkimet përfundimtare të zgjerojmë vendburimet e kërkimit që e gjithësia realizimin dhe tejkalimin e planit të nxjerrjes së mineraleve, por të garantojmë me rezerva industriale planet e ardhshme pesëvjeçare. Për të gjitha këto kërkohet nga ne një angazhim më i madh në problemet studimore aktuale dhe të perspektivës, në zgjidhjen e detyrave teknike e metodike, në eksperimentimin e metodave të reja gjeologo-kërkuese e zbuluese, që mendimi shkencor të na udhëheqë gjithnjë e në qdo drejtim.

Do të zgjerojmë përdorimin e kompleksit të kërkimit, do të përdorim një raport më të drejtë ndërmjet punimeve të kërkimit me ato të zbulimit, të shpimeve të cekta me ato të thella. Më mirë se deri tanë do të përdoren metodat e reja të gjeofizikës nëntokësore. Të gjitha këto do të bëjnë të mundur që të rritet efektiviteti i punimeve, të shpejtohen ritmet e kërkimit e zbulimit, si dhe dhënia e vendburimeve të reja përfshyrët, duke përmirësuar edhe treguesit ekonomikë e financiarë.

Ne e sigurojmë kongresin se këto detyra do t'i zbatojmë deri në një, se nëntoka janë është e pasur, njerëzit tanë i zbulojnë këto pasuri me guxim, se forcë jetëdhënëse na jep Partia e shoku Enver dhe përparrana presin vetëm fitore.

(Marrë nga «Zeri i Popullit»)

NË RRUGËN E NGRITIES SË MËTEISHME TË NIVELIT TË PUNËS MËSIMORE-SHKENCORE TË FAKULTETIT TË GJEOLGIJISË DHE TË MINIERAVE TË UT

— Eshref Pumo* —

I mobilizuar për të vënë në jetë vendimet shumë të rëndësishme të plumeve të kohëve të fundit të KQ të PPSH dhe të mësimeve jetëdhënëse të shokut Enver Hoxha, kolektivi punonjës i Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit të Tiranës plotësoi me sukses detyrat dhe zotimet e ndërmarrë në kuadrin e 40-vjetorit të themelimit të Partisë dhe të Kongresit të 8-të të saj. Nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, duke luftuar për të zbatuar një përfundimtare të zhvillimit të shkencës e teknikës bashkë-kohore. Gjatë pesëvjeçarit të kaluar katedrat tonë quan më përparrë punën e fakultetit. Në katër degët dhe në shtatë profilet e fakultetit u diplomuan 562 kuadro e specialistë, të cilët tanë po punojnë me sukses në kërkim-zbulimin dhe në shfrytëzimin e pasurive nëntokësore të Atdheut tonë socialist. Një punë mjaft e gjërë është bërë në drejtim të formimit e të edukimit të kuadrove të reja si dhe janë zgjruar e forcuar më tejjeta e mendimi shkencor i punonjësve të fakultetit. Gjatë pesëvjeçarit të kaluar u përgatitën dhe u vunë në dorë të studentëve 33 tekste mësimore, bazë dhe ndihmëse, u përgatitën e u mbrojtën 12 disertacione të shkallës së parë të kualifikimit, u shkruan mbi 110 artikuj shkencorë në revistat e buletinet, u mbajtën dhjetra referate e kumtesa në sesionet shkencore të vetë fakultetit dhe të institucioneve të tjera shkencore, vetë shqata e studentëve mbajti 7 sesione shkencore etj. Tërë ky aktivitet dha një ndihmë të çmuar në zhvillimin normal të procesit mësimor.

Gjatë kësaj periudhe doli më në pah aktivizimi i kuadrove dhe i pedagogëve të fakultetit në kryerjen e studimeve dhe në realizimin e

* Dekan i Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit të Tiranës.

temave të rëndësishme, siç janë: «Përpilimi i hartës gjeologjike të Shqipërisë në shkallën 1 : 200 000», «Studimi i mineralogjisë së xehorëve të kromit», zgjidhja e problemeve të gjeologjisë e të gjeokimisë së naftës, kërkimi i vendburimeve të kromit e të bakrit me metoda gjeofizike, eksperimentimi i metodave gjeofizike për studimin e cektinës detare, puna studimore për zgjedhjen e sistemeve më optimale të shfrytëzimit të vendburimeve të minraleve të dobishme të ngurta, puna kërkimore për zgjedhjen e problemeve që kanë të bëjnë me tre-tësirat argjilore me cilësi më të mirë gjatë shpimeve të thella, puna eksperimentuese për përcaktimin e parametrave të nxjerrjes së naftës e të gazit etj. Punonjësit e fakultetit, sipas rastit, janë përfshire në grupe pune e studimore për probleme thelbësore, duke dhënë ndihmën e tyre në zgjedhjen e problemeve kohore të ndërmarrjeve të ndryshme gjeologjike dhe minerare. Në rrugën për plotësimin e këtyre detyrave, punonjësit e fakultetit tonë kanë kryer e shkruar studime dhe disertacione, në të cilat janë trajtuar probleme të rëndësishme teorike e praktike, si studimi «Mbi punueshmérinë e qymyreve dhe mekanizimin e procesit të rrëzimit në minierat tona», studimi «Disaligjësi të filtrimit të naftave asfaltike dhe zbatime të tyre», studimi «Gradientët e fushës elektrike të polarizimit spontan», etj., të cilat janë vlerësuar si punime të një niveli të lartë shkencor. Janë trajtuar gjithashu probleme e detyra kohore e të perspektivës, si kompleksiteti i metodave në metoden e gjeokimisë së lëndës organike për zonën tektonike Jonike, shoqërimet minerale paragjenetike të xehorëve hidrotermalë damarorë, stratigrafia dhe fosilet e amoniteve në depozitim kufitare të jurasikut të sipërm — kretakut të poshtëm të zonës Jonike dhe të zonës së Mirditës, perspektiva e kërkimit të zhivës në të dy anët e thyerjes tektonike të Drinit etj. Veç këtyre, në këshillin shkencor të fakultetit janë diskutuar e miratuar edhe studime të rëndësishme të kryera nga specialistë të institucioneve e të ndërmarrjeve të tjera gjeologjike e minerare, si «Efektiviteti i metodës së polarizimit të provokuar për kërkimet komplekse të minraleve të bakrit», «Kushtet gjeologo-inxhinierike të luginës së lumi Drin për ndërtim hidroenergetike», «Kushtet e formimit të asbestit e të talkut, ligjësitë e përhapjes dhe perspektiva e kërkimit të tyre në vendin tonë» etj., të cilat kanë ndikuar në gjallërimin e jetës shkencore të katedrave të ndryshme.

Një hap i mirë është hedhur për zhvillimin e mëtejshëm të bazës kabinetore-laboratorike si dhe për plotësimin e fondit të kampionaturës bazë me minrale e shkëmbinj nga vendi ynë, nga vendet fqinje etj. dhe janë shtuar mjetet demonstrative. Po ashtu është rritur e zgjeruar baza mësimdhënëse me përdorimin e gjerë të filmit, të diapositivave etj.

Arritje të ndieshme janë shënuar në drejtim të realizimit më mirë të përgatitjes fiziko-ushtarake të studentëve si dhe në kryerjen më me efektivitet të praktikës mësimore në prodhim, të kryerjes së punës prodhuese dhe të periudhës për përgatitjen e diplomës, duke hedhur një hap tjetër në harmonizimin e tre komponentëve të mësimdhënës.

Pedagogët e fakultetit tonë kanë dhënë një ndihmë të madhe edhe në përgatitjen e inxhinierëve për minierat në Universitetin e Prishtinës.

nës dhe kanë shkëmbyer mendime me specialistët e këtij universiteti për probleme të ndryshme shkencore, gjatë vizitave e takimeve të organizuara në Kosovë ose në vendin tonë.

Një jehonë të gjëzueshme e mobilizuese ngjallën në punonjësit e fakultetit tonë, ashtu si në të gjitha masat punonjëse, punimet e Kongresit të 8-të historik të Partisë sonë të lavdishme, të cilat hapin horizonte të gjera edhe për shkollën tonë të re socialiste. Vendimet e mara në këtë Kongres si dhe mësimet dritëdhënës të shokut Enver Hoxha na vënë përballë detyrash të mëdha e të rëndësishme. Realizimi i tyre kërkon prej nesh një mobilizim edhe më revolucionar. Forcat e katedrave të fakultetit tonë lipset të përqëndrohen edhe më mirë e në mënyrë më të kualifikuar në drejtim të ngritisë së cilësisë së punës së shkollës, me qëllim që ajo të pajisë brezin e ri me dije të nivitet bashkëkohor.

Lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara për të ardhshmen, vëmendja e katedrave tona është përqëndruar në tri drejtime kryesore:

Së pari, për ngritisjen e cilësisë së përgatitjes së kuadrit të lartë, me qëllim që ai të përballojë tërështet dhe me cilësi të mirë detyrat që lidhen me studimin, projektimin dhe realizimin e kërkimeve gjeologjike, me studimet në fushën e industriës nxjerrëse të naftës e të gazit dhe të minraleve të tjera të dobishme, duke u mbështetur tërësisht në forcat tona, me qëllim që kuadrot tona të përballojnë me sukses jo vetëm detyrat e pesëvjeçarit të shtatë, por edhe ato të pesëvjeçarëve të ardhshëm. Po bëhen përpjekje që të formohen inxhinierë me përgatitje të përgjithshme më të thellë në shkencat bazë, si matematika, fizika, kimia si dhe në shkencat formuese të degëve të veçanta, si mineralogjia, petrografia, mekanika teorike, rezistenza materiale, kimia fizike e lëndëve koloidale, fizika e shtresës etj., të lidhura këto me kuptimet e nocionet formuese të lëndëve të profileve të ndryshme. Kjo do të bëjë të mundur që inxhinierët e ardhshëm të pajisen me një imaginatë shkencore më të përkryer dhe të përgatiten për të ndjekur e për të zbatuar në kushtet e vendit tonë realizimet më të fundit të shkencës e të teknikës më të përparuar, për t'iu përgjigjur më mirë detyrave e për të çuar përpara revolucionin tekniko-shkencor tanë dhe në të ardhshmen në fushat e naftës, të gjeologjisë dhe të minierave. Intensifikimi i kërkimeve gjeologjike në kushte më të koklavitura, për minrale të dobishme të njohura ose të reja, studimi, eksperimentimi dhe përdorimi në kompleks i metodave gjeologo-gjeokimiko-gjeofizike për kërkimin e naftës e të gazit si dhe të minraleve të tjera të ngurta nuk mund të kryhen me sukses pa një përgatitje të nevojshme në përshtatje me nivelin e detyrave që janë shtruar për zgjidhje. Po ashtu, përballimi i detyrave të mëdha në zgjidhjen e problemeve të hapjes, të përgatitjes, të zgjedhjes së sistemeve më optimale të shfrytëzimit dhe të zbatimit të një teknologji bashkëkohore në thallisëra më të mëdha nëntokësore dhe me kushte edhe më të koklavitura, studimi dhe projektimi i kapaciteteve prodhuese me rendimente më të larta dhe me një shkallë më të madhe mekanizimi e automatizimi, kërkojnë specialistë me një përgatitje më të mirë dhe me një kualifikim më të lartë.

Detyra më të mëdha e më me përgjegjësi vihen përpara nesh lidhur me përgalitjen e inxhinierëve të shpimit e të shfrytëzimit të vendburimeve të naftës e të gazit, që ndodhen shumë thellë nën tokë e

në presione mbinormale, në kontinent apo në cektinën detare. Këto kushte kërkojnë specialistë me përgatitje më të lartë e më të aftë për parandalimin e për kapercimin e avarive dhe të situatave të koklatura, që shpeshherë rrjedhin nga moskuptimi dhe mosbatimi në shkallén e duhur të disiplinës shkencore gjatë realizimit të detyrave. Pra ato kërkojnë një përgatitje të gjithanshme më të mirë, një formim më të mirë shkencor, ndërgjegje të lartë dhe këmbëngulje në plotësimin e detyrës së nderuar të gjeologut, të minatorit, ose të naftëtarit.

Duke pasur parasysh tërë këto detyra, katedrat e fakultetit tonë po studiojnë me kujdes planet dhe programet mësimore ekzistuese. Ndryshimet dhe përmirësimet e bëra gjatë viteve të fundit në dokumentacionet bazë të shkollës sonë, janë të pamjaftueshme. Në kuadrin e realizimit të detyrave për një përgatitje më të mirë të kuadrove të larta, po punohet për një ripunim më të përkryer të teksteve bazë dhe atyre ndihmëse, duke zgjedhur njojurive formuese dhe arrijet e fundit të shkencës e të teknikës, për të vënë në jetë porosinë e shokut Enver Hoxha në Kongresin e 8-të të PPSH se «Për t'i hapur vend informacionit të ri e të domosdoshëm shkencor, duhet bërë jo një shtim mekanik i vëllimit të njojurive, por ndryshime të aparatit konceptual dhe risistemime të këtij informacioni në struktura më kompakte dhe më universale, që e rritin mjaft peshën e tij specifike dhe e zgjerojnë në mënyrë të ndjeshme fushën e zbatimeve».

Për një përgatitje më të mirë të studentëve po studiojmë rrugët dhe format e reja, që duhen futur në procesin mësimor, me synim që atyre t'u jepet më shumë mundësi për një punë të pavarur jashtë auditorit, nën udhëheqjen dhe nën kontrollin e vazhdueshëm të katedrave përkatëse, nëpërmjet heqjes së ngarkesës së panevojshme në auditor, nëpërmjet përmirësimit vëllimor të përpjesëtimit teori-praktikë dhe nëpërmjet shfrytëzimit të orës së mësimit në auditor me një efektivitet më të lartë.

Përfshirja në mësimdhënie e kuadrove më të përgatitura të institucioneve e të ndërmarrjeve të tjera kërkimore-shkencore si dhe mobilizimi i tyre në përgatitjen e leksioneve e të ciklevës leksionesh për probleme të veçanta e në përgatitjen e informacioneve shkencore në katedër, sipas një programi të rregullt që nisi të zbatohet gjatë viti të kaluar, organizimi i shkëmbimit dhe i ballafaqimit të mendimeve e të pikëpamjeve në mbledhjet e këshillave shkencore për probleme të ndryshme sjellin një ndikim të veçantë, sepse ndihmojnë në përhapjen e njojurive të reja dhe të arritjeve të fundit të shkencës e të teknikës në mënyrë më të shpejtë në auditor, për rrjedhim, edhe në ngritjen cilësore të përgatitjes së inxhinierëve të ardhshëm.

Rritja e përgjegjësisë së katedrave tona për këto detyra bëhet edhe më e mprehtë për faktin sepse gjatë pesëvjeçarit të shtatë parashikohet të diplomohen 40 për qind më shumë kuadro se në pesëvjeçarin e kaluar.

Për të siguruar një përgatitje cilësore më të lartë, punonjësit e fakultetit po vënë në jetë porosinë e shokut Enver Hoxha se «Forcimi i gjithanshëm cilësor, ngritja e nivelit shkencor, e rendimentit dhe e efikasitetit të të gjithë procesit mësimor-edukativ kërkon të bëhen përpjekje më të mëdha për përmirësimin rrënjosor të metodave të mësimdhënieve, në mënyrë që të rritet përvetësimi aktiv i dijeve dhe qëndrue-

shmëria e tyre, të nxitet mendimi krijues dhe të edukohen shprehitë e punës së pavarur te nxënësit e studentët qysh në bankat e shkollës. Në këtë kuadër është e nevojshme të merren masa konkrete për të fuqizuar bazën materiale laboratorike të shkollës».

Së dyti, katedrat, nën dritën e arritjeve dhe të përvojës së deritanishme, duke kritikuar e mënjanuar edhe të metat e konstatuara, po punojnë për plotësimin e tematikës shkencore të të gjitha niveleve dhe po luftojnë për zgjerimin e mëtejshëm të saj, me pikësynim që ajo t'i shërbejë si studimit të problemeve të rëndësishme të ekonomisë së vendit tonë, ashtu edhe ngritjes së mëtejshme të nivelit e të punës mësimore-shkencore të katedrës, në mënyrë që të ndihmojë në formimin dhe aftësimin e mëtejshëm të kuadrit mësimor-shkencor. Në periudhën e tanishme, kur paraqiten probleme të shumta e të mprehta që duhet t'i nënshtrohen studimit e eksperimentimit, kur edhe katedrat tona po plotësohen më mirë me kuadro më të përgatitura, janë krijuar të gjitha mundësítë që të merremi më shumë e më efektivisht me studime shkencore që i nevojiten ekonomisë së vendit. Në këtë kuadër, kualifikimi i organizuar dhe i kontrolluar i kuadrove të katedrave tona është vënë në rrugë më të drejtë dhe, në përgjithësi, po ecet më mirë.

Nëpërmjet rrugës së shkallës së parë të kualifikimit është bërë e mundur që më shumë se 50 për qind e kuadrove të katedrave të kenë fituar grada ose tituj e grada shkencore. Në vitet e ardhshme do të mbrojnë disertacione punonjës të tjerë, kurse kuadrot që do të térhiqen nga fakulteti do t'i nënshtrohen kualifikimit me ritme më të shpejta.

Disertacionet e përgatitura gjatë viteve të fundit si dhe referatet e kumtesat e mbajtura nga specialistët tanë në sesionet shkencore dhe botimi i tyre në organet shkencore, flasin për një përparrim të ndihmojnë për pasurimin e literaturës shkencore në gjuhën shqipe. Megjithëkëtë, katedrat e fakultetit tonë kanë mundësi që të ndihmojnë më shumë nëpërmjet udhëheqjeve shkencore e konsultimeve të ndryshme, në mënyrë të tillë që edhe kuadrot e prodhimit të përgatisin e të mbrojnë studime me vlerë në kuadrin e kryerjes së shkallës së parë të kualifikimit.

Realizimi i detyrave në fushën e punës shkencore gjatë viteve të kaluara dhe plotësimi i detyrave të dhjetëmijorit të këtij viti tregojnë se katedrat e fakultetit tonë mund të kontribuojnë më shumë për zgjidhjen e problemeve kohore e të së ardhshmes në fushat e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit e të përpunimit të pasurive tona nëntokësore. Gjatë viteve 1981-1985 punonjësit e katedrave të fakultetit tonë kanë ndërmarrë të zgjidhin këto probleme: Pjesëmarria si bashkautorë në realizimin e studimeve përgjithësuese në fushën e gjeologjisë, siç janë ato të hartave gjeologjike, metalogenjike etj.; studimi i mineralogjisë së kromiteve; pjesëmarria në studimet komplekse gjeofizike, elektrometrike-magnetometrike etj.; studime në fushën e pasurimit të lëndës së parë minerale, në zgjedhjen e sistemeve më optimale të shfrytëzimit të qymyrgurit në minierën e Valiasit; eksperimentimi dhe zgjerimi i metodave të dyta të veprimit në shtresat naftë e gazmbartëse etj. Këto studime, si dhe temat e tjera, ndërmjet të cilave, hartimi i fjalarit enciklopedik shqiptar dhe i enciklopedisë shqiptare, që do të realizohen nën drejtimin e Akademisë së Shkencave, për-

fshijnë në punë të shtatë katedrat dhe kuadrot e tjera të fakultetit tonë. Thesojmë se pjesa më e madhe e këtyre temave e studimeve realizohen në bashkëpunim me institucionet e tjera, të cilat edhe i udhëheqin këto studime. Kështu, po bashkëpunohet më mirë me Institutin e Naftës në Fier, me Institutin e Studimeve dhe të Projekteve të Gjeologjisë dhe të Minierave në Tiranë, me Institutin e Teknologjisë së Mineraleve në Tiranë, me ndërmarrjet gjeologjike e minerare të vendit tonë, me Fakultetin e Inxhinierisë së UT dhe me Qëndrën Sizmologjike të Akademisë së Shkencave të RPSSH etj. Edhe në të ardhshmen, duke marrë parasysh faktin se numri i punonjësve të katedrave të fakultetit tonë është i vogël si dhe faktin që kuadrot e tyre janë specialistë të fushave të ndryshme, puna shkencore do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe ndërmarrjet e tjera, duke synuar gjithnjë që ajo t'i shërbejë ngritjes së nivelit të punës së katedrës, t'a bëjë pedagogun të aftë për t'i përcjellë auditorit njohuri të thella shkencore nëpërmjet leksioneve të pasura e me cilësi të lartë. Nga ana tjetër, rritja sasiore e cilësore e nivelit të pedagogut, ngritja dhe zhvillimi i mëtejshëm i bazës laboratorike, krijojnë premissa të favorshme jo vetëm për ecjen më përpara të punës shkencore, por edhe për ndërmarrjen e studimeve të thelluara e me afat të gjatë me karakter universitar, nën udhëheqjen e katedrës përkatëse.

Së treti, përgatitja e specialistëve për profile të reja dhe specializimi e kualifikimi i kuadrove, në përshtatje me kërkesat e ekonomisë popullore. Këtu përfshihen inxhinierë gjeofizikë dhe inxhinierë për matje nëntokësore. Kjo gjë do të sigurohet nëpërmjet rihapjes së degës së gjeofizikës dhe përgatitja e inxhinierëve të matjeve nëntokësore, duke profiluar studentët nga viti i tretë i degës së minierave; në përputhje me detyrat për të fuqizuar studimet lidhur me pasurimin dhe me përpunimin e lëndës së parë minerale si dhe për të siguruar ritme më të shpejta në këto fusha, duke filluar nga viti i kaluar akademik, pranë fakultetit nisi punën dega e re e pasurimit. Përgatitja e inxhinierëve për pasurimin e mineraleve të dobishme do të bëjë të mundur që ata të studiojnë në mënyrë më efektive rrugët e pasurimit e të përpunimit të mineraleve, sidomos të atyre të varfëra, gjë që do të rrissë edhe më shumë vlerën ekonomike të pasurive tona nëntokësore dhe do të ndihmojë në fuqizimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë socialiste.

Krahas me degët e mësipérme, kanë nisur punën kurse të rregullta një e dyvjeçare për të përgatitur specialistë mineralogë, petrografë, paleontologë e hidrogjeologë, të cilët do të jepin kontributin e vet në kryerjen e studimeve të plota në këto fusha, çka do të rrissë edhe më shumë nivelin e studimeve gjeologjike, në tërësi, dhe do të ndihmojë realizimin e studimeve e të përgjithësimeve më të bazuara shkencërisht, gjë që lidhet me intensifikimin e kërkimeve gjeologjike, me gjurmimin dhe gjetjen e mineralizimeve të reja dhe me futjen e tyre në shërbim të fuqizimit të ekonomisë popullore dhe të mbrojtjes së Atdheut tonë socialist.

Në stadin e tanishëm të zhvillimit shumë të shpejtë të industrisë minerare, ashtu siç u theksua në Plenumin e 10-të të KQ të PPSH, kërkohet që kuadrot e prodhimit të rrisin më tej aftësitë e veta, me

qëllim që të janë më të përgatitur për të zgjidhur detyrat e ditës e të perspektivës.

Në të kaluarën janë bërë përpjekje për organizimin e seminareve ose të formave të tjera disaditore kualifikimi. Përvoja e këtyre formave si dhe pjesëmarrja sa më masive dhe e diferencuar nxjerrin në pah nevojën që kjo detyrë të organizohet e të ndiqet më mirë në të ardhmen. Drejtimi i këtyre kurseve dhe formave organizative u është besuar instituteve tona kërkimore në Fier dhe në Tiranë. Gjatë vitit të kaluar dhanë kontributin e tyre modest edhe pedagogët e fakultetit tonë. Ata do ta zgjerojnë e do ta thellojnë më tej këtë ndihmë.

Rruja e ndjekur gjatë viteve të fundit për aktivizimin e studentëve nga ana e katedrave përkatëse në zgjidhjen e tematikës shkencore, duke nxitur tek të rintjtë dëshirën dhe vullnetin për t'u thelluar në punën shkencore, zbuloi një fushë të gjërë dhe një forcë të gjallë, që duhet organizuar e drejtuar më mirë në të ardhshmen. Përvoja e mirë e disa pedagogëve ka dalë në pah në këshillin shkencor të fakultetit. Nën shembullin e tyre po ecin edhe pedagogë të tjera, me pikësynim që kjo punë të masivizohet më tej, duke pasur parasysh se çdo specialist i sektorëve të gjeologjisë, të naftës dhe të industrisë minerare është jo vetëm një inxhinier i zakonshëm por edhe kërkues ndaj vetes, me iniciativë, me kurajë e vetveprues në çdo situatë, veti që kultivohen e zhvillohen gjatë jetës studenteske.

* * *

Sukseset dhe arritjet e deritanishme janë një nxitje për të quardhë më përpara punën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave. Ato na ndihmojnë për të vënë në jetë detyrat shumë të rendësishme të Kongresit të 8-të të Partisë dhe mësimet e udhëheqësit tonë të lavdishëm shokut Enver Hoxha për përgatitjen e specialistëve me atë nivel që kërkon koha e sotme e zhvillimit të vrullshëm të ekonomisë sonë popullore. Punonjësit e fakultetit, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, do të shkrijnë të gjitha aftësitë e tyre fizike e mendore për të arritur suksese edhe më të mëdha, për të ngritur edhe më lart nivelin dhe përbajtjen e punës mësimore-shkencore, për të përgatitur, kualifikuar e specializuar kuadro më të brumosura ideologjikisht e teknikisht, të devotshëm për të luftuar gjithnjë e më mirë krah për krah me naftëtarët e minatorët tanë heroikë, në ballë të luftës për forcimin e ekonomisë popullore dhe për fuqizimin e mbrojtjes së Atdheut tonë socialist.

Stratografi-Paleontologji

HEMIGORDIUS RENZI (REICHEL) NË DEPOZITIMET E PERMIANIT TË SIPËRM TË RAJONIT TË GJURAJT NË ZONËN E ALPEVE SHQIPTARE

— Agim Pirdeni* —

Përshkruhet pjesa e sipërme e depozitimeve permiane dhe jepet përshkrimi monografik i species *Hemigordius renzi* (Reichel) të takuar në to.

Depozitimet e permianit të sipërm vërehen mjaft mirë në Gjuraj. Këtu grupi i studimit të stratigrafisë për zonën e Alpeve Shqiptare ka kryer prerje të imta stratigrafike. Duke shfrytëzuar shlifet ekzistuese dhe duke përgatitur një numër të bollshëm shlifesh nga kampionet që ndodhen në rruajtje pranë Institutit të Studimeve dhe të Projekteve të Gjeologjisë dlhe të Minierave, u morëm me studimin e mikrofaunës, sidomos të asaj permiane e triasike. Takuam një mikrofaunë të bollshme, duke përfshirë mjaft gjini e specie, të cilat në vendin tonë cithen për herë të parë, duke përfshirë edhe *Hemigordius renzi* (Reichel), së cilës i kushtohet një studim më i hollësishëm.

Duke pasur si objekt studimi vetëm stratigrafinë e depozitimeve mesozoike të zonës së Alpeve Shqiptare, grupi ka pasë kapur vetëm pjesën e sipërme të depozitimeve paleozoike, që takohen në Gjuraj. Pikërisht në këto depozitime, që përbëhen kryesisht nga gëlqerorë biointrasparuditikë e biointrasparitikë, ngjyrë hiri, shtresë e trashë (fig. 1), u gjend një mikrofaunë e bollshme e permianit të sipërm, e cila përfaqësohet nga fuzulinide e foraminifere të tjera si dhe nga alge *Dasycladaceae*. Në shlifet e përgatitura u përcaktuan: *Neoschwagerina craticulifera* Schager, *Verbeekina cf. verbeeki* (Geintz), *Sumatrina cf. annae* (Volz), *Misellina ovalis* (Depret), *Cancellina primigena* (Hayden), *Afghanella* sp., *Codonofusiella* sp., *Rugos Schwagerina* sp., *Schubertella* sp., *Stafella*

* Instituti i Studimeve dhe i Projekteve të Gjeologjisë dhe të Minierave në Tiranë.

sp., *Kahlerina sp.*, *Hemigordius renzi* (Reichel), *Geinitzina cf. postcarbonica* (Spandel), *Globivalvulina bulloides* (Brady), *Climacammina sp.*, *Pachyphloia cf. ovata* Lange, *Agathammina pusilla* (Geinitz), *Tetrataxis sp.*, *Hemigordius sp.*, *Glomospira sp.*, *Endothyra sp.*, *Nodosinella sp.*, *Ammodiscus sp.*, *Archaeodiscus sp.*, *Tuberitina callosa* Reitlinger, *Mizzia velebitana* Schubert, *Colaniella sp.* etj.

Mikrofauna e permianit të sipërm u takua gjithashtu me bollëk e ridepozituar edhe në depozitimet e triasikut të poshtëm e sidomos të atij të mesëm, në tri pakot konglomeratike që shtrihen, njëra, në bazën e depozitimeve të triasikut të poshtëm, tjetra, pak më lart, kurse e treta, në bazën e depozitimeve të anizianit. Këto horizonte konglomeratike ndërtohen nga zaje fare pak të rrumbullakosura, që përfaqësohen kryesisht nga copa karbonatesh, ranorësh, rreshpesh, silicorësh.

Në kufirin midis permianit të sipërm dhe triasikut të poshtëm mund të kemi edhe ndonjë pushim, megjithëse nuk vërehet mospajtim këndor.

Hemigordius renzi (Reichel) është formë karakteristike vetëm për depozitimet e permianit të sipërm; është një formë me rëndësi për nga pikëpamja biostratigrafike. Megjithatë themi se në të ardhmen i duhet kushtuar një vëmendje më e madhe studimit më të imtësuar të depozitimeve paleozoikore, si lidhur me nxjerrjen në pah të pjesëve më të vjetra të paleozoikut, ashtu edhe lidhur me kufirin e permo-triasik. Studimi i hollësishëm i mikrofaunës së bollshme, që takohet në këto depozitime, do të bëjë të mundur deshifrimin më të saktë të tyre.

PJESA SISTEMATIKE

Familja *Hemigordiopsidae* Nikitina 1969.

Gjinia *Hemigordius* Schubert 1908.

HEMIGORDIUS

RENZI (Reichel)

(Fotopasqyra I, mikrofotot 1-12).

1945 *Hemigordiopsis renzi*-Reichel, fig. 1-2 në tekst.

1971 *Hemigordiopsis renzi*-Glement, Guernet, Lys, tab. 2, fig. 4.

1978 *Hemigordius renzi*-Bonnemann, Whittaker, Zaninetti, tab. 10, fig. 1-4; tab. 11, fig. 4-7; tab. 12, fig. 6, 13.

Përshkrimi: Ekzemplarët e takuar nga ne janë në trajtë të rrumbullakosur, paksë të tërhequr. Guacka përbëhet nga një dhomëzë fillestare e rrumbullakosur, që takohet nga një dhomë dytësore e pandarë në septe. Pjesa e hershme (që pason menjëherë pas dhomëzës fillestare) është e pështjelluar në mënyrë të çrrëgullt (streptospirale). Më pas vazhdon një pjesë spirale e sheshtë (planispirale). Guacka është involute. Dallohen 5-6 rrotullime spirale të sheshta. Muri është mjafte i trashë. Kavitetet dhomëzore janë mjaft të redaktuara.

Përmasat: Diametri më i madh luhatet nga 1,6 deri në 2,1 mm; diametri më i vogël luhatet nga 1,4 deri në 1,6 mm; trashësia e murit është 0,08-0,18 mm, kurse lartësia e dhomëzave është 0,02-0,035 mm.





Fig. 1: PRERJE E DEPOZITIMEVE PERMO-TRIASIKE.

1—Rreshpe argillo-silicore me pamje filitike, me zaje dhe popla gëlqerorësh; 2—gëlqerorë biointrasparuditikë, shtresëtrashë; 3—ndërthurje të gëlqerorëve biointrasparuditikë, me gëlqerorë biointrasparikitë; 4—gëlqerorë konglomeratikë, shtresëtrashë, ngjyrë hiri; 5—ndërthurje të gëlqerorëve biointrasparuditikë, plakorë, ngjyrë hiri, me rreshpe karbonatikë.

A, B, C — *Hemigordius renzi* (Reichel). Në zajet takohen fosile mikrofaunistike të permianit të sipërm; D — në zajet takohen fosile të *Hemigordius renzi* (Reichel) etj.

Fotopasqyra I, mikrofotot 1-12



1


2

3

F o t o p a s q y r a I

Mikrofoto 1, Shlifi Nr. 44/4, zmadhuar 16 herë

| | | | | | | |
|----|----|----|------|----|----|----|
| >> | 2 | >> | 9/3 | >> | 17 | >> |
| >> | 3 | >> | 9/2 | >> | 14 | >> |
| >> | 4 | >> | 44/2 | >> | 16 | >> |
| >> | 5 | >> | 44/4 | >> | 14 | >> |
| >> | 6 | >> | 44/3 | >> | 17 | >> |
| >> | 7 | >> | 11/1 | >> | 14 | >> |
| >> | 8 | >> | 9/7 | >> | 16 | >> |
| >> | 9 | >> | 9/6 | >> | 11 | >> |
| >> | 10 | >> | 44/2 | >> | 21 | >> |
| >> | 11 | >> | 45/2 | >> | 17 | >> |
| >> | 12 | >> | 11/2 | >> | 14 | >> |



7

8

9



10

11

12

Krahasimi: Ekzemplarët e takuar nga ne, si për nga forma, përmasat, mënyra e vendosjes së dhomëzave, lartësia, ashtu edhe për nga trashësia, pra për nga të gjitha karakteristikat, flasin për specien *Hemigordius renzi* (Reichel). Edhe në format e deformuara ose fragmentare dallohen karakteristikat kryesore vetjake të kësaj specieje.

Përhapja stratigrafike e gjeografike: Holotipi i *Hemigordius renzi* (Reichel) vjen nga depozitimet e permianit të sipërm të ishullit të Qipros. Është takuar edhe në depozitimet e permianit të sipërm të Malit të Zi (Jugosllavi), të Atikës (Greqi), të Turqisë, Birmanisë, Tailandës etj.

Materiali ruhet pranë Kabinetit të Paleontologjisë të ISPGJM, në shlifet 6/1, 9/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 11/1, 2, 44/2, 3, 4, 45/2.

LITERATURA

- 1 — Bronnimann P., Whittaker J. E., Zanimetti L. — Shanita, a new pillored miliolacean Foraminifer from the Late Permian of Burma and Thailand. Riv. It. Paleont. Strat., vol. 84, Nr. 1, Milano, 1978.
- 2 — Clément B., Guernet C., Lys M. — Données nouvelles sur le Carbonifère et le Permien du mont Beletsi en Attique (Grèce). Bull. soc. géol. de France (7) XII, n. 1. Paris, 1971.
- 3 — Peza L. H. Xhomo A., Theodhori P., Jahja B., Gjoshi Sh. — Stratigrafia e depozitimeve mesozoike të zonës së Alpeve Shqiptare. Tirana, 1973.
- 4 — Reichel M. — Sur un miliolide nouveau du Permien de l'île de Chypre. Verhandl. Natur-forch. Gesell., v. 56, pt. 2, Basel, 1945.
- 5 — Theodhori P., Pirdeni A. — Mikrofaciet e zonës së Alpeve Shqiptare (nga permiani i sipërm deri në eocen). Tirana, 1978.

Dorëzuar në redaksi
në prill 1981.

Résumé

Hemigordius renzi (Reichel) dans les dépôts du Permien supérieur de la région de Gjuraj dans la zone des Alpes Albanaises

On a rencontré *Hemigordius renzi* (Reichel), redéposé même dans les dépôts du Trias inférieur et supérieur et précisément dans les horizons congolératiques de galets mal arrondis et comportant principalement des morceaux de carbonate, de grès, de schistes et de silice.

Plus en bas, on trouvera la description monographique de l'*Hemigordius renzi* (Reichel) qui abonde dans ces dépôts en association avec les foraminifères susindiquées.

Fig. 1: Coupe des dépôts permotriasiques:

- 1 — Schistes argilo-siliceux à l'aspect philitique, avec des galets et des morceaux de calcaires; 2 — calcaires biointrasparuditiques, à couches épaisses; 3 — Alternances de calcaires biointrasparuditiques et de calcaires biointrasparitiques; 4 — calcaires congolératiques à couches épaisses, de coloration grise; 5 — alternances de calcaires biointrasparuditiques en plaquettes, de coloration grise, et de schistes carbonatiques.

A,B,C — *Hemigordius renzi* (Reichel): Dans les galets on a rencontré des

fossiles microfaunistiques du Permien supérieur; D — dans les galets on a rencontré des fossiles de l'*Hemigordius renzi* (Reichel), etc.

Le tableau photographique:

| Microphoto 1, Schlief N° 44/4, | | | agrandissement 16 fois |
|--------------------------------|-----|---|------------------------|
| » | 2, | » | 9/3, |
| » | 3, | » | 9/2, |
| » | 4, | » | 44/2, |
| » | 5, | » | 44/4, |
| » | 6, | » | 44/3, |
| » | 7, | » | 11/1, |
| » | 8, | » | 9/7, |
| » | 9, | » | 9/6, |
| » | 10, | » | 44/2, |
| » | 11, | » | 45/2, |
| » | 12, | » | 11/2, |

Gjeologji inxhinierike

TUNELI I QAFËTHANËS DHE VECORITË GJEOLOGJKO-INXHINIERIKE TË TIJ

— Vedat Shehu*, Nail Demi*, Nikolla Konomi** —

Në artikull trajtohen kushtet gjeologo-inxhinierike të tunelit të Qafëthanës të hapur në pjesën lindore të zonës së Mirditës, të cilat ndihmuin në përcaktimin e metodës më të përshtatshme të avancimit, formës dhe veshjes së tunelit, mënyrës pér largimin e ujërave nëntokësorë etj.

H Y R J E

Si pér çdo degë të ekonomisë sonë socialiste, Partia jonë e lavdëshme e Punës me shokun Enver Hoxha, në krye, ka treguar kujdes të veçantë edhe pér zhvillimin me ritme të shpejta të transportit hekurudhor, i cili para Çlirimt as që njihej fare. Kështu, pér të plotësuar kërkzesat gjithnjë në rritje pér transportin hekurudhor, u kalua nga ndërtimi i hekurudhave në terrene fushore, në ndërtimin e hekurudhave në terrene malore, të cilat përshkojnë edhe ura më të larta se 50 m, tunele dhe vepra të tjera të artit me kushte shumë të vështira gjeologo-inxhinierike. Një nga këto vepra qe edhe hekurudha Prrenjas — Guri i Kuq, e cila kalon nëpër tunelin e Qafëthanës, tuneli më i gjatë hekurudhor në vendin tonë.

Dihet se edhe pér tunelet kryhen studime gjeologo-inxhinierike sipas detyrës së përcaktuar nga etapa e projektimit, pér të vënë në shërbim të projektuesit dhe të zbatuesit të materialin e nevojshëm studimor në lidhje me ndërtimin gjeologo-strukturor të rajonit, që do të përshkojë tuneli, karakteristikat fiziko-mekanike të shkëmbinjve dhe presionet minerare, që mund të shfagjen gjatë hapjes së tunelit. Zgjidhja e këtyre problemeve çon në zgjedhjen e metodës më të përshtatshme të parashpënies, të trajtës dhe të veshjes së tunelit, në përcaktimin e mjeteve pér largimin e ujratë nëntokësorë etj. Këtij qëllimi

* Ndërmarrja Gjeologjiko-Gjeodezike e Ministrisë së Ndërtimit në Tiranë.

** Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave i Universitetit të Tiranës.

i shërbeu edhe studimi i kryer prej nesh, që sintetizohet në këtë artikull.

1 – Natyra gjeologjike e sektorit të Qafëthanës

Sektori i Qafëthanës, i cili ndodhet midis fushës së Domosdovës dhe ligenit të Ohrit, zë vend në vargun e ujëndarësit të pellgjeve ujëmbledhëse të Shkumbinit dhe të Drinit të Zi. Ai hyn në pjesën më lindore të zonës tektonike të Mirditës, për të cilën janë karakteristikë shkëmbinjtë ofiolitikë, që ndeshen pranë takimit me zonën tektonike të Korabit. Kjo vendosje strukturore ka kushtëzuar edhe nënshtrimin e sektorit ndaj forcave deformuese, të cilat kanë çuar në një copëtim tektonik të theksuar të shkëmbinjve.

Mbizotëron stili tektonik luspor i shoqëruar me shkëputje dhe hedhje. Ky stil ka ndikuar në vendosjen strukturore bllokore të shkëmbinjve ultrabazikë, të gëlqerorëve dhe të kompleksit efuzivo-sedimentar, që takohen në këtë sektor. Ndeshen bloqe brenda njëri-tjetrit. Rrafshet e thyerjeve mbizhvendosëse bien si në perëndim, ashtu dhe në lindje, gjë që tregon se lëvizjet tektonike kanë ndodhur në kohë të ndryshme. Drejtimi i shtrirjes së rrafsheve tektonike kryesore është nga veriu në jug. Ato ndërpriten edhe nga thyerje têrthore (shih fig. 1).




Fig. 1: Hartë gjeologo-inxhinierike skematiqe e sektorit të tunelit të Qafëthanës.

- 1 – Peridotite të serpentinizuara dhe të prishura; 2 – pako efuzivo-sedimentare; 3 – gëlqerorë; 4 – thyerje e zona tektonike.

Tuneli i Qafëthanës u trasua me drejtim nga linja në perëndim, têrthorazi me shtrirjen e strukturave të mëdha. Kështu u zgjodh varianci më i shkurtër, meqenëse me rritjen e gjatësisë së tunelit në variante e tjera, nuk zvogëlohej gjatësia e intervaleve me shkëmbinj të dobët. Në bazë të njohjes së tektonikës bllokore, u llogaritet intervalt e mundshme të shkëmbinjve me veti fiziko-mekanike të ndryshme, që do të përskonte tuneli për variante të ndryshme të trasimit të tij. Si shkëmbinj me më pak probleme gjeologo-inxhinierike u konsideruan gëlqerorët. Kështu, si më i mirë u zgjodh varianti që do të takonte sa më shumë gëlqerorë dhe sa më pak intervalle me shkëmbinj të dobët (periodotite të serpentinizuara ose serpentinite të brekçëzuara e të milonitzuara). Duke u nisur nga këto kushte dhe nga qëllimi që tuneli të ishte sa më i shkurtër, doli më i përshtatshëm varianti që tashmë është zbatuar.

Njohja e stilit tektonik të sektorit të Qafëthanës pati rëndësi edhe për përcaktimin e zonave me rrjedhje dhe shpërthime ujore. Të tilla ishin kontaktet e shkëmbinjve ultrabazikë me gëlqerorët, shkëmbinjtë gëlqerorë me sipërfaqe në trajtë hinkash karstike dhe vendet ku tuneli do të kishte në tavan shkëmbinj gëlqerorë të karstëzuar. Kontaktet e shkëmbinjve ultrabazikë me gëlqerorët u përcaktuan si zonat më të dobësuara për shkak të thërmimit të theksuar nga thyerjet tektonike.

Shkëmbinjtë e sektorit të Qafëthanës, nga poshtë-lart, kanë këtë vendosje: 1 – Seria strallore efuzivo-tufitike, që paraqitet në mënyrë fragmentare; 2 – gëlqerorë shtresash; 3 – gëlqerorë masivë të triasikut të sipërm. Kjo stivë shtresash është në marrëdhënie tektonike me ofiolitet e zonës së Mirditës, që përfaqësohen nga shkëmbinjtë ultrabazikë, gabrot dhe diabazet.

Në prerje nuk u kap horizonti i kuqërrimitë, për efekt të lëvizjeve tektonike të fugishme. Po ashtu, nuk u verifikua zhvillimi i prerjes më lart se depozitimet e triasikut të sipërm si dhe depozitimet kretake transgresive, që ndeshen në një rajon më të gjerë.

2 – Disa karakteristika gjeologo-teknike të tunelit të Qafëthanës

Tuneli ka një gjatësi të përgjithshme prej 3015 m dhe një sipërfaqe në drithë prej 35 m^2 , brenda prerjes së vetë qemerore. Lartësia e masës shkëmbore mbi tunel, nën kreshtën e ujëndarëses, arrin deri në 275 m.

Duke marrë parasysh ndërtimin gjeologjik të koklavitur, vendosjen gjeologjike anash zonës së Mirditës dhe pranë përplasjes së saj me zonën e Korabit, në përpilimin e prerjes gjeologo-inxhinierike të tunelit u përdorën metoda komplekse, si hartografimi gjeologjik i brezit gjatë gjurmës përvijuese të tunelit në shkallën 1 : 5 000 për një gjerësi rreth 500 m; metodat gjeofiziko-magnetometrike dhe elektrike në ndihmë të njëra-tjetrës; vrojtimet hidrogeologjike; shpimet pararendëse horizontale në ballin e tunelit në një largësi deri në 70-80 m. Meqenëse masa shkëmbore mbi nivelin e tunelit ishte mjaft e trashë (deri në 275 m) dhe ndërtimi gjeologjik tepër i koklavitur, zbulimi gjeologo-inxhinierik me shpime nga sipërfaqja u paraqit i vështirë dhe u quajt joefektiv, duke marrë parasysh stilin tektonik dhe nevojën për të filluar sa më parë ndërtimin. Për këto arsy, u përpilua fillimi, me anën e vrojtimeve sipërfaqësore, prerja gjeologo-inxhinierike 2a (fg. 2), që u bë bazë për projektimin e tunelit. Pas hapjes së tunelit, në disa pjesë të tij nuk u verifikuan vendosja e shkëmbinjve si dhe vlerësimi i tyre gjeologo-inxhinierik. Në anën e hyrjes (ana e Prrenjasit), zona serpentinite e brekçëzuar dhe e milonitzuar paraqitej më e zgjeruar dhe në tunel u shfaqën presione të mëdha malore. Po ashtu, prerja nuk u verifikua edhe nga ana e daljes. Kështu, për të verifikuar prurjen e ujut nga tavani i tunelit, lindi nevoja e vrojtimeve plotësuese gjeologjike të shoqëruara me punime gjeofizike.

Relievimi gjeologjik u shoqërua me metodat gjeofizike elektrike dhe magnetometrike (kryesisht për zonat e kontakteve të shkëmbinjve ultrabazikë me gëlqerorët për të përcaktuar orientimin e rrafshit tektonik përkufizues midis tyre për disa metra nën sipërfaqe. Si metoda elektrike u përdorën sondimet me potencial të provokuar, që bazohej në polarizimin e ndjeshëm dhe në rezistencën elektrike të duk-




Fig. 2: Prerje gjeologo-inxhinierike të tunelit të Qafethanës.

a – Për fazën e projektit teknik; b – pas zbulimeve gjeofizike; c – pas përfundimit të punimeve.
 1 – Gëlqerorë masivë të triasikut të sipërm; 2 – rreshpe gëlqerorë – shkëmbinj efuzivë; 3 – peridotite dhe serpentinite të shkatërruara; 4 – zonë tektonike; 5 – prishje tektonike shkëputëse; 6 – rrjetje të përqëndruara të ujrave nëntokësore;

shme mjaft të ndryshme ndërmjet gëlqerorëve dhe shkëmbinjve ultrabazikë (ajo e shkëmbinjve ultrabazikë lëkundëj nga 200-3500 mm, ndërsa ajo e gëlqerorëve ishte 500-6000 mm). Nga kjo duket se rezistencat elektrike të këtyre shkëmbinjve interferohen njëra me tjetrën. Për këtë arsy, u hasën vështirësi për pjesët e thella nën sipërfaqe, në të cilat rezistanca e dukshme e gëlqerorëve me çarje e me ujra nëntokësore afrohej ose bëhej e njëjtë me atë të shkëmbinjve ultrabazikë. Në bazë të të dhënavë të relievimit gjeologjik, të interpretimet gjeofizike dhe të shpimeve horizontale të kryera në ballin e tunelit, u ndërtua prerja 2b (fig. 2). Megjithatë, parashpënia e tunelit, në ecurinë 800 m nga hyrja (fig. 2c), ndeshi në gëlqerorë me çarshmëri të zhvilluar dhe me rrafshin e ujrave nëntokësore. Këta shkëmbinj, në bazë të punimeve gjeofizike, ishin interpretuar si shkëmbinj ultrabazikë të shkatërruar me rezistencë të dukshme të njëjtë. Kështu ndodhi edhe për disa pika të tjera, në të cilat gëlqerorët u konsideruan si mbulesa të holla dhe me vazhdueshmëri në thellësi. Prerja gjeologjike faktike e tunelit tregon se sektori i Qafethanës është koklavitur shumë në saje të një veprimtarie fazore të tektonikës bllokore dhe të asaj mbulesore. Mendimi i shprehur se blloqet gëlqerore, blloqet e shkëmbinjve ultrabazikë dhe fragmentet e gabrove e të shkëmbinjve efuzivë janë olishtlite brenda një flishi të hershëm, nuk na duket me vend. Duke u nisur nga përmasat dhe kompaktësia e blloqeve gëlqerore, është më e drejtë që këto blloqe t'i pranojmë si të një melanzhi tektonik ultrabazik.

3 – Problemet gjeologo-inxhinierike të tunelit të Qafethanës

Ndërtimi gjeologjik i sektorit të Qafethanës ka kushtëzuar edhe vetë problemet gjeologo-inxhinierike. Tektonika e fuqishme ka ndikuar për keq në vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve, kryesisht të atyre ultrabazikë, që janë shndërruar në serpentinite me veti plastike shumë më të mëdha se të gëlqerorëve. Po ashtu, ka ndikuar në ndryshimin e presioneve minerare fillestare të lindura qysh nga koha e formimit të këtyre shkëmbinjve. Kështu, si probleme kryesore gjeologo-inxhinierike dilnin deshifrimi i ndërtimit gjeologo-strukturor i sektorit të gjurmës së tunelit dhe i veticë gjeoteknikë të tij, si dhe përcaktimi i kushteve hidrogeologjike dhe i presioneve minerare.

Për një deshifrim sa më të saktë të ndërtimit gjeologo-strukturor të gjurmës së tunelit, në mënyrë që të përcaktoheshin drejtë trajta, veshja dhe metodika e parashpënieve së tunelit, u përdorën shpimet horizontale me thellësi 70-80 m në ballin e tunelit dhe paralelisht bëhej studimi gjeoteknik i llojeve shkëmbore.

Siq u përmend më lart, gjatë relievimeve komplekse gjeologo-gjeofizike u takuan kryesisht gëlqerorë të triasikut të sipërm dhe shkëmbinj ultrabazikë (më poshtë pëershruhen disa veti gjeoteknikë kryesore të tyre).

Gëlqerorët janë shkëmbinj me veti të mira fiziko-mekanike. Ata, në përgjithësi, paraqiten masivë ose shtresorë (në anën e daljes së tunelit) dhe mjaftë të epshëm kundrejt hapjes së tunelit, me përjashtim të zonave tektonike. Nga matjet e kryera në laborator vihet re se rezistenca në shtypjen njëboshtore lëkundet në kufij të gjerë (në varësi të gjendjes fizike të tyre, $600-1200 \text{ kg/cm}^2$). Koeficienti i fortësisë luhatet nga 4, për zonat e dobta, në 9, për ato të forta dhe masive. Gëlqerorët gjithëmonë janë shoqëruar me ujra çarjesh dhe karstile, të cilat kanë qenë më të shpeshta pranë kontaktave të tyre tektonike me shkëmbinjtë ultrabazikë. Duke u nisur nga gjendja fizike dhe nga vetitë e mira fiziko-mekanike të tyre, në përgjithësi, tunelit nuk iu bë ndonjë veshje konstruktive, me përjashtim të vendave, ku mund të ndodhnin shëmbje të tavanit të orientuara sipas rrafsheve tektonike, brenda vetë gëlqerorëve dhe në kontaktet e tyre me shkëmbinjtë ultrabazikë.

Shkëmbinjtë ultrabazikë, siq u theksua edhe më lart, përfaqësohen nga harzburgite dhe serpentinitë.

Harzburgitet takohen në trajtë blloqesh me përmasa të ndryshme dhe pykash tektonike me zona të gjera, thërmimi ndërmjet prishjeve tektonike. Në përgjithësi, janë shoqëruar me ujra çarjesh në sasira të vogla, të cilat kanë ndikuar keq në qëndrueshmërinë e tyre. Shpeshherë përgjatë çarjeve, të ushqyera edhe nga ujrat nëntokësore, krioheshin shëmbje me përmasa të mëdha, që bëhen pengesë për parashpënien e tunelit. Të tilla shëmbje ndodhën sidomos në ecurinë 1700-2500 m nga hyrja e tunelit. Prandaj në këtë interval tuneli u pajis me veshjen konstruktive.

Serpentinitet përfshinin pjesën më të madhe të shkëmbinjve ultrabazikë, që u takuan nga tuneli. Ato përbënin melanzhin tektonik ndërmjet blloqeve kompakte. Copat e milonitzuara vende-vende paraqiteshin disi të cimentuara dhe jepnin pamjen e brekçeve me cimento

argjilore. Copat peridotitesh dhe serpentinitesh ishin zhytur në masën milarite. Në këtë masë mungonin copat gëlqerore. Copat e peridotiteve të serpentinituara kishin përmasa të ndryshme, me diametër nga disa milimetra deri në biloqe të mëdha 3-4 m, me peshë vëllimore 2 T/m^3 , me lagështi në gjendje natyrore 5-10% dhe me porozitet 30-40%. Në përgjithësi, paraqiteshin me pak lagështi dhe në disa vendë ishin të thata. Kjo masë hynte në kontakt me mjedisin atmosferik e i nënshtrohej një përajrimi të shpejtë. Thithja e lagështirës ishte më shumë karakteristike për ecurinë 500-700 m nga hyrja e tunelit. Duke u mbështetur në të dhënë hidrogeologjike, u vërtetua se ujrat nëntokësore lokalizoheshin kryesisht në biloqet e gëlqerorëve me të çara dhe shumë të karstëzuara, aty ku vende-vende formoheshin edhe gropë karstike. Prishjet tektonike shkëputëse janë rrugë të lidhjes së biloqeve gëlqerore sipërfaqësore me ato të thellësisë për furnizimin me ujë. Kjo vihet re edhe në vendet e daljes së ujit në tunel, ku uji përqëndrohet kryesisht në kontaktet e biloqeve gëlqerore me serpentinitet osë brenda vetë gëlqerorëve. Megjithatë, kjo sasi e ujit është pak a shumë e vogël dhe nuk paraqet asnjë vështirësi për parashpënien e tunelit.

Anomalitë e presioneve minerare kanë qenë një nga problemet kryesore gjeologo-inxhinierike, që u ndeshën në tunelin e Qafëthanës. Shkëmbinjtë e ndryshëm, në kushte natyrore të shtrirjes, siç dihet, ndodhen nën ndikimin e peshës së vet, të lëvizjeve tektonike, të gradientit të temperaturës dhe të proceseve gjeokimike, domethënë ndodhen në gjendje të sforuar. Sforcimet e brendshme lindin qysh nga koha e formimit të shkëmbit dhe ruhen për një kohë të gjatë në qoftë se nuk veprojnë forca të tjera, siç janë lëvizjet tektonike. Sforcimet normale të brendshme, për një thellësi të caktuar nga sipërfaqja e tokës, janë $\sigma = \gamma H$ (ku: γ – pesha vëllimore e tokës dhe H – thellësia e shkëmbit nga sipërfaqja e tokës); ndërsa sforcimet horizontale, për një presion mesatar 0,25, janë sa 0,33 e sforcimeve vertikale ose normale. Mirëpo praktika e hapjes së punimeve nëntokësore ka vërtetuar se një ligjshmëri e tillë nuk ekziston kudo, sidomos pranë prishjeve tektonike e në zonat e erozionit të thellë humor, aty ku shkëmbinjtë relaksojnë etj. Kështu, si rezultat i këtyre dukurive, të cilat kanë shoqëruar zhvillimin e shkëmbit gjatë gjithë historisë së zhvillimit gjeologjik, shkëmbi është zhvendosur dhe, për rrjedhim, në vende të veçanta të shtrirjes së tij formohen vatra me sforcime të ndryshme. Kjo gjë bëhet edhe më e theksuar kur zona e zhvendosur përbëhet nga shkëmbinj me veti të ndryshme mekanike. Për rrjedhim, në këtë rast hapja e punimit bën që të prishet gjendja e ekuilibrit të shkëmbinjve dhe në vendet e akumulimit të energjisë ndaj punimit minerar krijuhen presione shumë më të mëdha se ato të llogaritura më lart, duke prishur kësosoj ligjin e përgjithshëm të shpërndarjes së presioneve nëpër koren e Tokës.

Në largësinë 500-550 m nga hyrja e tunelit duket qartë se serpentinitet e brekçezuara, që ndodhen herë mbi gëlqerorët dhe herë të tjera në gjendje të sforuar brenda gëlqerorëve, kanë veti plastike shumë më të madhe se gëlqerorët. Tektonika zhvendosëse, që i ka shkatërruar këta shkëmbinj dhe i ka sjellë në kushte të tjera nga ato të krijimit parësor, si dhe, nga ana tjetër, rritje e deformimeve plastike si pasojë e peshës së tyre dhe marrëdhëni tektonike me gëlqerorët, bëjnë të mundur që me hapjen e tunelit dhe me parashpënien e tij, në këta

shkëmbinj të çlirohet një sasi e madhe e energjisë plastike të akumular. Si përfundim, në tunel u krijuan presione të paparashikuara. Në këtë rast, presioni vertikal krijoj sforcime ngjeshëse në anët e punimit, duke formuar një «bark» dhe një zhvendosje të mbështetjeve të këmbëve të armaturës. Për pasojë, u ngushtua seksioni i punimit në disa dhjetra milimetra dhe u prish armatura fillestare e llogaritur në bazë të shpërndarjes normale të presioneve. Në këtë mënyrë, presioni horizontal u bë më i madh se presioni vertikal dhe arriti deri në 40 T/m^2 . Koeficienti i përqëndrimit të sforcimit, që shprehet me përpjessëtimin midis sforcimit të lidhur pas hapjes së punimit dhe atij në kushte normale, arriti deri në 2,5. Për rrjedhim, gjatë projektimit të punimeve nëntokësore me kushte të ngjashme me ato të Qafëthanës, këto lloje presionesh duhet të parashikohen në projekt, sepse kanë rëndësi të madhe në parashikimin e metodës së parashpënies së tunelit, të llojës së veshjes dhe të afatit të kryerjes së punimit minerar.

PERFUNDIME

1 – Kufiri lindor i zonës tektonike të Mirditës, që kontakton tektonikisht me zonën e Korabit, ka një ndërtim gjeologjik shumë të koklavitur. Biloqet tektonike të gëlqerorëve me përmasa të ndryshme, nuk duhet të merren si mbulesa sipërfaqësore. Ato ndodhen edhe në thellësi dhe janë rrethuar nga melanzhi tektonik, që është karakteristik për kontaktin e shkëmbinjve ultrabazikë me shkëmbinjtë rrethues.

2 – Shkëmbinjtë që takohen në sektorin e gjurmës së tunelit kanë veti të ndryshme gjeoteknikë: gëlqerorët i kanë të larta, kurse serpentinitet dhe melanzhi tektonik serpentinitik i kanë shumë të ulta. Kjo është karakteristike edhe për zona të ngjashme me ndrydhje të theksuara.

3 – Si pasojë e prishjeve tektonike shkëputëse në disa faza dhe i tipit bllokor-mbulesor, në shkëmbinjtë serpentinitikë e në melanzhin tektonik me veti më të larta plastike vërehen sforcime mbetëse me vlerë deri në 40 t/m^2 , të cilat krijojnë anomali në parashpënien normale të punimit minerar.

LITERATURA

- 1 – Shehu V., Demi N., Konomi N. – Raport për kushtet inxhiniero-gjeologjike të tunelit të Qafëthanës. Tiranë, 1977.
- 2 – Demi N., Ahmetaj L. – Disa probleme gjeologo-teknike të tunelit të Qafëthanës. Tiranë, 1980.
- 3 – Avxhiu R. – Raport i punimeve elektrometrike e magnetometrike për sektorin e Qafëthanës. Tiranë, 1977.

Dorëzuar në redaksi
në korrik 1980.

Résumé

Le tunnel de Qafethane et ses traits géologiques-ingénieriques

Le tunnel de Qafethane sur la voie ferrée Prrenjas-Pogradec, d'une longueur de 3 015 m, a été percé dans l'extrême orientale de la zone tectonique de Mirdita, au voisinage direct de la zone tectonique du Korab. Dans ce milieu,

le secteur de Qafethane se caractérise par une combinaison tectonique écailleuse-disloquante et en bloc. Sa structure géologique comporte la série de silex tufitique à diabases fragmentaires, au-dessus de laquelle viennent des calcaires en couches, qui passent aux calcaires massifs du Trias supérieur. Aux points de contact de ces formations on trouve des roches ultrabasiques, qui prédominent et sont associées à des fragments de gabbro et de diabases. Les ultrabasiques, représentées principalement par des harzburgites et des serpentines, sont fortement écrasées par les mouvements tectoniques de certaines phases sur déplacement et d'abaissement en bloc, ce qui est à l'origine du puissant mélange tectonique de serpentines. Et en conséquence, à une disposition des blocs de calcaires à l'intérieur de ce mélange également. Par endroits la masse du mélange de serpentines et de morceaux de peridotites revêt un aspect cimenté et de nature bréchique. Les calcaires sont karstiques, il en est de même de la couverture des eaux superficielles et souterraines. Les ultrabasiques et le mélange sont imperméables à l'égard de l'eau. D'où l'apparition de l'eau au moment du passage du tunnel des ultrabasiques aux calcaires.

Les calcaires, de leur côté, ayant des traits élevés géotectoniques, ont facilité le percement du tunnel. Les ultrabasiques, les serpentines et le mélange tectonique, se caractérisant par des traits peu favorables sur le plan géotectonique, ont donné lieu à la manifestation de puissantes pressions des minéraux du côté oriental (de Prrenjas).

La connaissance des conditions ingénierо-géologiques du tunnel a connu trois phases: la phase de la prognose préliminaire pour l'élaboration du projet, la phase successive au commencement des travaux de la phase conclusive. Bien que durant la phase de percement du tunnel on a employé aussi les méthodes géophysiques, les anomalies diverses qui différenciaient les roches calcaires et ultrabasiques ont été relevées jusqu'à une profondeur non supérieure aux 100 m, ce qui a été conditionné par la présence de l'eau dans les parties profondes des calcaires, par la structure géologique complexe et par le terrain montagneux difficile.

Par suite des accidents tectoniques et de la destruction tectonique des roches, on a relevé dans les serpentines et le mélange tectonique aux traits plastiques élevés des résidus d'efforts, qui ont créé les anomalies dans le percement normal du tunnel.

Fig. 1: Carte géologique-ingénierique schématique du secteur du tunnel de Qafethane.
1 — Péridotites serpentiniés et altérées; 2 — banc effusivo-sédimentaire;
3 — calcaires; 4 — cassure de la zone tectonique.

Fig. 2: Coupe géologique-ingénierique du tunnel de Qafethane.
a — pour la phase de la conception du projet; b — après la prospection géophysique; c — à la conclusion des travaux.

1 — Calcaires massifs du Trias supérieur; 2 — schistes calcaires-roches effusives; 3 — péridotites et serpentines altérées; 4 — zone tectonique; 5 — cassure tectonique disloquante; 6 — écoulement concentré des eaux souterraines; 7 — l'axe du tunnel.

Mineralet e dobishme

PLAZHI I SEMANIT, PASURIMI I TIJ ME MINERALE TË RËNDA, KUSHTET E FORMIMIT DHE PËRBËRJA MINERALOGJIKE

— Ruzhdi Cara*, Faridin Mullaj** —

Në artikull pasqyrohen shkurtimisht rezultatet e punës disavjegare dhe faktat e grumbulluara lidhur me ripërtëritjen e plazhit të Semanit dhe pasurimi i tij me minereale të rënda të dobishme.

H Y R J E

Kongresi i 7-të i PPSH, ndër të tjera, shtroi edha detyrën e rëndësishme të kërkim-zbulimit të mineralevë të rënda e të rralla, sidomos rritjen e aftësisë prodhuese për këto minerale. Në vijim të vëniec në jetë të kësaj detyre si dhe në zbatim të vendimit të qeverisë së RPSSH për ngritjen e fabrikës së pasurimit të rezervave të rërave bregdetare të vendit tonë, janë kryer dhe po kryhen studime për mineralet e dobishme të rënda që përbajnë këto rëra. Ato përfshijnë rërat bregdetare të plazheve tona dhe rërat e sopeve (dunave).

Tashmë është bërë e njehur se plazhet e vendit tonë janë të pasura me minerale të rënda të ndërthurura ose të shpërndara njëtrajtësishët në masën e rëres (4, 6, 7), siç janë kromshpinelidi, titanomagnetiti, granatet, ilmeniti, rutili, zirkoni dhe disa minerale të tjera shqëruar. Ato mund të përdoren në industrinë tonë metalurgjike, kimike etj. si dhe për eksport, në shërbim të forcimit të ekonomisë sonë socialiste.

Plazhi i Semanit është një ndër plazhet më të pasura me këto mine-

* Miniera e Qymyrgutit në Manëz-Durrës.

** Ndërmarrja Gjeologjike e Tiranas.

rale. Këtu, për vite me radhë, janë kryer punime gjeologjike për shtimin e rezervave dhe studime lidhur me ligjshmërinë e pasurimit natyror të këtij plazhi me minerale të dobishme të rënda (4).

NATYRA E PLAZHIT TË SEMANIT DHE PASURIMI I TIJ ME MINERALE TË RËNDË

Ka një shtrirje mjaft të gjërë përgjatë bregdetit jugor të Adriatikut. Është mjaft i hapur, në trajtën e një gjiu të pambrojtur (pa dalje të kepeve). Lëvizja e masës së rërës dhe shpërndarja e mineraleve të rënda janë të ndryshme: ndeshen zona shumë të pasura e zona të varfëra. Zona që paraqet më tepër interes paraqitet në trajtën e një rripti prej masës së rërës së pasur me minerale të rënda. Sopet e reja, që shkojnë paralelisht me këtë rripti, herë lartësohen e herë krijojnë ultësira, aqsa janë sheshuar fare për shkak të veprimtarisë së valëve të detit e të erës, që e kanë shpërndarë rërën në drejtim të kontinentit (për në lindje).

Në tërë plazhin kemi vijueshmëri të masës së rërës, e cila, atykëtu, është ndërprerë nga kanale të formuara prej valëve të detit gjatë furtunave, duke lidhur detin me kënetën ose me lagunat e vogla, siç është Liqeni i Gjëmisë. Afër kësaj zone ndeshet një zonë në të cilën plazhi paraqitet i shplarë, domethënë në të cilën krejt masa e rërës është larguar, duke dalë në sipërfaqe pakot argjilore të ndërthurura me rërë e surëra të gjelbëra. Pikërisht këtu ndodhet edhe shtrati i vjetër i lumbit të Semanit (Lumi i Vdekur), gjë që tregon se ky lumë ka ndërruar hera-herës shtratin e vet (5) dhe, për pasojë, vija bregdetare ka pësuar ndryshime në varësi të mbathjes (prurjeve) dhe të gjerryerjes së shkaktuar nga valët e detit dhe rrymat detare.

Masa rërore e këtij plazhi është polimikte, me madhësi kokrrizash mesatarisht 0,1-0,2 mm. Në të vërehen copëza mineralesh të shkëmbinjve ultrabazikë, bazikë, të metamorfizuar dhe të depozitimeve sedimentare, që rrëthojnë plazhin. Rëra është e asortuar mirë.

Pasurimi i plazhit takohet kryesisht në sipërfaqe dhe paraqitet në trajtë aureolash ose njollash të zeza, si shtresëza të holla e si breza të zinj të pasur me minerale të rënda.

Tërë ato që përshkruam më sipër përbëjnë «koncentratin natyror». Brezat e zinj të këtij koncentrati ndodhen në nivele të ndryshme të masës së rërës dhe priren (bien) për në perëndim (çka tregon për intervale të ndryshme të formimit të tyre). Ata janë me trashësi deri në 10-12 cm dhe përbëhen në masën 70-80% nga fraksioni i rëndë. Ky i fundit është në varësi të fuqisë përpunjuese të valëve të detit. Masa tjetër e rërës ka një pasurim të njëtrajtshëm, që arrin deri në kufirin me nivelin e ujrave nëntokësore. Fill pas këtij niveli rëra është ndërthur me alevrolite, copëza argjilore me fare pak minerale të dobishme dhe me përbajtje mjaft të ulët (shih fig. 1).

Siç shihet edhe nga fig. 1, që përfaqëson një prerje tërthore të zonave të ndryshme të pasurimit, duke iu referuar përbajtjes mesatare të të gjitha provave të marra dhe të llogaritura 100 % përkundrejt mineralit të kromit, kemi të dhënat faktike të paraqitura në pasqyrën 1, për vitet 1976-1977-1978, vetëm për mineralet e dobishme




Fig. 1: Pamje skematike e llojit të pasurimit të plazhit të Semanit.
a – Koncentrat i depozitar në trajtë aureolash; b – breza të zinj të ndërthurur; c – rërë me shpërndarje të njëtrajtshme të fraksionit të rëndë; ç – rërë e varfër kënetore.

Pasqyra 1.

Përbajtja mesatare e mineraleve të dobishme, në %, përkundrejt mineralit të kromitit

| Numri i provave | Titanomagnetit | Kromit | Granat | Ilmenit | Rutil | Zirkon | Leukoksen |
|-----------------|----------------|--------|--------|---------|-------|--------|-----------|
| 1-19 | 8,18 | 100 | 44,85 | 17,18 | 1,42 | 1,46 | 0,94 |
| 20-39 | 29,40 | 457,2 | 224,22 | 66,42 | 5,86 | 5,91 | 4,20 |
| 40-50 | 1,34 | 12,48 | 4,20 | 1,88 | 0,42 | 0,45 | 0,26 |

Shënim: 1-19 – prova me pasurim të njëtrajtshëm;
20-39 – prova me breza të zinj;
40-50 prova me përbajtje të varfër të mineraleve të rënda.

Siç del dhe nga pasqyra 1, pasurimi jo gjithmonë është i njëjtë, meqenëse shpërndarja ose përqëndrimi i mineraleve të rënda bëhen në periudha të ndryshme dhe në zona të ndryshme, gjë që lidhet shumë me kushtet e krijuara në varësi të intensitetit të valëve, të drejtimeve të tyre dhe të faktorëve të tjera. E rëndësishme është se, sa më pranë sipërfaqes, aq më e pasur është rëra me minerale të rënda dhe, në të kundërt, sa më thellë të shkojmë, aq më shumë varfërohet ajo, meqenëse rëra e sipërfaqes përpunohet më shpesh nga dallgët e detit dhe nga era.

Duke u mbështetur në të dhënat faktike të grumbulluara deri më sot dhe në pozicionin gjeografik të plazhit të Semanit, me kushte të përshtatshme të një gjiri të hapur e të ushqyershëm nga prurjet e dy lumenjve Seman e Vjosë, themi se, në tërësi, plazhi pasurohet vazhdimisht me minerale të rënda, si në sipërfaqe dhe në thellësi, prakemi një ripërtëritje periodike të tij.

PASURIMI I PLAZHIT DHE KUSHTET E SHFRYTEZIMIT E TË FORMIMIT TË TIJ

Ashtu siç e thamë edhe më sipër, plazhi i Semanit pasurohet herëpashore, sidomos gjatë periudhës nëntor-mars, kur mbizotërojnë erërat e forta jugperëndimore dhe, për pasojë, valët e detit kapërcjejnë bregun e mbulojnë plazhin. Gjatë shuarjes së valëve në sipërfaqe mbeten e depozitohen shtresëza të zesa të koncentratit të pasur me minerale të dobishme të rënda dhe me minerale të tjera shoqëruar. Këto shtresëza, me përbajtje të lartë të fraksionit të rëndë, grumbullohen në mënyrë të thjeshtë. Ato mund të merren me lopatë, të depozitohen togje-togje dhe të transportohen për në impiantin e pasurimit.

Pas një farë periudhe, po në ato zona ose afër tyre, vihet re depozitimi i «koncentratit natyror».

Në vitin 1973 këtu filloj për herë të parë shfrytëzimi. Merrej ose grumbullohej sasia e koncentratit me përbajtje 60-75% të fraksionit të rëndë; ndërsa pjesa tjetër e masës së rërës lihej në vend dhe i nënshtrohet më vonë përpunimit nga valët e detit. Nga viti 1973 deri në vitin 1980 është marrë periodikisht koncentrati natyror i plazhit të Semanit (shih fig. 2).




Fig. 2: Shfrytëzimi i plazhit të Semanit gjatë viteve 1973-1980, duke marrë vitin 1973 100% të vlerësuar në ton.

Sic shihet edhe nga fig. 2, sasia e koncentratit të grumbulluar në plazh është në rritje, megjithëse vërehet një farë ulje e përbajtjes së fraksionit të rëndë të dobishëm në koncentratin bregdetar.

Theksojmë se pasurimi, ose ripërtëritja e plazhit të Semanit bëhen falë procesit ose ciklit natyror, që kushtëzohet nga disa faktorë të rëndësishëm, sic janë: shkëmbinjtë mëmë, që rrëthojnë zonën; shtrirja e gjerë e rrjetës lumore me prurje të shumta; gjemorfologjia e zonës bregdetare akumulative; rrymat detare, valëzimi, baticat e zbaticat; kahu i erërave mbizotëruar etj. Lumenjtë Seman dhe Vjosë sjellin qdo vit sasira të mëdha rërash e llumesh, të cilat, kur zbrazen në dimër në deltat e tyre, transportohen, përpunohen e pašurohen, duke u

bërë një burim i vazhdueshëm ushqyes për plazhin. Në rastet e furtunave detare, sidomos kur fryjnë erërat me kah nga jugperëndimi, që favorizohen edhe nga dallgët e mëdha me kah të njëjtë, lënda e depozituar afër grykëderdhjeve lëvis e mbartet nga valët e detit dhe nga rrymat detare. Falë diferencimit të bërë nga valët dhe rrymat detare, peshës specifike e madhësisë së kokrrizave, lënda depozitohet gjatë bregut në trajtë shtresëzash të holla. Sa më të fuqishme të jenë stuhitë detare, aq më shumë lëndë vjen në sipërfaqe të plazhit. Po që se ndryshon drejtimi i erërave, domethënë nga jugperëndimore, që është drejtimi më i favorshëm, në veriore ose verilindore, nis edhe varfërimi i lëndës me minerale të rënda, ose koncentrati i depozituar në shkallët e ndryshme të plazhit shpërndahet, përzihet me rërën shterpe, rimerret nga valët e detit ose mbulohet nga rërat shterpe.

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, është e domosdoshme që, fill pas pasurimit të plazhit me fraksion të rëndë, koncentrati të grumbullohet përnjëherë dhe të largohet nga zona e pasuruar, në mënyrë që të arrijmë të grumbullojmë sa më shumë koncentrat të dobishëm.

Përveç këtij koncentrati me përbajtje të lartë të fraksionit të rëndë, 60-70% të masës së rërës së plazhit, kemi edhe minerale të shpërndara njëtraftësisht e me përbajtje brenda kondicioneve të miratuar për shkrifërimet bregdetare. Ato, duke përdorur pajisje të mekanizuara, mund të shfrytëzohen fare mirë dhe përbëjnë një bazë të shëndoshë si lëndë e parë për fabrikën e pasurimit të rërave bregdetare.

MINERALOGJIA DHE PËRBËRJA KOKRRIZORE E SHKRIFËRIMEVE TË PLAZHIT TË SEMANIT

Meqenëse lidhur me përbërjen mineralogjike të shkrifërimeve bregdetare të vendit tonë është folur edhe më parë, këtu po japim një pasqyrë të shkurtër karakterizuese vetëm për shkrifërimet e plazhit të Semanit.

Për studimin e përbërjes kokrrizore të shkrifërimeve të këtij plazhi zgjodhëm klasat nga +0,4 deri në -0,063 mm. Përbërja kokrrizore e tyre jepet në pasqyrën 2.

Pasqyrë 2.

Përbërja kokrrizore, në %, sipas diametrave përkatëse

| + 0,4 | +0,2 | +0,1 | +0,09 | +0,063 | -0,063 | Gjithësej |
|-------|------|------|-------|--------|--------|-----------|
| 28,9 | 45,3 | 15,7 | 1 | 9 | 0,1 | 100 |

Pra pjesën më të madhe të lëndës e përbëjnë kokrrizat me përmasa $\langle 0,4 \rangle = 0,2$ (45,3%).

**Përbërja mineralogjike e parë
në spektrin kokrrizor**

Nga studimet e kryera lidhur me përbërjen mineralogjike (shih pasqyrën 3), del se përbajtja e mineralevë të fraksionit të rëndë luhatet në kufijtë 0,4–58,7% (mesatarisht 9,41%); kurse mineralet e fraksionit të lehtë përbëjnë 41,3–99,6% të shkrifërimeve të plazhit.

Pasqyra 3.

**Shpërndarja e kokrrizave në % sipas
diametrave përkatëse (mm)**

| Fraksionet | +0,315 | +0,2 | +0,1 | +0,09 | +0,063 | -0,063 |
|------------|--------|------|------|-------|--------|--------|
| I lehtë | 97,1 | 64,1 | 41,3 | 99 | 98,9 | 99,6 |
| I rëndë | 2,9 | 35,9 | 58,7 | 1 | 1,1 | 0,4 |

Nga studimi i përbërjes mineralogjike del se mineralet kryesore janë ato të fraksionit të lehtë dhe konkretisht kuarci e aggregatet me $n > 1,544$ (shih pasqyrën 4).

Pasqyra 4.

Përbërja mineralogjike e fraksionit të lehtë

| Mineralet | Pjesëmarrja në përbërjen e fraksionit të lehtë, % | Mineralet | Pjesëmarrja në përbërjen e fraksionit të lehtë, % |
|--------------------------|---|--------------------------|---|
| Kuarc | 40,9 | Aggregate të $N < 1,544$ | 1,12 |
| Aggregate të $N > 1,544$ | 22,6 | Kuarc-feldshpat | 1 |
| Feldshpat | 12,25 | Muskovit | 0,5 |
| Serpentinë-klorite | 11 | Mikë e gjelbër | 0,25 |
| Copa kuarc-silicore | 10,5 | | |

Për përbërjen e fraksionit të rëndë themi se në të marrin pjesë më shumë se 30 mineralet dhe konkretisht: magnetit-titanomagnetiti, mineralet e grupit të kromshpinelideve, të pirokseneve, të granateve, të epidotit, të amfiboleve, të kloriteve, olivina, ilmeniti, limonit-hematiti, leukokseni, rutili, zirkoni, sfeni, anatasi, turmalina, stavroliti, disteni, apatiti, bariti, kloritoidi, shpineli etj. Nga mineralet e rënda të dobishme, masën kryesore e përbëjnë mineralet e grupeve të kromshpinelideve, të granateve, ilmenitit, të magnetit-titanomagnetitit; ndërsa mineralet e tjera zenë një vend më të vogël (shih pasqyrën 5).

Pasqyra 5.

Përbërja mineralogjike e fraksionit të rëndë

| Mineralet | Pjesëmarrja në përbërjen e fraksionit të rëndë, % | Mineralet | Pjesëmarrja në përbërjen e fraksionit të rëndë, % |
|-------------------------|---|-----------|---|
| Kromshpinelide | 35,19 | Leukoksen | 0,39 |
| Granate | 14,24 | Rutil | 0,70 |
| Ilmenit | 11 | Zirkon | 0,22–0,41 |
| Magnetit-titanomagnetit | 5 | | |

Duke parë shpërndarjen e mineralevë kryesore të dobishme sipas përbërjes kokrrizore, del në pah, se në përgjithësi, ato përqëndrohen në fraksionet me përmasa të sitave $< 0,2 > 0,1$ mm. Këtu përfjashtohet rreth 52% e zirkonit, i cili përqëndrohet në fraksionet e sitave me përmasa $< 0,1 > 0,078$ mm (shih pasqyrën 6).

Pasqyra 6.

**Përbërja kokrrizore e disa mineralevë kryesore
të dobishme, %, sipas diametrave përkatëse (mm)**

| Mineralet | +0,42 | +0,2 | +0,1 | +0,078 | +0,056 | +0,046 | -0,046 | Shuma |
|--------------------------|-------|-------|-------|--------|--------|--------|--------|-------|
| Kromshpinelide | 0,019 | 2,215 | 92,53 | 4,96 | 0,23 | 0,028 | — | 100 |
| Granate | — | 4,10 | 89,42 | 5,61 | 0,60 | 0,058 | 0,19 | 100 |
| Magnetit-tita-nomagnetit | 0,56 | 17,99 | 73,17 | 6,64 | 0,54 | 0,56 | 0,51 | 100 |
| Rutil | 0,011 | 0,63 | 91,85 | 7,38 | 0,077 | 0,022 | 0,022 | 100 |
| Zirkon | 0,009 | 0,027 | 47,42 | 52,08 | 0,27 | 0,072 | 0,099 | 100 |

**VEÇORITË E MINERALEVE TË DOBISHME KRYESORE
TË FRAKSIONIT TË RËNDË**

1 — Mineralet e grupit të kromshpinelideve.

Janë mineralet kryesore të fraksionit të rëndë. Në pjesën më të madhe të tyre paraqiten në trajtë kokrrizash të parregullta me periferi të thepisur, ose disi të rrumbullakosura; aty-këtu takohen kristale me trajta karakteristike oktaedrike (111). Janë me ngjyrë të zezë, me shkëlqim metaloid në pamje; në copat, janë të ngjashme me asfaltet; ndërsa të kokrrizat ose kristalet, që i janë nënshtruar procesit të limonitizimit, ngjyra eshtë disa e kuqëremtë. Kanë thyerje zgavrore. Copat e vogla e të holla janë deri në gjysëm të tejdukshme. Gjatë matjes së indeksit të thyerjes të dritës rezultoi vlera $N \approx 2,085$. Kromshpinelidet e fraksionit elektromagnetik kanë peshë specifikë barabar me 4,460.

Nga analiza e përbërjes kokrrizore doli se shumica e kromshpinelideve (92,53%) përqëndrohen në fraksionin e sitave me përmasa $<0,2>0,1$ mm.

Gjatë ndarjes sipas aftësive magnetike, mineralet e këtij grupi përqëndrohen kryesisht në fraksionin elektromagnetik (shumelektrömagnetik 16,27%, elektromagnetik 58,04% dhe pakelektrömagnetik 22,42%). Në fraksionin magnetik përqëndrohen 5,26% e kromshpinelideve.

Vrojtimi mikroskopik i anshlifeve të përgatitura me konecentrat kromshpinelidi nxori në pah se shumica e kokrrizave janë me trajta të çrrëgullta; takohen edhe kokrriza të rrumbullakosura, por ndërmjet tyre takohen edhe kokrriza me pamje idiomorfe-katërkëndore e katrore. Kromshpinelidet e fraksionit magnetik i janë nënshtruar procesit të magnetizimit, që është zhvilluar përréth kokrrizave në trajtën e një brezi të hollë, si njolla dhe, në disa raste, është zhvilluar aq shumë, sa që kanë mbetur bërtama të vogla kromiti të pazëvendësuara plotësisht. Në kromshpinelidet e fraksionit elektromagnetik janë vërejtur kokrriza të pastra, pa ndërfutje, por vërehen edhe kokrriza të gërryerë e që vende-vende paraqiten të magnétitizuara, të zëvendësuara nga magnetiti (fraksioni shumelektrömagnetik). Ka raste kur gërryerja është zhvilluar aq shumë, sa që kokrrizat janë shndërruar tëresisht në minrale jometalore.


Përbërja elementare në bazë të analizës kimike dhe rezultatet e analizës spektrale gjysëmsasibre jepen përkatesisht në pasqyrat 7 dhe 12.

Pasqyra 7.

Përbërja kimike e kromshpinelideve në përqindje peshore

| SiO ₂ | TiO ₂ | Cr ₂ O ₃ | Al ₂ O ₃ | Fe ₂ O ₃ | FeO | MgO | CaO | MnO | Shuma |
|------------------|------------------|--------------------------------|--------------------------------|--------------------------------|-------|------|------|------|-------|
| 2,13 | 0,16 | 47,39 | 18,20 | 7,50 | 15,20 | 8,29 | 0,14 | 0,25 | 99,65 |

Në bazë të rezultateve të mësipërme, nxjerrim se kromshpinelidet e plazhit të Semanit përkojnë me këtë formulë kristalokimike:



Llogaritja e tyre në bazë minallesh jep këtë përbërje normative në %: MgAl₂O₄ 33,32; MgCr₂O₄ 8,70; FeCr₂O₄ 49,70; FeFe₂O₄ 8,26.

Sipas klasifikimit të njohur, këto kromshpinelide janë të llojit subalumoferrikrómít hekuror, ose krompikótít.

2 – Mineralet e grupit të granateve.

Zënë vendin e dytë në mineralet e fraksionit të rëndë. Zakonisht paraqiten në trajtën e kokrrizave të çrrëgullta, me periferi të thepisur dhe disa herë disi të rrumbullakosura. Rrallë takuan kristale rrombë-dodekaedrike (110). Takohen në ngjyra të ndryshme: trëndafili, trëndafili

fili e zbardhur, e gjelbër e zbardhur dhe kokrriza pa ngjyrë. Kanë shkëlqim xhamor. Thyhen pak a shumë me vështirësi. Sipas matjeve të bëra në sipërfaqe të poluar, mikrofortësia e tyre lëkundet në kufijtë $H_m = 1\,377,4 - 1\,449 \text{ kg/mm}^2$. Ka raste kur brenda kristaleve vërehen ndërfutje të vogla të minraleve të tjera.

Për mineralet e këtij grupi është karakteristik indeksi i madh i thyerjes së dritës, më i madh se 1 780. Në raste të veçanta, me ndihmën e mikroskopit vumë re se ka kokrriza me veti anizotropike.

Pesha speciflike e granateve është 4,15.

Gjatë ndarjes së shlihut ngjyrë hiri me lëng bromoformi (me peshë speciflike 2,89) dha, pastaj, me ndihmën e elektromagnetit, granatet përqëndrohen në fraksionin elektromagnetik, me peshë specifike më të lartë se 2,89.

Nga analiza për përbërjen kokrrizore doli se shumica e granateve (89,42%) përqëndrohet në fraksionin e sitave $<0,2>0,1$ mm. Kurse nga të dhënat e analizës spektrale gjysëmsaslore doli se përbërës krysore janë silici, alumin, hekuri; përbërës të dorës së dytë janë, në sasi të rëndësishme, magnezi, kalciumi e mangani. Elementet e tjera marrin pjesë në sasira të papërfillshme dhe mund të janë rrjedhim i përzierjeve izomorfike (shih pasqyrën 12).

Granatet kanë këtë përbërje kimike (në përqindje peshore):

Pasqyra 8.

| SiO ₂ | TiO ₂ | Al ₂ O ₃ | Fe ₂ O ₃ | FeO | MnO | MgO | CaO | Shuma |
|------------------|------------------|--------------------------------|--------------------------------|-------|------|------|------|-------|
| 37,68 | 0,08 | 19,27 | 2,63 | 28,75 | 1,29 | 4,97 | 3,45 | 99,50 |

Në bazë të rezultateve të mësipërme, nxjerrim përfundimin se granatet e plazhit të Semanit përkojnë me këtë formulë kristalo-kimike:



Kanë këtë përbërje normative në bazë minallesh:

Pasqyra 9

| Minallet | Përbërja, % | Minallet | Përbërja, % |
|------------|-------------|----------|-------------|
| Almandin | 64,75 | Andradit | 7,98 |
| Pirop | 19,99 | Grosular | 4,26 |
| Spesartine | 2,93 | Shuma | 99,91 |

Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme, del se në mineralet e grupit të granateve të këtij plazhi mbizoteron grapi i piralspitave, që përfaqësohet nga almandini; kurse grapi i ugranditeve, që përfaqësohet nga andraditi dhe grosulari, përbën vetëm një pjesë të vogël të sasisë së përgjithshme.

3 – Ilmeniti.

Zakonisht e takuam në trajtën e kokrrizave të çrregullta ose pllakore. Ka raste kur i është nënshtuar procesit të leukoksenizimit me intensitet jo të njëjtë për kokrriza ose pllaka të ndryshme. Për nga përmasat, shumica e kokrrizave përqëndrohen në fraksionin $<0,2>0,1$ mm. Gjatë ndarjes së mineraleve të fraksionit të rëndë sipas aftësive magnetike dhe aftësive elektromagnetike, ilmeniti përqëndrohet, në përgjithësi, në fraksionin shumelektronmagnetik.

Rezultatet e analizës spektrale gjysëmsasiore jepen në pasqyrën 12.

4 – Magnetit-titanomagnetiti.

Zakonisht i takuam në trajtën e kokrrizave të çrregullta dhe, rrallë, në trajtën karakteristike oktaedrike (111), me përmasa që përfshihen pothuajse tërësisht në fraksionin e sitave $<0,2>0,1$ mm (73,17%). Gjithashtu ndeshen kokrriza në trajtë ndërfutjesh te një pjesë e mineraleve të tjera, duke i pajisur ato me aftësinë për t'u përqëndruar në fraksionin magnetik.

Në anshlif, magnetiti paraqitet me kokrriza të veçanta e të çrregullta e, rrallë, idiomorfe. Është karakteristike se në shumë raste, këto kokrriza përbajnjë ndërfutje mineralesh jometalore. Njëkohësisht, si pasojë e procesit të magnetitizimit, magnetiti zëvendëson në masa të ndryshme kromshpinelidet. Ky proces është zhvilluar përreth kokrrizave të kromshpinelideve në trajtën e një brezi të hollë ose si njolla, duke arritur në atë shkallë sa që kokrriza e kromshpinelidit ka ngelur si një bërtbamë e vogël. Mendojmë se është formuar si rezultat i ndryshimit metamorfik të masivëve magmatikë ultrabazikë.

Studimi në anshlif i titanomagnetitit nxori në pas se paraqitet në trajtë kokrrizash të veçanta me përvijëzime të çrregullta. Brenda këtyre kokrrizave janë përqëndruar thupra ilmeniti, të cilat janë vendosur në trajtë rrjetë dhe në disa vende vihet re vendosja e thuprave sipas drejtimeve kristalografike (shih fig. 3).




Fig. 3: Kokrriza titanomagnetiti me thupra ilmeniti të vendosura sipas drejtimeve kristalografike.

Ashtu si edhe për mineralet e tjera, rezultatet e analizës spektrale gjysëmsasiore jepen në pasqyrën 12.

5 – Leukokkseni.

Pothuajse gati tërësisht (mbi 90%) përqëndrohet në fraksionin e sitave $<0,2>0,1$ mm. Zakonisht paraqitet në trajtë kokrrizash të çrregullta, këndore dhe me rrumbullakim të ndryshëm. Si mineral dytësor i titanit, takohet si pseudomorfozë pas ilmenitit, rutilit, sfenit, anatasit. Ngandonjëherë vihen re ndërfutje ose njolla të zeza, që janë pjesë të ilmenitit jo të leukoksenizuar. Përqëndrohet kryesisht në fraksionin pak-elektronmagnetik dhe sidomos në atë jolelektronmagnetik. Në fraksionet e tjera takohet fare pak.

Për rezultatet e analizës spektrale gjysëmsasiore shih pasqyrën 12.

6 – Rutili.

Pjesa më e madhe e kokrrizave të këtij minerali (91,85%) përfshihet në fraksionin e sitave $<0,2>0,1$ mm. U takua në trajtë kokrrizash të çrregullta, të stërgjatura, në disa raste disi të rrumbullakosura dhe, më rrallë, në trajtë kokrrizash prizmatike, me vijëzime përgjatë shtrirjes së prizmit. Paraqitet me ngjyrë të kuqe – të kuqe në të verdhë – të kuqe në të zezë deri në të zezë (me këtë ngjyrë ndeshet zakonisht në fraksionin elektromagnetik). Ka raste kur brenda kokrrizave të tij vihen re përbillyje ose njolla të errta. Në drithë të përshkuar vërehet se, në përgjithësi, kokrrizat e rutilit janë me trajta të veçanta, të çrregulla, prizmatike të thyera dhe gjysmë të rrumbullakosura. Një pjesë e tyre, si pasojë e procesit të leukoksenizimit, janë gërryer dhe prishur.

Lidhur me përbërjen kimike të rutilit mund të gjykojmë nga rezultatet e analizave kimike (pasqyra 10) dhe të analizave spektrale gjysëmsasiore (pasqyra 12).

Pasqyra 10.

Përbërja kimike e rutilit në përqindje peshore

| TiO ₂ | SiO ₂ | Fe ₂ O ₃ | Al ₂ O ₃ | Cr ₂ O ₃ | Nb ₂ O ₅ | V ₂ O ₅ | CaO | MgO | MnO | Shuma |
|------------------|------------------|--------------------------------|--------------------------------|--------------------------------|--------------------------------|-------------------------------|------|------|------|-------|
| 94,41 | 4,26 | 0,25 | 0,20 | 0,07 | 0,47 | 0,10 | 0,07 | 0,16 | 0,01 | 100 |

Nga të dhënat e analizës spektrale gjysëmsasiore del se elementi kryesor i rutilit, si zakonisht, është titani; ndërsa si përzierje janë Si, Fe, Al, Cr, Nb, V, Ca, Mg, Mn etj.

7 – Zirkoni.

Përqëndrohet pothuajse tërësisht (99,50 %) në fraksionin e sitave $<0,2>0,078$ mm. E takuam në trajtën e kristaleve të tipeve të ndrysh-

më morfollogjike (mbizoteron zhvillimi i prizmit) dhe si kokrriza të rrumbullakosura. Ka raste kur brenda kristaleve e kokrrizave të tij vihen re ndërfutje të huaja, të cilat, në dukje, janë opake, gjysëm ose tërësisht të tejpushme. Ndërfutjet opake bëjnë që kokrrizat e tij të bien në fraksionin pakelektromagnetik (zirkoni përqendrohet kryesisht në fraksionin jolelektrömagnetik). Në pjesën më të madhe (64 %) është pa ngjyrë, kurse pjesa tjeter (36%) paraqitet me ngjyrë trëndafili të çelur.

Nga analizat kimike del në pah përbajtja e lartë e TiO_2 (shih pasqyrën 11), gjë që mund të vijë nga prania e papastërtive. Përbajtja elementare është dhënë në pasqyrën 12.

Pasqyra 11

Përberja kimike e zirkonit në përqindje peshore


| $(ZrHf)O_2$ | SiO_2 | TiO_2 | Fe_2O_3 |
|-------------|---------|---------|-----------|
| 63,40 | 31,45 | 2,23 | 0,35 |

Pasqyra 12.

Rezultatet e analizave spektrale gjysëmsasiore të mineralev kryesore të rërës së pasuruar të plazhit të Semanit (në %)

| Elementet | Kromshpinellide | Granate | Magnétit-titano-magnétit | Ilmenit | Leukoksen | Rutil | Zirkon |
|-----------|-----------------|-----------|--------------------------|-----------|-----------|-----------|-------------|
| Si | 1 | Mbi 10 | 5 | 1 | 5 | 1–3 | Mbi 10 |
| Al | Mbi 10 | Mbi 10 | 0,1 | 0,5–1 | 1–3 | 0,01 | 0,1 |
| Ti | — | — | — | — | — | 0,03–0,05 | — |
| Cr | Mbi 10 | 0,001 | 0,5–1 | Mbi 10 | Mbi 10 | Mbi 10 | — |
| Fe | Mbi 10 | Mbi 10 | »10 | »10 | 1 | 0,05 | 0,01 |
| Mg | 5 | 3–5 | 1 | 0,3 | 0,1–0,5 | 0,05 | 0,003–0,005 |
| Mn | 0,05 | 1 | 0,03 | 0,1–0,5 | 0,01–0,03 | 0,003 | 0,03 |
| Ca | 0,1 | 3–5 | 0,01 | 0,5 | 1–3 | 0,01 | 0,1 |
| Ni | 0,001 | 0,001 | 0,05 | Nën 0,001 | Nën 0,001 | — | 0,001–0,003 |
| Co | 0,001 | 0,001 | 0,005–0,01 | — | — | — | — |
| | 0,003–0,01 | 0,005 | 0,005–0,01 | 0,05 | 0,01 | 0,01 | 0,001 |
| C | Nën 0,001 | Nën 0,001 | 0,003 | Nën 0,001 | Nën 0,001 | Nën 0,001 | — |
| Zr | — | 0,003 | — | 0,001 | 0,01 | 0,05 | »10 |
| Sc | — | 0,001 | — | — | — | — | 0,001 |
| Ba | — | 0,003 | — | 0,01 | 0,01 | — | 0,05 |
| Nb | — | — | — | —0,005 | —0,03 | —0,1 | — |

Mikrofoto 1: Magnetit-titanomagnétit.




Mikrofoto 2: Kromshpinellid.



Mikrofoto 3: Granate.



Mikrofoto 4: Rutil.



Mikrofoto 5: Leukoksen.



Mikrofoto 6: Zirkon.

P E R F U N D I M E

1— Plazhi i Semanit i ka të gjitha mundësitë dhe kushtet për ripërteritjen e tij natyrore në pasurimin me minerale të dobishme të rënda, duke përfaqësuar një burim të rëndësishëm për fabrikën e pasurimit të rrerave bregdetare.

2— Pasurimi është rrjedhim i shplarjes së shkëmbinjve ultrabazikë, bazikë, metamorfikë dhe i depozitimeve sedimentare, që rrrethojnë këtë plazh. Lënda copëzore, nëpërmjet lumenjve Seman dhe Vjosë, depozitohet afër grykëderdhjeve të tyre dhe përpunohet së bashku me masën e rrerës së plazhit gjatë fryrjes së rrerave të forta. Pasurimi bëhet kryesisht në sipërfaqe në trajtë aureolash, njollash, shtresëzash e brezash të zinxh të pasura me minerale të rënda, të cilat formojnë «koncentratin natyror».

3— Masa e rrerës që mbulon këtë plazh është polimikte, me kokrrizshmëri mesatare; ndërsa nën nivelin e ujërave sipërfaqësore ajo paraqitet me kokrrizshmëri të imët.

L I T E R A T U R A

- 1— Enver Hoxha — Raport në Kongresin VII të PPSH. Shtëpia Botuese «8 Nëntori». Tiranë, 1976.
 - 2— Enver Hoxha — Përparimi i vendit është i pandarë nga zhvillimi i shkencës dhe i teknikës. Fjala e mbylljes në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH. Shtëpia Botuese «8 Nëntori». Tiranë, 1980.
 - 3— Ramiz Alia — Puna kërkimore shkencore t'i shërbejë zhvillimit aktual e perspektiv të vendit. Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbajtur në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH, Shtëpia Botuese «8 Nëntori». Tiranë, 1980.
 - 4— Cara R., Mullaj F. — Natyra, përbërja mineralogjike dhe të dhëna për rigjenerimin e plazhit të Rushkullit me minerale të rënda. Përmblehdje Studimesh, Nr. 1, 1976.
 - 5— Luli N. — Buletin shkencor natyror për studimin e lëvizjes së vijës bregdetare nga pikëpamja topografike.
 - 6— Ostrosi B. — Kërkimi i shkrifërimeve bregdetare të Adriatikut. Bul. i USHT, ser. shkenc. nat., Nr. 4. Tiranë, 1968.
 - 7— Sinoimeri Z. — Kushtet e formimit të tipeve kryesore të shkrifërimeve perspektive për vendin tonë. Bul. i USHT, ser. shkenc. nat., Nr. 2. Tiranë, 1970
- Dorëzuar në redaksi në shtator 1980.

R é s u m é

La plage de Seman, son enrichissement avec des minérais lourds, ses conditions de formation et sa composition minéralogique

Dans cet article les auteurs présentent les résultats des études effectuées et des données recueillies pendant plusieurs années en ce qui concerne la plage de Seman. Se basant sur ces données, ils aboutissent à la conclusion qu'existent toutes les prémisses et les conditions naturelles pour la régénération et l'enrichissement de cette plage avec des minéraux lourds. La nécessité de cet enrichissement découle du fait que les roches ultrabasiques, basiques, métamorphiques et les dépôts sédimentaires, qui entourent cette plage et qui l'alimentent avec des substances détritiques à travers les eaux des fleuves Seman et Vjose ont été érodés. La substance détritique se dépose dans les embouchures de ces fleuves et elle est élaborée, tout comme le sable, par les vents forts qui y soufflent.

Les auteurs relèvent que l'enrichissement a lieu uniquement à la surface et se présente sous forme d'auréoles ou de tâches noires, en couches fines et bandes noires riches de minéraux lourds. Elles constituent le «concentré naturel». L'enrichissement a lieu continuellement et surtout dans la période novembre-mars, en fonction de certaines prémisses qui prédominent dans cette zone cotière. On doit recueillir le concentré au moment même de son enrichissement et l'éloigner immédiatement de la zone enrichie afin d'éviter son retrait dans les profondeurs de la mer.

La masse de sable est polynigte, avec un granulage moyen, alors que sous les eaux superficielles elle se caractérise par un granulage plus fin.

Les principaux minéraux lourds utiles sont représentés par des chromites,

Fig. 1: Vue schématique du mode d'enrichissement de la plage de Seman.

a — Concentré déposé sous forme d'auréoles; b — bandes noires à alternances; c — sable à répartition uniforme dans la fraction lourde; d — sable pauvre de marais.

Fig. 2: Exploitation de la plage de Seman pendant la période 1973-1980, en considérant l'année 1975 comme exploitée à 100% en tonnes.

Fig. 3: Grains de titanomagnétites à bâtons d'ilmenite disposés selon la direction cristallographique.

Microphoto 1: Magnétite-titanomagnétite.

Microphoto 2: Chromites.

Microphoto 3: Grenats.

Microphoto 4: Rutile.

Microphoto 5: Leucoxène.

Microphoto 6: Zircon.

Teknologjia dhe pasurimi i mineralave të dobishme

LIDHUR ME PËRCAKTIMIN E KONDICIONIT TË PËRMBAITJES SA MË TË ULËT TË METALIT NË XEHERORËT E VARFËR TË KROMIT

Menella Hido*—

Duke u mbështetur në të dhënrat e studimeve të kryera dhe në përvojën e grumbulluar në vendin tonë në pasurimin e kromiteve, jepen mendime për mundësinë e uljes më tej të përmbajtjes së Cr_2O_3 në sterilet dhe, si rrjedhim, për uljen e kondicionit në zbulimin e rezervave shumë të varfëra, me më shumë se 10 për qind Cr_2O_3 .

Zhvillimi i vrullshëm i industriisë nxjerrëse e përpunuese të minraleve të dobishme gjatë këtyre 37 vjetëve të pushtetit populor është shoqëruar edhe me thellimin e vazhdueshëm të studimeve për zgjidhjen e problemeve të shfrytëzimit racional të rezervave minerale, falë luftës dhe përpjekjeve për të vënë një jetë direktivat e Partisë dhe mësimet e shokut Enver Hoxha.

Tanimë është bërë shumë i rëndësishëm problemi i studimit dhe i përcaktimit të kondicioneve më të ulta, me leverdi më të madhe ekonomike, duke përfshirë xehlerorët që u nënshtrohen proceseve të pasurimit, siç janë sidomos ato të kromiteve dhe të bakrit sulfuror. Këto kondicione u detyrohen kryesisht faktorëve tekniko -tekhnologjikë dhe ekonomikë dhe ndryshojnë krahas me shkallën e përpunimit të xehlerorëve deri në prodhimin e gatshëm, i cili mund të jetë koncentrat, si për rastin e kromiteve, ose metal, për xehlerorët e bakrit. Studimet e deritanishme janë përqëndruar në xehlerorët e kromit. Për kryerjen e provave eksperimentale janë përdorur xehlerorë nga rajoni i Bulqizës, prandaj në këtë artikull paraqesim rezultatet që u përkasin xehlerorëve të varfër të kromit të këtij rajoni.

Dihet se në fazën e zbulimit gjeologjik shpesh lihen jashtë lloga-

* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave i Universitetit të Tiranës.

ritjes së rezervave industriale trupa e zona të mineralizuara me përmajtje të Cr_2O_3 më të ulët se kondicioni i pranuar. Mirëpo kondicionet pësojnë herëpashere ndryshime në përputhje me kushtet e nxjerrje — përpunimit dhe koniukturat e tregut ndërkombe tar. Prandaj ato studihohen vazdimisht dhe, në përgjithësi pësojnë ulje, për të shfrytëzuar sa më racionalist rezervat e kromiteve, të cilat kanë rëndësi të veçantë për ekonominë tonë popullore.

DISA TË DHËNA NGA PËRVOJA DHE EKSPERIMENTIMET E KRYERA

Studimi dhe përcaktimi i kondicionit të kromiteve të varfëra kryhet duke u mbështetur në përvojën e grumbulluar nga minierat e fabrikat si dhe nga eksperimentet laboratorike të pasurimit.

Kështu, përvoja e grumbulluar nga fabrikat e pasurimit të kromiteve në Bulqizë e Kalimash, si dhe rezultatet e studimeve të kryera në vendin tonë me lloje të ndryshme xehororësh (1, 2) kanë vërtetuar se, nëpërmjet pasurimit të tyre, nxirren koncentrate me përmajtje më shumë se 48 - 50 % Cr_2O_3 , pavarësisht nga përmajtja e metalit në lëndën e parë. Nga ana tjetër gjatë viteve të fundit në fabrikën e pasurimit në Bulqizë u vu re pak a shumë një rritje e treguesit të rikuperimit dhe pse cilësia e lëndës së parë pësoi ulje. Kjo gjë i kushtohet kryesisht përmirësimi të punës së punonjësve për të zvogëluar përmajtjen e Cr_2O_3 në sterilet e dambës; në masën nga 13 - 14 % që ishte në fillim, në 10-11 % në periudhën e fundit. Këto rezultate do të kishin qenë edhe më të larta po të ishte kryer bluarja e xehororit deri në imtësinë e kërkuar nga natyra e kromiteve të përpunuara.

Kjo përvojë e mirë e punonjësve të fabrikave tona përputhet me kriteret shkencore të vartësive të ndërsjellta midis treguesëve kryesorë teknologjikë, të cilët gjenden duke zgjidhur, më të dhëna faktike varësitë e njohura $\epsilon = f(\alpha)$, $v = f(\alpha)$ dhe $\epsilon = f(\beta)$. Ky problem është pikësynimi i punës përgjithësuese që po bëhet në këtë drejtim.

Në kushtet teknologjike të fabrikave tona të pasurimit, duke pasur parasysh sidomos rezultatet e viteve të fundit gjatë të cilëve në periudha të caktuara janë përpunuar xehororë të varfër e shumë të varfër, siç ka se krahas me zvogëlinin epërmbrasjes së Cr_2O_3 në lëndën e parë (α) se krahas me zvogëlinin epërmbrasjes së Cr_2O_3 në lëndën e parë (α) se pëson ulje edhe përmajtja e metalit në sterilet (v), gjë që vjen për shkak të rritjes së sasisë të këtyre sterileve

Këto të dhëna e përfundime mbështeten edhe nga rezultatet e studimeve të kryera vite më parë (2, 3) me xehororë të varfër të vendburimeve Bulqizë — Batrës e të Kalimashit. Nga këto studime ka dalë në pah se përmajtja e Cr_2O_3 në sterilet mund të ulet në 4-5 %, po që se xehororët trajtohen rregullisht, sipas natyrës e ndërtimit të tyre. Gjithashtu, nxjerrja e sterileve të varfëra vërtetohet edhe nga të dhënat e literaturës (5, 7) siç janë rastet në mjaft fabrika pasurimi, që përurojnë kromite në 20-25 % Cr_2O_3 dhe që nxjerrin sterile me 4-6 % Cr_2O_3 .

Në këtë drejtim synojnë edhe studimet dhe eksperimentimet e kryera kohët e fundit (4) në disa xehororë të varfër të Bulqizës, që janë dhënë nga miniera e kromit.

Vemë në dukje se gjatë eksperimentimeve të kryera u zbatua një skemë teknologjike afërsisht e njëjtë me skemat e studimeve të mëparshme, e cila përfshin klasifikimin paraprak të xehororit të bluar me imtësi më pak se 0.63 dhe pasurimin e veçantë sipas klasave në makinat e sedimentimit dhe në tavolinat e koncentrimit. Këto studime për xehororët e varfër ($\alpha = 15-17 \% \text{ Cr}_2\text{O}_3$) kishin për qëllim nxjerrjen nga procesi të sterileve sa më të varfëra, duke filluar nga thërimimi i imët në më pak se 5 ose 2 mm deri te bluarja me imtësi e kërkuar.

Në bazën e eksperimenteve të kryera¹⁾ doli përfundimi se nga pasurimi i xehororëve të tillë, nuk mund të pritet nxjerrja e sterileve ose e koncentratit të pastërt qysh në thërmimet e imta, prandaj veçimi i tyre duhet bërë pas bluarjes përkatëse. Nga ana tjetër, në të gjitha rastet doli në pah problemi i shllameve për nga sasia e ndjeshme që kanë; kurse cilësia e tyre është pak a shumë më e ulët se ajo që ka dalë në fabrikat e pasurimit ose në studimet e mëparshme. Megjithëkëtë, këto shllame mund dhe duhen pasuruar në aparatura të veçanta, për të arritur tregues të lartë dhe për të mënjanuar një pjesë të mirë të humbjeve të metalit që rrjedhin prej tyre. Përvoja ka vërtetuar (5, 8) se pasurimi efektiv i këtyre shllameve, me grimca kryesisht më të imta se 0,07 mm, realizohet duke përdorur skema të gërshetuara aparaturash të tilla hidrociklon-tavolinash të qeta (shluz) — tavolinash koncentrimi për të nxjerrë koncentrate të pasura dhe sterile dambe me përmajtje të ulët metali, zakonisht sa gjysma e përmajtjes së tij në shllamet parësore. Një skemë e tillë mund të eksperimentohet e të zbatohet për çdo rast konkret, siç është vepruar në disa studime të kryera më parë në vendin tonë (1,5). Përveç kësaj për shllamet e xehororëve të pasur është e njohur edhe skema e flotinit (5), mirëpo kjo përligjet ekonomikisht vetëm në raste të caktuara.

Në përfundim të studimeve të kryera themi se, nga pasurimi i xehororëve të varfër me 15 - 17 % Cr_2O_3 u arrit marrja e sterileve me përmajtje 3.5 - 4 % Cr_2O_3 . Në këtë mënyrë, u vërtetua edhe një herë se krahas me zvogëlimin e α pëson ulje të ndjeshme edhe « v », kurse β mbetet pothuajse e njëjtë. Prej këtej del se, nga përpunimi i xehororëve më të varfër për shembull me 10 - 12 % Cr_2O_3 veçohen sterile edhe më të varfëra se sa sterilet që dolën nga eksperimentimi i përmendor.

Për këto arësy, është me vend, që si një nga treguesit më kryesorë teknologjikë të pranohet cilësia e sterileve v meqenëse ulja e saj në përputhje me përmajtjen e lëndës së parë (α), siguron tregues të lartë rikuperimi. Kështu themi me bindje se niveli i cilësisë së sterileve shpreh drejtëpërdrejtë kujdesin e punonjësve për zbatimin e regjimit teknologjik në përshtatje me lëndën e parë që përpunohet.

Të dhënat e mësipërme eksperimentale mund të arrihen me përafërsi edhe në fabrikat e pasurimit, mjaftron që procesi teknologjik të sığurojë një imtësi përfundimtare të bluarjes në përputhje me natyrën e çdo lloji të xehororit. Përvoja e grumbulluar në vendin tonë vërteton

¹⁾ Eksperimentet laboratorike të pasurimit u kryen me pjesëmarrien e K. Fetahut dhe A. Kastratit.

se, në përgjithësi, kjo imtësi optimale luhatet në kufijtë $0.5 - 0.3$ mm, gjë që i përgjigjet një shkalle optimale të zërthimit të pikëzimeve minerale. Rruga teknologjike e përvijezuar më lart siguron nxjerrjen e sterileve sa më të varfëra dhe që, tani për tani, mund të pranohen si të përshtatshme për tu depozituar. Kështu që nxjerja e sterileve me $3.5 \pm 4.0\%$ Cr_2O_3 , duhet marrë si një synim i mundshëm kohor për pasurimin e xeherorëve shumë të varfër. Ky përfundim mbështetet edhe nga fakti i vërtetuar për ndërtimin e kromiteve të vendit tonë, se varfërimi i xeherorit të kromit është rezultat kresqist i rrallimit të pikëzimeve minerale në njësinë vëllimore, ndërsa zgogëlimi i përmasave mesatare është mjaft i kuftuar në xeherorët shumë të varfër.

Llogaritja e kondicionit me vlerë të leverdissime.

Mbi bazën e të dhënave dhe të bindjeve të përmendura më lart mund të përcaktohet edhe kondicioni me vlerë më të leverdissime i përbajtjes së Cr_2O_3 në kromitet (α min) që mund të pasurohen në fabrikat e vendit tonë. Llogaritja e këtij kondicioni (7) mbështetet në koston e 1 ton koncentratit (K_k), që del nga përpunimi i një xeherori të caktuar, duke pasur parasysh se për çdo ton të këtij xeherori kryhen shpenzime të njëjtë përpunimin (K_m), pavarësisht nga cilësia e tij. Nga ana tjeter, kostoja e koncentratit lëvis në varësi të përbajtjes së Cr_2O_3 në prodhimet e pasurimit dhe të kostos së përpunimit të xeherorit. Prandaj pranojmë se:

$$K_k = \frac{100}{\gamma_k} K_m; \text{ku: } \gamma_k = \frac{(\alpha - v)}{(\beta + v)} 100; \text{ prej këndejej del se: } K_k = \frac{(\beta - v)}{(\alpha - v)} K_m$$

Nga ky barazim del se sa më i varfër të jetë xeherori, pra sa më e vogël të jetë vlera e α , aq më e lartë është kostoja e koncentratit.

Duke u nisur nga kjo, themi se përbajtja minimale e leverdissime e Cr_2O_3 në xeherorët (α min) është ajo vlerë më e ulët e α , që bën të barabartë koston e koncentratit me çmimin e shitjes ose me vlerën e koncentratit V_k :

Në vijim të barazimit të mësipërm, duke zëvëndësuar $K_k = V_k$ dhe $\alpha = \alpha$ min, nxjerrim se:

$$\alpha_{\min} = \frac{(\beta - v)}{V_k} + v;$$

ku: β – % Cr_2O_3 në koncentrat;
 v – % Cr_2O_3 në sterilet.

Të dhënat e nxjerra nga përvoja dhe nga studimet teknologjike të kryera, vërtetojmë se si cilësi e koncentratit për këto raste mund të pranohet $\beta = 48 - 50\%$ Cr_2O_3 (mesatarisht 49 %); kurse sterilet duhet të jenë me $v = 4\%$ Cr_2O_3 . Po të pranojmë se kostoja e përpunimit e realizuar për vitin 1977 – 1979 në fabrikën e Bulqizës është në nivelin e dhënë ($K_m = 1,21$ lekë/ton) dhe se vlera e koncentratit mund të merret mesatarisht 862 lekë/ton, atëherë me llogaritje nxjerrim se:

$$\alpha \text{ min} > 10.2\% \text{ Cr}_2\text{O}_3.$$

Prej këtej arrijmë në përfundimin me leverdi ekonomike mund t'i nënshtron pasurimit xeherorët e kromit të varfër me më tepër se

10 % Cr_2O_3 . Mirëpo ky kondicion, siç duket qartë edhe nga barazimi i mësipërm, varet nga disa faktorë, të cilët, në përgjithësi, ndikojnë përmirë në uljen e mëtejshme të α min. Kështu në të ardhshmen, krahas me rritjen e kapaciteteve prodhuase të minierave e të fabrikave dhe krahas me rritjen e rendimentit të punës do të ulet edhe kostoja e përpunimit të xeherorit (K_m), në të cilën përfshihen shpenzimet për nxjerrjen dhe për pasurimin e një ton xeherori. Nga ana tjeter, do të përmirësohen pandërprerje treguesit teknologjikë; kurse vlera e koncentratit (V_k) do të shkojë në rritje, paralelisht me koniukturat kohore të tregut botëror. Prandaj, themi se kondicioni i mësipërm jo vetëm paraqitet i qëndrueshmë, por madje anon në drejtim të uljes:

P E R F U N D I M E

1 – Kondicioni ekzistues i kategorizimit të rezervave industriale mendojmë se duhet të zbritet, duke pranuar si kufi të ri më të ulët vlerën prej 10 % Cr_2O_3 për rajonin krommbartës Bulqizë – Batëri si dhe për rajonet e zonat e tjera. Në këtë mënyrë do të rriten rezervat industriale të kromiteve.

2 – Për natyrën që kanë xeherorët e varfër të vendit tonë dhe përmundësitet e krijuara në fabrikat tonë të pasurimit, teknikisht dhe ekonomikisht mund të kërkohet që nga pasurimi i këtyre kromiteve të dalin sterile me $v = 4 \div 5\%$ Cr_2O_3 , për të siguruar një rikuperim të lartë të metalit edhe nga xeherorë shumë të varfër. Kusht themelor për këtë kërkesë është: kryerja e bluarjes në dy shkallë, deri në imtësinë me përmasa më të vogla se 0.3 (0.5) m/m si dhe pasurimi i veçantë i shllameve me imtësi kokrrizash më të vogla se 0.07 – 0.05 mm. Për çdo rajon konkret të zbuluar, ky problem përcaktohet nëpërmjet studimeve plotësuese përkatëse.

3 – Në këto kushte, në një të ardhme të afërt, del e leverdissime, madje më mirë se për xeherorë fillestarë, që të rikthehen e të pasurohen në fabrikën e Bulqizës sterilet e dambës me $12 \div 14\%$ Cr_2O_3 , menjëse, prej tyre mund të rikuperohet një sasi e konsiderueshme e koncentratit.

L I T E R A T U R A

- 1– Hido M. Studimi teknologjik i pasurimit të kromit të vendburimit të Kalimashit – 2. Tiranë, 1964 – 1965.
- 2– Hido M. Pasurimi i kromiteve të vendburimit të Kalimashit. Përbledhje Studimesh, Nr. 1, 1965.
- 3.– Hido M. Studime plotësuese për pasurimin e disa lloje kromitesh të rajoneve të Bulqizës e të Kalimashit. Tiranë, 1966-1967.
- 4.– Hido M., Fetahu K. Studimi paraprak i mundësise së pasurimit të kromiteve shumë të varfëra në Bulqizë. Tiranë, 1980.
- 5– Pasurimi i xeherorëve të kromit në Jugosllavi Gorni Zhurnall, Nr. 3, 1973.
- 6– Stefani M. etj. Projekti teknologjik i fabrikës së pasurimit Kalimash. Tiranë 1970.

- 7—Stepinski W. Ekonomike procesov wzbogacania. 1961.
 8—Pasurimi i kromiteve të varfëra. Rept. Investing. Byr. Mines. 1964.
*Dorëzuar në Redaksi
në Korrik 1980.*

Résumé

A propos de la détermination de la condition de teneur minimale du métal dans les minerais de chrome pauvres

Dans cet article il est question des résultats de l'expérience accumulée pendant l'enrichissement des chromites, ainsi que les études effectuées chez nous dans ce domaine. On y tire aussi des conclusions en rapport à la dépendance réciproque qui existe entre les indices technologiques. Les données obtenues indiquent que la qualité des déblais de l'enrichissement peut être ultérieurement abaissée pour les minerais pauvres et atteindre les 4-5% de Cr₂O₃. A cette fin, il est indispensable de broyer les minerais à une finesse inférieure à 0.3 (0.5) mm., en fonction de leur nature, et de maintenir aussi les schémas et les régimes optimaux dans le traitement des minerais et particulièrement des déblais ayant des grains d'une finesse inférieure 0.07 mm.

Sur la base des indices technologiques réalisables, on peut calculer la condition minimale d'avantage économique pour les minerais pauvres du chrome susceptibles d'être enrichis. Compte tenu du coût actuel de l'élaboration et de la valeur du concentré de chrome, on aboutit à la conclusion que les minerais pauvres, contenant plus de 10% de Cr₂O₃, doivent faire l'objet des prospections du service géologique, puisque leur enrichissement, dans les conditions étudiées, se présente avantageuse surtout dans la conjoncture actuelle et la perspective d'avenir de ce produit important.

L'auteur a tiré aussi des conclusions sur la nature et la structure des minerais du chrome, les indices technologiques obtenus et les mesures requises pour une nouvelle élaboration des déblais extraits dans les années précédentes. De la sorte, la base des réserves de ce minéral s'élargit et l'on peut obtenir sa meilleure valorisation à travers le processus d'enrichissement.

RUBRIKA E DISKUTIMEVE**Kimi analitika**

SAKTËSIME TË DISA REKOMANDIMEVE TË DHËNA PËR KONTROLLIN E GABIMIT SISTEMATIK TË ANALIZAVE

— Niko Nosi* —

Vihen në dukje disa kushte të tjera, që duhet të plotësohen, me qëllim që rekandimet e dhëna në një artikull të botuar më parë (3) të zbatohen më saktësisht. Vec kësaj, janë formuluar rishtas disa pohime dhe tregohen se fusha e zbatimit të këtyre rekandimeve, kur plotësohen të gjitha kushtet, është edhe më e gjërë.

Në një artikull të botuar vitin e kaluar në «Përbledhje Studimesh» (3) bëhen përpjekje për të treguar rrugët e zbulimit të gabimit sistematik në analizat e përbërësit të dobishëm dhe të korrektimit të gabimit, pas zbulimit. Qysh në fillim të artikullit pohohet se «gabimi sistematik mund të shmanget tërësisht». Në fund, në përfundimet, thuhet se «gabimi sistematik, nëqoftëse është i pranishëm, mund të zbulohet gjithmonë duke rritur në një masë të caktuar numrin e analizave të kontrollit». Gjatë llogaritjeve, për gabimet e analizës pranohet se «shpërndarja është normale», duke pohuar se shpërndarje normale është rasti që «ndodh përgjithësisht».

Autori e shtron problemin, në thelb për gabime sistematike sado të vogla dhe për zhdukjen e tyre tërësore (dhe jo për zvogëlimin e ndikimit të tyre).

Mendojmë se fusha e zbatimit të rekandimeve të dhëna në këtë artikull (3) është më e gjérë. Ato mund të përdoren jo vetëm për analizën e përbërësit të dobishëm, por edhe për analizën e çdo elementi ki-

* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave i Universitetit të Tiranës.

mik, që vlen drejtëpërdrejtë ose têrthorazi (për shembull si indikator gjeokimik) pér kërkimet gjeologjike. Madje rekomandimet në fjalë mund të zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe pér saktësimin e matjes së madhësive fizike, që karakterizojnë veti të mineraleve e të shkëmbinjve, si pér shembull dendësia, mikrofortësia, treguesit e pasqyrimit e të thyerjes së dritës, etj. si dhe në fusha të tjera.

Si matjet, ashtu edhe analizat, kryhen në kushte nga më të ndryshmet, të cilat përgjithësisht, dallohen shumë nga njëra metodikë në tjetrën. Prandaj pér të karakterizuar shpërndarjen e përfundimeve të matjeve e të analizave (rrjedhimisht edhe të gabimeve përkatëse), në çdo rast konkret, me një koeficient sigurie, pranohet njëri nga ligjet e mundëshme të shpërndarjes. Në këtë zgjedhje mbahet medoemos parasysh edhe përdorimi që do të kenë matjet ose analizat e kryera. Nuk mund të thuhet asnjëherë me siguri të plotë se ligji i shpërndarjes është i tillë ose i atillë, megenëse vërtetëmi lidhet çdoherë me vlera të rastit të matura eksperimentalisht. Veç kësaj, pér analizat dhe pér matjet e madhësive pozitive, sic është rasti tek artikulli i përmendor (3), nuk mund të thuhet se «shpërndarja është normale», edhe sepse gabimi përfshihet në kufitë $+a$, $+ \infty$ dhe jo në kufitë $- \infty, + \infty$, sic duhet të ndodhë kur shpërndarja është normale (2). Pra, do të qe më e saktë sikur në (3) të thuhej se «Ne do të shohim rastin kur shpërndarja e vlerave të gabimeve mund të përafrohet me një shkallë të mjaftueshme sigurie me atë normale».

Për problemin në se, në shumicën e rasteve, mund të arrihet apo jo ky përafrim në fushën e analizave të përbërësit të dobishëm, në literaturë gjënden mendime jo të favorshme (1, 2). Në kushtet e vendit tónë, shumica e analizave të përbërjes së lëndës kryhen me metodën e analizës spektrale gjysëmsasiore të lëshimit atomik, pér të cilën është treguar se si shpërndarja më e pranueshme është ajo lognormale (4). Për këtë rast, janë diskutuar (5, 7) në mënyrë paraprake edhe problemi i rrugëve të kontrollit të shmangjeve dhe të gabimeve sistematike si dhe mundësia e zbutjes së ndikimit pér të keq, që sjellin këto gabime në saktësinë e analizës e të interpretimeve gjeokimike.

Në artikullin e përmendor më sipër (3), gjatë veprimeve të kryera pér të arritur në formulat që duhet të përdoren pér zbulimin dhe korrektimin e gabimit sistematik, ëshë ndjekur një rrugë krahasuse, meqenëse është nënkuptuar se ekziston një metodë e dytë e analizës që nuk përmban gabim sistematik, me të cilën mund të rianalizohen mostrat që kanë qenë analizuar fillimisht me metodën që kontrollohet. Nënkuptimi pér ekzistencën e një metodike të tillë nuk është i lejueshëm, sepse nuk ka ndonjë rrugë të drejtëpërdrejtë (dhe jo krahasuese) praktikisht të realizueshme, me anë të së cilës të vërtetohet me siguri të plotë mungesa e qdo lloji të gabimit sistematik të saj, sado i vogël qoftë. Pra mungon baza eksperimentale pér zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga autori, në atë formë që paraqitet prej tij. Prej këtej rrjetëdhim dy kufizime në zbatimin e këtyre rekomandimeve:

Së pari, edhe sikur metodika krahasuese të mos ketë gabim sistematik, gabimi sistematik i metodikës që kontollohet nuk mund të «shmangjet têrësisht», sepse ai nuk mund të zbulohet dot têrësisht. Në të vërtetë, sic e pranon edhe vetë autor, gabimi sistematik nuk mund të zbulohet kur madhësia e tij kufizohet në intervalin që jepet me mos-

barazimin. 18. Numri i analizave paralele të kontrollit mund të merret shumë i madh, por jo i pafundëm prandaj ky interval nuk mund të zhduket. Kur vlera e gabimit sistematik del jashtë këtij intervallit, përsëri ai nuk mund të «shmangjet têrësisht» sepse, sic del edhe nga arsyetimet e autorit, megjithëse vërtetohet prania e gabimit sistematik, në vend të vlerës së saktë «d» të modulit të tij, gjendet vetëm një vlerësim jo i zhvendosur «d». Meqenëse «d» është gërshtim linear i madhësive të rastit X dhe y , atëherë edhe vetë vlera e saj është madhësi e rastit (-6) dhe objektivisht do të përcaktohet me një farë gabimi. Pra edhe në kushtet ideale të zgjedhura nga autori (kur metodika kontrolluese nuk ka gabim sistematik), pohimi pér mundësinë e shmangies «têrësore» të gabimit sistematik të metodikës që kontollohet nuk qëndron.

Së dyti, po të pranojmë se metodika kontrolluese përmban gabim sistematik të panjohur, çka në praktikë është e pashmangshme, duhet pranuar se, në rastin e përgjithshëm, rekomandimet e dhëna (3) pér gabimin sistematik të metodikës që kontollohet, janë të vlefshme po të flitet jo pér gabim sistematik, por pér shmangje sistematike të përfundimeve të arritura në metodikën që kontollohet nga të arriturat me metodikën kontrolluese. Verifikimi i hipotezës pér praninë e kësaj shmangje mund të bëhet me cilëndo nga të të tre rrugët që propozohen (3) pér zbulimin e gabimit sistematik. Megjithatë, edhe pér të nxjerrë në pah shmangjet sistematike, ekzistojnë po ato kufizime si edhe pér të nxjerrë në pah gabimin sistematik në rastin ideal: Ajo nuk mund të vihet në dukje kur është aq e vogël sa që kufizohet në intervalin (18), ose mund të nxirret në pah vetëm me afersi kur ka vlera që del jashtë atij intervali (11).

Kushtet që jepen në (3), janë të mjaftueshme pér të nxjerrë në pah dhe korrektimin e shmangies sistematike të përfundimeve të dy metodikave, të metodikës së kontrolluarë dhe të metodikës kontrolluese.

Për të kaluar prej këtej në vlerësimin dhe në korrektimin e gabimit sistematik të metodikës që kontollohet, duhet të plotësohen edhe kushte të tjera:

a — Të përcaktohet një kufi i sipërm i modulit të gabimit sistematik të metodikës kontrolluese; kjo mund të arrihet vetëm me rrugë të drejtë përdrejtë matematiko - eksperimentale, e cila, në thelb, është e ndryshme nga rruga e treguar në (3) pér nxjerrjen në pah dhe pér korrektimin e shmangies sistematike. Me këtë rast themi se vetëm mundësia praktike pér këtë ekziston, pa hyrë në imtësi të cilat nuk janë të pakta.

b — Në rrugë matematiko - eksperimentale duhet të vërtetohet hipoteza se moduli i shmangies sistematike të përfundimeve të arritura me metodikën që kontollohet dhe me atë kontrolluese e kalon kufirin e sipërm të modulit të metodikës kontrolluese. Po u plotësua edhe kjo, atëherë shmangjen sistematike të përfundimeve të të dyja metodikave mund t'a quajmë si gabim sistematik të metodikës që kontollohet, dhe më pas, ky gabim të korrektohet në rrugën e treguar në (3). Sa më i vogël është kufiri i sipërm i modulit të gabimit sistematik të metodikës

1) Në të gjitha arsyetimet tonë, ashtu si dhe në (3), keimi parasyshë një koeficient të caktuar sigurie dhe një numër të caktuar analizash kontrolli, pér ndryshe nga ç'vprohet në (3), këtë numër e pranojmë vetëm të fundmë.

kontrolluese, aq më i mundëshëm është që të lejohet vendosja e shenjës së barazimit midis shmangies sistematike dhe gabimit sistematik të metodikës që kontrollohet; pra, që të përdoren korrektimet dhe nomograma e propozuar në (3). Sa më shumë të kalojë moduli i shmangies sistematike kufirin e sipërm të modulit të gabimit sistematik të metodikës kontrolluese, aq më i vogël është gabimi që bëhet duke e vendosur shenjën e barazimit midis shmangies sistematike dhe gabimit sistematik të metodikës që kontollohet dhe aq më të vlefshme janë korrektimet dhe nomograma e propozuar në (3).

Në lidhje me pohimin se «gabimi sistematik mund të shmanget tërësisht», themi se si nuk është shfrytëzuar nga autori për nxjerrjen e formulave të rekomanduara, pra nuk cënon këto formula. Për t'iu shmangur krijimit të bindjeve të gabuara tek analizuesi, mendojmë se, në vend të tij, mund të vendoset pohimi: «Duke zbritur (algjebrikisht) nga përfundimet e analizës vlerën e gjetur për gabimin sistematik, fitojmë vlera të reja, për të cilat probabiliteti, që të jenë më afër përqëndrimeve të vërteta, është më i madh».

PERFUNDIME

1 — Në përdorimin e nomogramës së propozuar në (3) më drejt duhet kuptuar shmangia sistematike midis përfundimeve të arritura me metodikën që kontollohet dhe me atë kontrolluese.

2 — Shmangia sistematike midis përfundimeve të dy metodikave mund të merret si gabim sistematik i metodikës që kontollohet vetëm po të plotësohen edhe kushtet e renditura në diskutimet e mësipërme.

3 — Në këtë rast, shfrytëzimi i faktorit korrektues «K», që tek (3) jepet në formulën 23, siguron pëmirësimin e saktësisë së analizave, madje në një rrugë mjaft të thjeshtë, prandaj duhet të përdoret në laboratoret tonë që kryejnë matje dhe analiza.

LITERATURA

- 1— Clancey V.J. — Statistical methods in chemical analyses. Nature, 159, No 4036, 339-340, 1947.
- 2— Nalimov V.V. — The application of mathematical statistica to chemical analysis. Addison-Wesly Publ. Comp, Reading, Massachusetts, 1963.
- 3— Ninka I. — Kontrolli i gabimit sistematik në analizat e përbërësit të dobishëm. Përbledhje Studimesh, Nr. 4, 1980.
- 4— Nosi N. — Lidhur me ligjin e shpërndarjes së përfundimeve të analizave spektrale gjysëmsasiore të mostrave gjeologjike. Përbledhje Studimesh, Nr. 1, 1980.
- 5— Nosi N. — Kontrolli i ruajtjes së saktësisë së analizave spektrale gjysëmsasiore. Teknika, Nr. 3, Tiranë, 1980.
- 6— Ruseti B. — Teoria e probabilitetit dhe statistika matematike. Botim i U. T. Tiranë, 1975.
- 7— Vllaho J., Nosi N. — Njohja e saktësisë së analizës dhe rëndësia e saj përpunimin dhe për interpretimin e punimeve gjeokimike të kërkimit. Përbledhje Studimesh, Nr. 3, 1980.

Résumé

L'exactitude de certaines recommandations données à propos du contrôle de l'erreur systématique des analyses

Dans cet article il est question de certaines recommandations et affirmations figurant dans un autre article publié l'année passée (3) et portant le titre «Le contrôle de l'erreur systématique dans les analyses du composant utile». On y expose aussi d'autres conditions à remplir en vue de parfaire l'exécution de ces recommandations, ainsi que des formulations nouvelles et plus précises des affirmations faites précédemment. On indique également que le champ d'application de ces recommandations est plus large, lorsque toutes les conditions requises sont satisfaites.

Kronika jomë

SHËRBIMI GJEOLOGJIK I NAFTËS NË 30-VJETORIN E KRIJIMIT TË TIJ

— Servet Pasho* —

Në këtë vit entuziazmi dhe mobilizimi të madh revolucionar të 40-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme të Punës dhe të Kongresit të 8-të historik të saj, naftëtarët tanë heroikë kremluan me gjërim 30-vjetorin e krijimit të shërbimit gjeologjik të naftës.

Tridhjetë vjet më parë, në shtator të vitit 1951, u krijua për herë të parë në vendin tonë shërbimi gjeologjik i naftës. Ai u ngrit pranë Kombinatit të Naftës dhe ndërmarrjeve që vareshin prej tij. Në atë kohë përbëhishë disa gjeologë të rinj me arsim të mesëm, që sapo kishin mbaruar shkollën e mesme «17 Nëntori» në Tiranë; po ashtu përbëhej nga disa të rinj e të reja të tjera, që punonin si laborantë, kolektore, dokumentues, dësenjatorë si dhe fare pak specialistë të lartë.

Shërbimi gjeologjik i naftës, ashtu si edhe shërbimi teknik, ndonëse shumë i ri dhe me mungesë të theksuar përvoste për sektorin e naftës, bëri hapë të shpejt-

ta përpara për ngritjen profesionale, me qëllim që t'u përgjigjej në kohë e me cilësi të mirë detyrave shumë të rëndësishme që i kishte vënë Partia për kërkim-zbulim-shfrytëzimin e naftës e të gazit.

Nën udhëheqjen dhe kujdesin atëror të Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, shërbimi gjeologjik i naftës, ashtu si tërë sektorët e tjerë të kësaj dege të për të rëndësishme të industrisë sonë socialiste, nga dita në ditë e nga muaji në muaj erdhi duke urritur dhe duke u bërë më i aftë për t'iu përgjigjur më së miri kërkeseve gjithmonë në rritje për naftë e gaz. Falë njës pune këmbëngulëse e plotë pasion, shërbimi gjeologjik i ndërmarrjeve të shpimit e të prodhimit bëri që fushat tona naftëgazmbartëse të Qytetit Stalin e të Patosit të zgjeroeshin shumë dhe, si rrjedhim, të rritej perspektiva e tyre, gjë që solli edhe rritjen e prodhimit të naftës e të gazit me hapa të shpejta e të sigurta. Duke

* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave i Universitetit të Tiranës.

vënë në jetë orientimet e drejta të Partisë dhe mësimet largpamëse të shokut Enver Hoxha përkërkim-zbulimin e naftës e të gazit, naftëtarët tanë bënë që të rritë vazhdimisht sipërfaqja naftegazmbartëse e Patosit. Njëkohësisht, duke u mbështetur në përgjithësime shkencore, në këtë vendburim të rëndësishëm u arrit të zbulohen për herë të parë edhe shtratime të reja naftëgazmbartëse të panjohura deri në atë kohë. Këto rezultate të kënaqshme ishin fryt i një mobilitizimi shumë të madh të punonjësve të shërbimit gjeologjik, të krijuar e të drejtuar me largpamësi nga Partia dhe shoku Enver Hoxha, ishin fryt i porosive dhe i ndihmës së vazhdueshme të saj për naftën, në përgjithësi, dhe për kërkimet gjeologjike, në veçanti.

Tashmë shërbimi gjeologjik i naftës ishte organizuar jo vetëm në Kombinatin e Naftës, por edhe në ndërmarrjet e shpimit e të prodhimit. Përveç tyre, ishin ngritur shërbime gjeologjike pranë sektorëve të prodhimit si dhe pranë puseve të shpimit e të përvetësimit. Ai ishte fuqizuar sidomos pranë çdo pusi kërkimor.

Megjithëse gama e studimeve gjeologjike, që kryhej në ndërmarrjet e shpimit e të prodhimit ishte e vogël dhe jo me nivelin e duhur shkencor, duhet vënë në dukje lufta e madhe që bënte atëherë ky shërbim gjeologjik i spongritur për të zbatuar rregulloret gjeologjike, disiplinën shkencore, për të zbatuar një shfrytëzim sa më racional të puseve të shfrytëzimit, për të grumbulluar të gjitha të dhënat dhe provat për analiza në puset e kërkimit e të zbulimit, me qëllim që prej tyre të nxirreshin përfundime e rekondimë sa më të drejta e sa më shkencore.

Falë punës së bërë, u arrit që në muajin qershor 1957, nëpërmjet pusit të kërkimit numër 542, të zbulohet vendburimi i madh i Marinzës, i cili ishte një sukses shumë i rëndësishëm në ato vite për ekonominë populllore. Zbulimi i tij solli ndryshime të theksuara në tërë sistemin e naftës. Në radhë të parë, vërtetoi parashikimin e Partisë sonë të lavdishme dhe personalisht të shokut Enver Hoxha se vendi ynë ka rezerva të konsiderueshme nafte e gazi, që duheshin kërkuar e zbuluar.

Pas zbulimit të vendburimit të Marinzës, punimet komplekse gjeologo-gjeofizike si dhe shpim-kërkimet morën një përhapje të vrullshme. Shërbimi gjeologjik i naftës tanë ishte zgjeruar shumë dhe bënte një punë më të kualifikuar, duke u mbështetur jo vetëm në vrojtime fushore, por edhe në përgjithësime e analizë të ndryshme shkencore e laboratorike. Nevoja e rritjes dhe e fuqizimit të shërbimit gjeologjik të naftës lindi si një domosdoshmëri urgjente. Prandaj Partia dhe personalisht shoku Enver Hoxha treguan një kujdes të posaçëm për studimet gjeologjike e sidomos për ato që lidheshin me kërkimet. Gjatë viteve 1951-1960 shërbimi gjeologjik i naftës u zgjerua me mjaft specialistë të lartë të diplomuar në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit të Tiranës, të cilët e çuan edhe më përpara punën në kërkimet gjeologjike, dhe në prodhimin e naftës e të gazit. Tanimë u rrit mjaft gama e studimeve gjeologo-gjeofizike. Po kështu, u ndërmorën studime të thelliara në lëmin e stratigrafisë, të paleontologjisë e të petrografisë së depozitimeve terrigjene miockenike; u ndërmorën tematika

studimore edhe për depozitimët më të vjetra, si për flishin paleogjenik dhe për gëlqerorët mesozoikë. Këto studime si edhe studime të tjera, që u kryen më pas, çuan në zbulimin e vendburimeve të reja të naftës e të gazit në vitet e mëvonshme.

Një sukses shumë i rëndësishëm i shërbimit gjeologjik të naftës, të udhëhequr me mënçuri e urtësi nga Partia e shoku Enver Hoxha, ishte zbulimi për herë të parë i naftës në shkëmbinjtë gëlqerorë, i cili në vitin 1962 u konkretizua me vendburimin e Visokës. Gjetja e naftës në gëlqerorët ishte rezultat i këmbënguljes së gjeologëve tanë të përgatitur e të edukuar nga Partia, të cilët, duke u mbështetur në një punë përgjithësuese shkencore, prej kohësh kishin arritur në përfundimin se kërkimi i naftës në shkëmbinjtë karbonatikë përbënte një problem me rëndësi të posaçme për vendin tonë. Shpim-kërkimet e kryera në gëlqerorët treguan se trualli i vendit tonë është i pasur me naftë e gaz, gjë që hodhi poshtë mendimet dhe rekondimet sabotuese të specialistëve të huaj revisionistë sovjetikë, të cilët ngulnin këmbë që kërkimet e naftës e të gazit të përqëndroheshin vetëm në depozitimët terrigjene. Faktet treguan se gëlqerorët përbën objektin më të rëndësishëm. Gjatë kohëve të fundit në ta janë zbuluar dhe janë vënë në shfrytëzim disa vendburime të reja naftëgazmbartëse e s'ka asnjë dyshim se në të ardhshmen do të zbulohen edhe vendburime e shtratime të reja, që do të janë mbështetje për realizimin e detyrate gjithnjë në rritje për prodhimin e naftës e të gazit.

Gjatë këtyre 30 vjetëve, shërbimi gjeologjik i naftës ka ecur

shumë përpara dhe ka ngritur në një shkallë të lartë nivelin shkençor të studimeve, gjë që shprehet me zbulimin e vendburimeve të reja, me rritjen e koeficientit të naftëdhënies dhe, në tërësi, me rritjen e prodhimit të naftës e të gazit nga njëri vit në tjetrin e nga njëri pesëvjeçar në tjetrin. Falë zgjerimit të punimeve komplekse gjeologjiko-gjeofizike, u krijuan kushtet që në vitin 1965 të ngrihej Instituti Gjeologjik i Naftës, i cili merret kryesisht me studimet gjeologjike për orientimin e punimeve të kërkimit e të zbulimit. Puna kërkimore-shkencore e këtij instituti ka ardhur vazhdimisht duke u rritur e zgjeruar.

Krahas ngritjes së Institutit, nën kujdesin e Partisë janë forcuar, zgjeruar e fuqizuar edhe punimet gjeologjike në ndërmarrjet e shpim-kërkimit, të shpim-shfrytëzimit dhe të nxjerrjes së naftës e të gazit. Pranë këtyre ndërmarrjeve punojnë tanë një numër i konsiderueshëm gjeologësh, të cilët merren me përpunimin e materialeve gjeologjike të puseve, me përgjithësimin dhe drejtimin operativ të punimeve gjeologjike.

Shërbimi gjeologjik i naftës tanimë është pajisur jo vetëm me një armatë të tërë specialistësh e kuadrosht të afta për t'u përgjigjur të gjitha detyrate që u janë ngarkuar, por edhe me aparatura, laboratore e kabinetë moderne për kryerjen e të gjitha llojeve të studimeve shkencore e të analizave. Ai ka tanë Qendrën Llogaritëse Elektronike, e cila jep një ndihmë të çmueshme sidomos përpunimin e materialeve gjeofizike. Ai është në gjendje t'u bëjë ballë të gjitha studimeve kërkimore shkencore, për të realizuar me sukses detyrat që vuri Ko-

ngresi i 8-të i Partisë dhe përtë bërë realitet direktivat për planin e 7-të pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës në vendin tonë socialist.

Naftëtarët dhe të gjithë punojësit e shërbimit gjëologjik të naftës do të kenë gjithnjë busull orientuese porosinë e shokut Enver Hoxha, se «Realizimi i detyrave për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, si dhe rritja e efektivitetit të shpenzimeve të mëdha që bëhen në këtë degë të industrisë, kërkijnë që naftëtarët, specialistët e kuadrot t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përsosjes së metodave të kërkimit dhe të nxjerrjes së tyre, duke u mbështetur plotësisht në arritjet e shkencës, në zbatimin e një disipline të fortë teknike dhe të punës».

Shërbimi gjëologjik i naftës, i ndërgjegjshëm për detyrat që i ngarkoi Kongresi i 8-të i Partisë,

ashtu si gjithmonë, duke pasur si armë të fuqishme orientimet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver Hoxha, do të mobilizohet akoma më shumë, për t'i zgjidhur me sukses të gjitha këto detyra. Me një punë edhe më këmbëngulëse, duke zbatuar e shfrytëzuar të gjitha mundësitet fizike e mendore të brendshme, do të çojë edhe më përpëra arritjet në drejtëim të zbulimit të vendburimeve të reja të naftës e të gazit, si dhe do të sigurojë një shfrytëzim racional të vendburimeve ekzistuese. S'ka dyshim se puna e deritanishme 30-vjeçare do të ngrihet në një nivel edhe më të lartë shkencor dhe përfundimet në këtë drejtëim do të janë edhe më të rëndësishme e të përkryera, duke vënë në jetë në mënyrë të pandërrerë porosinë e shokut Enver Hoxha se «duhet menduar ditë e natë për naftën ashtu si edhe për bukën».

Tiranë, nëntor 1981.

Bibliografi

BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE TË "PËRMBLEDHJE STUDIMESH" PËR VITIN 1981.

(Bibliographie des publications de «Përbledhje Studimesh» pour l'année 1981).

— Afërdita Osmanliu* —

Enver Hoxha — Nga raporti mbi veprimtarinë e Komitetit Qendoror të Partisë së Punës të Shqipërisë. (Rapport sur l'activité du Comité central du PTA). Nr. 4.

Nga diskutimi për projektdirektivat e Kongresit të 8-të të PPSH për planin e 7-të pesëvjeçar në ndërmarrjet gjëologjike e minerare. (Discussions du projet de la discussion du 8^e Congrès du PTA le VII-ème plan quinquennal des entreprises géologique et miniers). Nr. 3.

Direktivat e Kongresit të 8-të të PPSH për planin e 7-të pesëvjeçar (1981-1985) të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RPSSH. (Directives du 8^e Congrès du PTA le VII-ème plan quinquennal (1981-1985) du développement de l'économie et de la culture de la République Populaire Socialiste d'Albanie). Nr. 4.

Bujar Patë — Nga diskutimi në Kongresin e 8-të të PPSH. (Discours au 8^e Congrès du PTA). Nr. 4.

Ded Kolndreu — Nga diskutimi në Kongresin e 8-të të PPSH. (Discours au 8^e Congrès du PTA). Nr. 4.

Llambi Gegprifti — Nga diskutimi në Kongresin e 8-të të PPSH. (Discours au 8^e Congrès du PTA). Nr. 4.

Afërdita Osmanliu — Mbrojtje disertacionesh për gradën «Kandidat i shkençave». (Soutenance de thèse pour obtenir le grade «Candidat des sciences»). Nr. 3.

Afërdita Osmanliu — Bibliografi e botimeve të «Përbledhje Studimesh» përvitin 1981. (Bibliographie des publications de «Përbledhje Studimesh» pour l'année 1981). Nr. 4.

Ägim Pirdeni — Hemigordius renzi (Reichel) në depozitimet e permianit të sipërm të rajonit të Gjurajt në zonën e Alpeve Shqiptare. (Hemigordius renzi (Reichel) dans les dépôts du permien supérieur de la région de Gjuraj dans la zone des Alpes albanaise). Nr. 4.

Alaudin Kodra — Shkëmbinjtë jurasikë dhe jurasiko-kretakë në rajonet verilindore të Albanideve (në lindje të ofioliteve të zonës së Mirditës). (Les roches jurassiques et jurassico-crétacées dans les régions N-E des Albanides à l'est des aphiolites de la zone de Mirdita). Nr. 3.

Ana Thanasi — Studimi dhe aplikimi i një mëthode më të leverdissħħme përcaktimin e arsenikut dhe të fosforit në xeherorë polimetalaror.

*) Institut i Studimeve dhe i Projektimeve të Gjeologjisë dhe të Minierave.

- (L'étude et l'application d'une méthode plus avantageuse pour la détermination de l'arsenic et du phosphore dans les minéraux). Nr. 3.
- Andon Grazhdani** — Mineralizimet e reja në thyerjen e Drinit dhe në tarrë vendin tonë. (Les minéralisations nouvelles dans la cassure du Drin et en général dans notre pays). Nr. 3.
- Artan Tashko** — Metalopirja gjeokimike në zonën tektonike të Korabit. (Tendances métallo-géochimiques dans la zone tectonique du Korab). Nr. 3.
- Bashkim Lleshi, Fiqizi Bëkallı, Haki Caslli, Llambı Langora** — Ngritja në një nivel më të lartë shkencore e kërkimore gjeologjike-domosdoshmëri për rritjen e efektivitetit të tyre (Soulèvement de recherche géologique dans un niveau scientifique plus haut — une nécessité pour augmentation de leur efficacité). Nr. 2.
- Bashkim Lleshi** — Instituti i Studimeve dhe i Projekteve të Gjeologjisë dhe i Minierave në 40-vjetorin e themelimit të PPSH. (Institut de Recherche et de Projet Géologiques et Miniers au 40-Anniversaire du PTA). Nr. 3.
- Bilbil Meçaj** — Nomenklatura dhe klasifikimi strukturor i shkëmbinjve copëzorë të vendit tonë. (Nomenclature et classification structurale des roches détritiques de notre pays). Nr. 1.
- Eshref Pumo** — Formimet e kores së lashtë të tjetersimit në Albanidet Verilindore. (Les formations de l'ancienne croûte d'altération dans les Albanides N-E). Nr. 1.
- Eshref Pumo** — Në rrugën e ngritjes së mëtejshme të nivelit të punës mësimore-shkencore të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave të UT. (Elevons encore le niveau des travaux d'enseignement et scientifique à la Faculté de Géologie et de Mines de l'Université de Tirana), Nr. 4.
- Haki Caslli** — Kërkim-zbulimi i mineraeve të dobishme në planin e 7-të pesëvjeçar. (La prospection et l'exploration des minéraux utiles dans le 7 plan quinquennal). Nr. 3.
- Hazbi Shehu, Petrit Muhameti, Pëllumb Sadushi, Bilbil Meçaj** — Stratigrafia e depozitimeve terrigjene të paleogjen-miocenit të poshtëm të zonës Jonike pa përfshire brezin e Tomorrit. (Stratigraphie des dépôts terri-gènes du Paléogène-miocène dans la zone Ionienne sans la bande de Tomorri). Nr. 1.
- Hazbi Shehu, Petrit Muhameti** — Paleogeografia dhe paleotektonika e depozitimeve terrigjene të paleogjen-miocenit të poshtëm në zonën Jonike pa brezin e Tomorrit. (Paléogéographie et paléotectonique des dépôts terrigènes du Paléogène-miocène inférieur dans la zone Ionienne, exception faite de l'unité de Tomorri). Nr. 2.
- Hektor Dalipi** — Mendime mbi zhvillimin paleotektonik dhe mbi tektonikën e Ultësirës Pranadriatike. (Conceptions sur l'évolution paléotectonique et la tectonique de la Dépression périadiatique). Nr. 2.
- Jorgo Kanani** — Procesi i çdolomitizimit në depozitim karbenatore të jurasikut të poshtëm të zonës Jonike. (Le processus de dédolomitation des dépôts carbonates). Nr. 1.
- Kadri Gjata, Lulzim Goci** — Tiparet petrologjike e metalogenjike të komplekseve magmatike të Mirditës Verilindore. (Traits pétrologiques et métallogéniques des complexes magmatiques de la Mirdita N-E.) Nr. 2.
- Koço Prifti** — Formimet kuaternare të luginës së rrjedhjes së sipërme të Vjosës dhe disa veçori karakteristike të tyre. (Les dépôts quaternaires de la vallée du cours de la Vjosa) Nr. 2.

- Kristaq Papa** — Mbi efektivitetin e studimeve shkencore në punimet gjellogjike për kërkim-zbulimin e mineraeve të dobishme të nëntokës sonë. (De l'efficacité des recherches scientifiques dans les travaux géologiques pour la prospection et l'exploration des minérais utiles). Nr. 1.
- Kristaq Papa** — Përvetësimi më i thelluar i shkencës dhe i teknikës së përparruar — kusht i domosdoshëm për të quar përparrat rritjen e efektivitetit të studimeve shkencore në gjellogji. (L'assimilation plus approfondie de la science et de la technique avancée, condition indispensable pour rendre plus efficace les études scientifiques dans le domaine de la géologie). Nr. 3.
- Lufulla H. Pezq, Ded Marku, Agim Pirdeni** — Biostratigrafia dhe paleogeografia e depozitimeve kretake të rajonit të Munellës. (Biostratigraphie et paléogéographie des dépôts crétaçés de la région de Munella). Nr. 2.
- Luljeta Bozo** — Studim për vëtitë fiziko-mekanike të argjilave të Tiranës. (Les propriétés physico-mécaniques des argiles de Tirana). Nr. 3.
- Llesh Prenga, Parid Bérzhiku, Artan Tashko** — Disa përfundime mbi interpretimin gjeologjik të punimeve komplekse në një objekt të zonës së Mirditës. (Conclusion sur l'interprétation géologo-structurale des travaux complexes effectués dans une unité de la zone de Mirdita). Nr. 1.
- Menella Hido** — Studimet teknologjike të pasurimit të xherorëve kërkjojnë njohje e thellë të përbërjes lëndore. (Les études technologiques de l'enrichissement des minéraux exigent une connaissance profonde de la composition matérielle). Nr. 3.
- Menella Hido** — Lidhur me përeaktimin e kondicionit të përbajtjes sa më të ulët të metalit në xherorët e varfër të kromit. (À propos de la détermination de la condition de teneur minimale du métal dans les minéraux de chrome pauvres). Nr. 4.
- Mihallaq Malaveci, Vasil Qendro** — Aftësità zgjidhëse të metodave komplekse në mbështetje të rezultateve të kërkim-zbulimit të mineralizimit kuarc-sulfuror në rajonin e Hasit. (L'effet des méthodes complexes en tant que soutien des résultats des travaux d'exploration et de recherche de la minéralisation quarto-sulfureuse dans la région de Has). Nr. 1.
- Minella Shullo, Thanas Gjata, Aleks Vranaj, Polikron Theodhori, Lirim Hoxha** — Mbi praninë e flshit të hershëm të berriasian-valanzhinianit dhe mbi marrëdhëni e tij me bazamentin ophiolitik dhe me depozitimet e kretakut të poshtëm në rajonin e Kurbnesh-Kumbullës. (De la présence de l'ancien flysch du Berriasien-Valanzhinien et de ses rapports avec le sous-séisme ophiolitique et les dépôts du Crétacé inférieur dans la région de Kurbnesh-Kumbull, zone ophiolitique de Mirdita). Nr. 1.
- Minella Shallo, Aleks Vranaj, Agim Doni, Xhelil Karkanje** — Vendosja hapsinore e shkëmbinjve ultrabajzikë të vendit tonë. (Extension des roches ultrabasiques dans notre pays). Nr. 2.
- Neki Frashëri, Petrika Kosho** — Përdorimi i analizës spektrale për filtrimin e të dhënavë gjeofizike. (L'utilisation de l'analyse spectrale dans le filtrage des données géophysiques). Nr. 2.
- Niko Shkodrani** — Konsultë në Shkodër kushtuar problemeve të kërkim-zbulimit të boksiteve. (Consulte dans la ville de Shkodër dédiée aux problèmes de prospection et de recherche des bauxites). Nr. 3.

- Niko Nosi** — Saktësimë të disa rekëmandimeve të dhëna përf. kontrollin e gabisë mit sistematik të analizave. (L'exactitude de certaines recommandations données à propos du contrôle de l'erreur systématique des analyses). Nr. 4.
- Pandeli Pashko** — Paleobiogeografiqë e depozitimeve oligocenike të Ultësirës së Korçës. (Paléobiogéographie des dépôts oligocéniques dans la dépression de Korça). Nr. 3.
- Prekop Murra** — Arritjet përbëjnë një bazë të sigurtë përf. të sëur gjithmonë përparrë. (Les résultats constituent une base solide pour aller toujours de l'avant). Nr. 1.
- Róbert Ballta** — Përdorimi i radiovalëve në përcaktimin e zonave të thata¹ nga shëllirat në vendburimet e kripës së gurit. (L'emploi des ondes hertziennes pour la détermination des zones sèches et de celles de saumure dans les gisements de sol gemme). Nr. 1.
- Rushan Kocibelli** — Dësa rezultate nga eksperimentimi i sistemit të shfrytëzimit me hinkar në minierën e Prrenjasit. (Résultats de l'expérimentation du système d'exploitation avec des antennes dans la mine de Prrenjas). Nr. 1.
- Rushan Kocibelli, Isuf Meta, Iliaz Nako, Apostol Kromidha** — Përmirësimi i mënyrës së rrëzimit të xherorit hekurnikelor në minierën e Prrenjasit përf. të ulur humbjet dhe varfërimin. (Amélioration du mode d'abattage du mineraï de ferronichel en vue de diminuer les pertes et l'appauvrissement du mineraï dans la mine de Prrenjas). Nr. 3.
- Ruzhdi Cara, Faredin Mullaj** — Plazhi i Semanit, pasurimi i tij me minerale të rënda, kushtet e formimit dhe përbërja mineralogjike. (La plage de Seman, son enrichissement avec des minéraux fourde, ses conditions de formation et sa composition minéralogique). Nr. 4.
- Servet Pasho** — Shërbimi gjeologjik i naftës në 30-vjetorin e krijuarit të tij (Le service géologique du pétrole au 30^e anniversaire). Nr. 4.
- Sesion shkencore në Institutin e Studimeve dhe të Projekteve të Gjeologjisë** — dñe të Minierave në Tiranë dhe në Institutin Gjeologjik të Naftës së Fier. (Sessions scientifiques par l'Institut de Recherche et de Projet Géologiques et Miniers à Tirana et par l'Institut Géologique du pétrole à Fier). Nr. 1.
- Sotir Dodona** — Aftësimi i mëtejshëm i specialistëve të minierave përf. t'u përgjigjur edhe më mirë rolit që duhet të luajnë në shfrytëzimin e vëndburimeve të mineralete të dobishme. (L'élévation du niveau de connaissances de nos ingénieurs des mines permettra de mieux remplir leur rôle dans l'exploitation des gisements de minéraux utiles). Nr. 1.
- Sotir Dodona** — Humbjet dhe varfërimi i mineralete, mënyra e vlerësimit dhe disa masa përf. uljen e tyre. (Les pertes que subissent les minéraux qui sont extraits du sous-sol et leur appauvrissement). Nr. 3.
- Vaskë Pine, Dhora Tabaku** — Karakteristikat mineralogjike dhe përbërja lëndore e trupave xherorë dhe e kromspinelideve të masivit ultrabazik të Shebenik-Pogradecit. (Caractéristiques minéralogiques et compositions matérielles des corps de minérais et des chromites accessoires du masif ultrabasique des Shebenik-Pogradéc). Nr. 2.
- Vedat Shehu, Nail Demi, Nikolla Konomi** — Tuneli i Qafëthanës dhe vlerësimit gjeologjike-inxhinierike të tij. (Le tunnel de Qaféthanë et ses traits géologiques-ingénieriques). Nr. 4.